ExLibris

ISSN 2708-4876

E PËRJAVSHME LETRARE KULTURORE

Themelues · Kryeredaktor
BUJAR HUDHRI

E SHTUNË, 14 SHTATOR 2024 | NUMËR 301 | VITI VII I BOTIMIT | ÇMIMI 50 LEKË | WWW.EXLIBRIS.AL | EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL | BOTIM I ONUFRI SHPK

MBROJTJA eSHKODRES

NË VEPRAT E PIKTORËVE TË SHQUAR EUROPIANË

Nga Ferid Hudhri

ATË NDON BELUSHIT NË 90-VJETORIN E LINDJES

Rrugëtimi i një misionari: model përkushtimi për arbërorët dhe arbërinë

Nga Vilma Proko (fq. 18)

E përkthyer mjeshtërisht nga Alqi Kristo, botohet për herë të parë në shqip poema e Shekspirit

Feniksi dhe turtullesha

Nga Prof. Dr. Diana Kristo

"Feniksi dhe Turtullesha" ka një muzikalitet të brendshëm, të shprehur në tetrametër trokaik që na sjell ndërmend një marsh hijerëndë, nëpërmjet të cilit perceptojmë tonalitetin e errët të trumpetës të përmendur në vargun e tretë...

(fq. 22)

SHËNIME MBI LIBRAT

Romani i shkrimtarit Ndue Ukaj *Dritarja e Marin Shkrelit*: Retrospektivë mbi fatin e individit dhe qenësinë e një kombi

Nga Rrezarta Morina (fq. 8)

Anton Nikë Berisha, *Gjin Bardhela i Arbresh, Etja e Gurëzuar*

SHTRESËZIMI POETIK I NJË KRIJESE TË LARTË ARTISTIKE

Nga Dante Maffia (fq. 10)

LUGINA KU BASHKOHEN GEGË E TOSKË (fq.6)

Nga dr. Skënder Karriqi

Përtej faktit të njohur mbi ndarjen e gjuhës shqipe në dy dialekte (Gegë e Toskë) me kufi lumin Shkumbin, gati si një shënim plotësues, në tekstet e dialektologjisë së gjuhës shqipe bëhet fjalë edhe për të folmet kalimtare.

SHOQËRIA E SPEKTAKLIT DHE LIBRI (fq.7)

Nga Xhevair Lleshi

Shoqëria shqiptare sot është futur në binarët e shoqërisë së spektaklit, jo me dashjen e saj, por si rrjedhojë e një diktati shtetëror...

Fituesja e "Booker International"

JENNY ERPENBECK për romanin e saj "Kairos", për Marksin, shpresat e thyera, dhe se si u rrit në Gjermaninë Lindore

The Berliner



BIBLIOTEKË

Rudolf Marku (fq. 12)
Kujtim i largët

Gazmend Berlajoli (fq. 14)
Fëllanzat

Ylli Ajdini (fq. 15)
Një kafe jashtë radhe

Istref Haxhillari (fq. 16)
Flutura e nënës sime

Mehmet Elezi (fq. 17)
31 poezi hajk

Arben Meksi (fq. 24)
Karikatura e së shtunës

BUJAR LUCA DHE ARTI I TIJ I HIJSHMËRISË SË EPËRME

Nga Prof. Dr. Luan Topçiu (fq. 11)

Botim i ri nga BotArt

Yuval Noah Harari

NEXUS (fq. 20)

Një histori e shkurtër e rrjeteve të informacionit nga Epoka e Gurit tek Inteligjenca Artificiale

MBROJTJA E SHKODRËS

NË VEPRAT E PIKTORËVE TË SHQUAR EUROPIANË

Nga Ferid Hudhri

Afresku *Mbrojtja e Shkodrës* vlerësohet midis veprave më të rëndësishme me temë shqiptare jo vetëm për vlerat artistike, për autorin e shquar, vendin ku është pikturuar, por edhe për tematikën. Krijuesi i kësaj pikture, mjeshtri i njohur i Rilindjes italiane Paolo Calliari Veronese, që zotëron salla të mëdha në Galerinë Kombëtare të Londrës, apo bën pjesë në disa koleksione italiane si dhe nëpër muze të tjerë nëpër botë, e realizoi *Mbrojtjen e Shkodrës* pikërisht në kohën kur ishte në periudhën më të artë të krijimtarisë së tij. Tabloja u pikturua në Pallatin e Dozhëve, një nga selitë kryesore të institucioneve shtetërore të Vendikut.

Përkrah veprës monumentale *Rrethimi i Shkodrës* të Marin Barletit, kushtuar *një prej episodeve më mbresëlënëse të luftës midis Perëndimit dhe Gjysmëhënës,* siç e ka përcaktuar balkanologu Franz Babinger[1], piktura murale *Mbrojtja e Shkodrës* e Veronese-s mund të përcaktohet si homazhi më i bukur artistik kushtuar qëndresës arbërore gjatë shekullit XV.

Tabloja u pikturua në vitin 1585, pas rikonstruksionit që iu bë pallatit, nga zjarri i vitit 1577 që e dëmtoi në krejt gjatësinë e tij. *Mbrojtja e Shkodrës* në muret e brendshme të Pallatit Dukal qëndron përballë *Parajsës* së Tintoretto-s, në krah të sipërfaqes ovale të zbukuruar nga afresku *Apoteoza e Venecias*.

Në kohën kur jetoi dhe krijoi artisti Veronese, në Venecia banonin edhe shumë familje shqiptare, që u shtuan pas vdekjes së Skënderbeut. Çdo qëndresë kundër pushtuesve osmanë në trojet shqiptare festohej bashkë me qytetarët italianë, si simpatizantë të atyre luftëtarëve që pengonin marshimin e pushtuesve përtej brigjeve të Adriatikut. Qëndresa e Shkodrës më 1479, ku mbetën të vrarë qindra osmanë, u festua në Venedik me ngritjen e flamurit në Bazilikën e Shën Markut. Në vazhdimësi të këtij manifestimi, 106 vite më vonë Veronese realizoi pikturën murale më 1585. Mbi afreskun *Mbrojtja e Shkodrës*, ka shkruar me dorën e tij edhe këto fjalë: *Scodra, bellico omni apparatu diù vehementerque à Turcjs oppugnata, accerima propugnatione retinetur* (Shkodra e sulmuar me tërë mjetet e luftës prej turqve, për një kohë të gjatë e me fuqi, i bëri ballë duke qëndruar rreptë). Si një mbishkrim i saktë për këtë tablo mund të merren edhe fjalët e historianit Hammer-Purgstall i cili, duke përshkruar inkursionet osmane, që në vitin kur sulmuan Shkodrën arritën deri në Austri, nënvizonte: *Qëndresë trimash, siç nuk i gjetën ushtritë grabitqare në Kroaci, Karnie, Karinti, Stiri dhe Slavoni, ato e gjetën në Shqipëri, përpara mureve të Shkodrës*[2]. Shkodra ishte fortesa e fundit e Perëndimit.

Për realizimin e afreskut, Veronese është ndihmuar edhe nga i biri, piktori Carlo Caliari. Në moshën 15 vjeç, në kohën kur mësonte artin e pikturimit në studion e të atit, piktori i ardhshëm ka lënë gjurmët e tija në një nga veprat më të bukura me temë shqiptare. Vite më pas Carlo u bë një nga artistët e njohur të Rilindjes Italiane. Disa nga pikturat e tij vazhdojnë të vlerësohen edhe sot nëpër ankandet e veprave të artit, por për shqiptarët mbeten më të çmuara penelatat e tij të para në tablonë *Mbrojtja Shkodrës*. Pas vdekjes së të atit, Carlo vazhdoi të pikturonte në të njëjtën studio bashkë me të vëllain Gabriele, si dhe me xhaxhanë Benedetto, për të përfunduar veprat e lëna në mes të mjeshtrit të madh.

Një nga skicimet e para për realizimin e tablosë *Mbrojtja e Shkodrës* ruhet në Oksford. Ky vizatim bën pjesë ndër ato krijime të rralla artistike ku autori, motivi dhe vendndodhja ndahen midis tri shteteve; tema shqiptare e vizatimit, e realizuar nga artisti italian Paolo Veronese, ruhet në një koleksion anglez, në Muzeun Ashmolean të Oksfordit. Vizatimi i Veronese-s, ndonëse daton rreth vitit 1585, është nga zbulimet e fundme midis krijimeve me temë shqiptare. Më parë njihej vetëm tabloja në Venedik. Drejtori i Kabinetit të Vizatimeve në muzeun e Oksfordit, Phd. John Whiteley, duke e quajtur si pjesë të rëndësishme të koleksionit dhe si një nga dëshmitë artistike për realizimin e tablosë së njohur (që ndodhet në Pallatin e Dozhëve në Venedik) e përfshin vizatimin e mësipërm midis eksponateve të çmuara të Muzeut Ashmolean[3]. Për ne shqiptarët është akoma më i vyer, se përjetëson një episod të rëndësishëm të historisë kombëtare, realizuar nga njëri prej mjeshtërve më të mëdhenj të Rilindjes Italiane në një nga godinat më të veçanta të arkitekturës botërore. Gjatë vëzhgimeve krahasuese midis imazheve të vizatimit origjinal që ruhet në Ashmolean dhe afreskut të pikturuar në Venecia, vihen re disa ndryshime në kompozimin e figurave dhe elementë të tjerë figurativë. Vizatimet paraqesin fragmente të ndryshme nga tabloja e pikturuar.

E përbashkët midis të dy krijimeve është figura e gruas që paraqitet në plan të parë. Me pikturimin e saj Veronese na kujton edhe shumë gra të tjera shkodrane që iu desh të përballeshin me sulmin e armiqve apo të ndihmonin burrat e djemtë e tyre gjatë betejave. Një pjesë e madhe prej grave mbetën të vetme me fëmijët. Albanologia L. Nadin, në një nga studimet e saj për këtë periudhë, përshkruan se një numër të madh grash dhe fëmijësh nga Shkodra u vendosën në qytetin e lagunave gjatë kohës së luftimeve për mbrojtjen e kështjellës. Nëpër faqet e regjistrave të Senatit ajo ka hasur shënimin se *në Venedik gjenden shumë gra shkodrane, të cilat, nëpërmjet deklaratave me shkrim të kapitenit Antonio da Lece, dëshmojnë se janë bashkëshorte të luftëtarëve të angazhuar gjatë rrethimit të parë e të dytë të Shkodrës*[4]. Vlerësimi për gratë shkodrane paraqitet edhe në një gravurë të Giovanni Palazzi-t në vitin 1861 që është

Anthony van Dyck, *Defence of Scutari; after Paolo Veronese*, British Museum, London

Fragment nga tabloja *Mbrojtja e Shkodrës* (Paolo Veronese, Pallati Dukal, Venecia)

Paolo Veronese, *Mbrojtja e Shkodrës*, 1585, Pallati Dukal, Venecia

përdorur për lojën me letra *La virtu in gioco* (Virtyti në lojë). Sipas L. Nadin në atë tufë letrash të përgatitura nga Palazzi, saktësisht te Nënta Spathi, është paraqitur një grua që përfaqëson gratë shkodrane në Venedik, të cilat, siç shkruhet në botimin italian, edhe pas dy shekujsh nga mërgimi i vitit 1479 vazhdojnë të jenë simbol i ndershmërisë femrore[5].

Përveç vizatimit në muzeun e Oksfordit, një skicë tjetër e Veronese-s për tablonë *Mbrojtja e Shkodrës* (në përmasat 121 x 198 cm) ruhet në një koleksion privat në Angli. Eshtë i vizatuar me pendë, me ngjyrë kafe të artë dhe kafe të errët. Ndërsa te vizatimi në Muzeun Ashmolean (me shifrën P2 742, në përmasat 123 x 215 cm), krahas skicimeve me pendë janë përdorur edhe bojra uji (acquarello).

Përmasat e vlerave artistike të veprave me temën kushtuar mbrojtjes së Shkodrës rriten më shumë dhe nga disa krijime të autorëve të tjerë të njohur. Më i rëndësishmi prej tyre është vizatimi nga Anton van Dyck, piktori më i shquar flamand dhe ndër më të spikatur në të gjithë artin botëror. Nga kërkimet në fondin e Muzeut Britanik në Londër zbuluam se vizatimin kushtuar shqiptarëve mjeshtri flamand e kishte bërë sipas tablosë *Mbrojtja e Shkodrës* të Veronese-s. Në kartelën e muzeut është vendosur ky shënim: "Anthony van Dyck: *Defence of Scutari; after Paolo Veronese*"[6]. Në gjurmimet për të përcaktuar vendin dhe kohën më të saktë të realizimit (pasi në kartelë shënohej: *midis viteve 1614-1641*, periudhë që artisti e ndau midis Anglisë dhe Italisë), ishte i nevojshëm krahasimi me një nga vizatimet paraprake të Veronese-s për këtë tablo të ndodhur në Muzeun Ashmolean të Oksfordit. Nuk kishte ngjashmëri midis tyre. Vizatimi i Dyck-ut ishte bërë sipas afreskut origjinal të vitit 1585 në Pallatin Dukal në Venecia. Pra, sipas këtij hulumtimi del se lidhjet e mjeshtrit flamand me botën shqiptare kishin nisur gjatë viteve të para të qëndrimit të tij në Itali. Siç është paraqitur gjërësisht në studimin e Angela Valenti Durazzo, piktori A. Van Dyck pas udhëtimit në Venecia qëndroi për disa muaj në Genova, pranë familjes së njohur Durazzo. Gjatë pikturimeve në mjediset e Pallatit Mbretëror (*Palazzo Reale*) në telajot e këtij piktori u përjetësuan gjithashtu edhe fytyrat e disa prej pjesëtarëve të fuqishëm të kësaj familje të madhe, të ardhur në Itali nga qyteti i Durrësit[7].

Giovanni Palazzi, *Gruaja shkodrane në lojën me letra*, Venecia, 1861

Krahas veprave të këtyre dy autorëve më të shquar, për qëndresën shqiptare në muret e kështjellës së Shkodrës njihen edhe tri punime të tjera artistike. Nga më të hershmit është relievi kushtuar qëndresës së Shkodrës në vitin 1479, i vendosur në ballinën e Shkollës së Shqiptarëve (Scuola degli Albanesi), në Shën Mauric. Në pjesën e poshtme të relievit shihet Sulltan Mehmeti me Vezirin e tij duke vështruar nga larg kështjellën e Shkodrës që paraqitet në anën e sipërme, mbi masivin shkëmbor. Në muret e brendshme të kësaj shkolle të njohur në Venecia është realizuar edhe një cikël i plotë pikturash nga artistët Vittorio Carpaccio dhe Marco Basaiti ku janë të pranishëm personazhe, vende dhe ngjarje të ndryshme nga bota shqiptare.

Në vitin 1720, piktori Andrea Zucchi e rikujtoi ngjarjen historike të qëndresës së shqiptarëve duke gdhendur gravurën "Lufta për mbrojtjen e Shkodrës". Krijimi i Zucchi-t është realizuar sipas tablosë së pikturuar në Pallatin Dukal në vitin 1585. Sipas një praktike të njohur të atyre viteve, kur tablotë më të bukura të autorëve të shquar riprodhoheshin në disa kopje përmes gdhendjeve grafike, edhe imazhet e luftimeve për mbrojtjen e Shkodrës u shumëfishuan me këtë rast për koleksionistët dhe admiruesit e artit. Një nga gravurat e para të A. Zucchi-t, e gdhendur sipas imazhit të tablosë *Mbrojtja e Shkodrës*,



Giuseppe Lorenzo Gatteri, *Dëbimi i turqve nga kalaja e Shkodrës*, akuaforte e vitit 1860

Paolo Veronese, Vizatim për tablonë *Mbrojtja e Shkodrës,* Muzeu Ashmolean Oxford

Andrea Zucchi, *Lufta për mbrojtjen e Shkodrës*, gravurë e vitit 1742, Muzeu Britanik, Londër

tani ruhet në fondin e Muzeun Britanik në Londër[8].

Ndërsa në vitin 1860, kur piktori Giuseppe Gatteri realizoi 150 tablo të ndryshme që u përdorën për ilustrimin e historisë së Venecias, në atë cikël përfshiu edhe një imazh nga betejat për Shkodrën, që njihet gjithashtu me titullin *Prapsja e turqve nga Shkodra* (I Turchi respinti da Scutari). Bëhet fjalë pikërisht për luftën e vitit 1479, në kalanë e Shkodrës, për mbrojtjen e qytetit nga otomanët; e njëjta temë që është pikturuar nga mjeshtri Paolo Veronese në Pallatin e Dozhëve në Venedik. Krijimet e të dy autorëve italianë për ngjarjen e Shkodrës janë realizuar në teknika të ndryshme. Edhe këndvështrimi për të njëjtën temë është krejt i ndryshëm. Nëse Veronese mbrojtjen e qytetit e simbolizon me shpëtimin e një gruaje të re nga duart e pushtuesve, Gatteri pasqyron një çast beteje, ku duken turqit e rrënuar nga goditjet me gurë dhe objekte të tjera që zbresin prej bedenave të kalasë. Vizatimi i piktorit Gatteri është gdhendur në gravurë prej grafistit Enrico Reinhart.

Për mbrojtjen e Shkodrës janë realizuar edhe vepra të tjera që i përkasin viteve të mëvonshëm. A. Bianchini, autori i tablosë së njohur "Gratë shqiptare luftojnë përkrah burrave në mbrojtje të vendit të tyre", ka pikturuar një skenë nga betejat e viteve 1912-13. Të kësaj periudhe janë edhe një numër i madh vizatimesh, ilustrimesh, gravurash dhe litografi nga autorë të ndryshëm europianë. Ekziston gjithashtu edhe një cikël karikaturash ku demaskohen qëllimet, ndërhyrjet dhe veprimet luftarake të shteteve shoviniste për pushtimin e Shkodrës, si dhe dështimi dhe dëbimi i tyre nga muret e kështjellës Rozafa. Pjesa më e madhe e këtyre krijimeve u botuan në disa prej gazetave dhe revistave të njohura të kohës si *Kikeriki, Die Muskete, Le Monde illustré*, *Wiener Caricaturen, Simplicissimus, Punch, Illustrirte Zeitung,* etj.

Pas veprave të mësipërme, kryesisht atyre kushtuar qëndresës në shekullin e XV, marrin një vlerë të veçantë edhe shumë gravura, akuarele dhe vizatime të mëvonshme ku ravijëzohet pamja e plotë e kalasë së Shkodrës. Duket sikur gjithë ato imazhe të sjellin ndër mend qëndresën dhe luftimet e shkodranëve nga mesi i shekullit XV deri në pavarësinë e Shqipërisë. Pjesa më e madhe e gravurave dhe akuareleve të mëpasshëm janë realizuan gjatë shekullit XIX, kur u shtuan përpjekjet e shqiptarëve për liri. Vëmendja e artistëve të huaj për Shkodrën ndjehet në çdo periudhë. Është qytetit ku kanë kaluar apo kanë qëndruar për të pikturuar më shumë autorë të njohur europianë. Edhe ekspozita e parë e artistëve të huaj që kanë pikturuar në trojet shqiptare u çel në një nga sallonet e Shkodrës. Nga data 30 prill deri më 2 maj të vitit 1918, piktorët Armin Horowitz, Pravotinsky dhe skulptori László Beszédes ekspozuan para qytetarëve shkodranë skica, vizatime, peizazhe në akuarel dhe ngjyra vaji, me motive të ndryshme nga bota shqiptare[8]. Aty u paraqitën edhe disa imazhe nga kështjella legjendare. Në qytetin ku pikturuan dhe ekspozuan gjithë ata autorë të huaj është hapur gjithashtu edhe e para ekspozitë në grup e artistëve shqiptarë. Në muajin shkurt të vitit 1923, Shoqëria Rozafa mblodhi në një sallë të përbashkët veprat e artistëve të njohur Kol Idromeno, Ndoc Martini, Andrea Kushi, Simon Rrota si dhe të disa autorëve të tjerë që nuk e çuan deri në fund rrugën e artit. Në atë ekspozitë mori pjesë edhe At Gjergj Fishta me 24 punime[9]. Në një nga pikturat e asaj kohe mjeshtri Idromeno pasqyron "Ikjen së Zonjës së Shkodrës". Mbështetur në legjendën e hershme ai paraqet fluturimin e ikonës nga kisha në rrëzë të kalasë Rozafa drejt Italisë në vitin 1467, pikërisht në kohën kur ushtritë osmane po dyndeshin drejt pushtimit të plotë të Arbërisë, pas vdekjes së Skënderbeut. Sipas legjendës ikona "Zonja e Shkodrës" arriti në qytezën Genazzano, pranë Romës, më 25 prill të vitit 1467 dhe u vendos në altarin e kishës Madre del Buon Consiglio. Udhëtimi nga Shkodra në Genazzano dhe pritja nga besimtarët vendas është pasqyruar në dy tablotë "Shkodër - Genazzano" dhe "Mbërritja e Zonjës së Këshillit të Mirë në Genazzano" të artistit italian Prospero Piatti. Pikturat mësipërme të Idromenos dhe Piatti-t mund të cilësohen si imazhet më të afërta pararendëse për tablotë kushtuar luftrave për mbrojtjen e Shkodrës në vitin 1479, luftime që u zhvilluan pranë kishës, ku

ndodhej ikona "Zonja e Shkodrës", si dhe në pjesën e sipërme të kodrës shkëmbore, rreth mureve të larta të kalasë Rozafa.

Siç del nga përshkrimet e mësipërme, veprat me temë nga mbrojtja e Shkodrës, të pikturuara nga disa autorë të shquar, i dhanë jehonën e përjetshme qëndresës shqiptare gjatë shekullit XV. Që nga koha e realizimit të tyre, ato vazhdojnë të soditen nga vizitorë të shumtë në disa prej muzeve dhe galerive më të rëndësishme të Europës. Vazhdojnë t'i bëjnë jehonë botës shqiptare. Përveç Pallatit të Dozhëve në Venecia, ku është pikturuar afresku nga Veronese, veprat e tjera ndodhen në Muzeun Ashmolean të Oksfordit, në Museun Britanik në Londër, te Scuola degli Albanesi në Venecia, si dhe në koleksione të tjera private në Itali, në Angli dhe nëpër vende të tjera.

Nga kërkime e hulumtime të ardhshme me siguri do të dalin në dritë edhe gravura, litografi, vizatime, akuarele, tablo apo relieve dhe punime të ndryshme artistike. Vepra të reja po zbulohen edhe në fusha të tjera. Para pak kohësh doli nga shtypi një libër i ri rreth një dorëshkrimi të panjohur kushtuar luftës për mbrojtjen e Shkodrës[9].

* *Fragment nga libri* HISTORIA E SHQIPTARËVE NËPËR MUZETË E ARTIT, *në proces botimi nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë.*

Antonio Bonamore, Kalaja e Shkodrës, gravurë e shekullit XIX

Reliev kushtuar qëndresës së Shkodrës në vitin 1479, Scuola degli Albanesi, Venezia



Edward Lear, *Shkodër 1848*, The Houghton Library, Harvard University, USA

Bibliografi:

1. Barleti, M.: *Rrethimi i Shkodrës*, përgatitur për botim David Hosaflook, f. 2-3, Onufri, Tiranë, 2012.
2. Sipas Prof. Aleks Buda, *Hyrje* në botimin e librit të M. Barletit *Rrethimi i Shkodrës*, Tiranë 1967, f. 5-52, botuar edhe në librin Buda, A., *Shënime historike*, Vol. I, f. 346, Tiranë, 1987.
3. Whiteley, J.: Sipas përshkrimit në skedën e vizatimit për tablonë *Mbrojtja e Shkodrës*, të piktorit P. Veronese. WA 1938.44 , The Ashmolean Museum, Oxford, 2008.
4. Nadin, L.: *Shqiptarët në Venedik. Mërgime integrim* 1479-1552, Shtëpia Botuese 55, f. 21,Tiranë, 2005.
5. Nadin, L.: *Venezia e Albania: Tracce di antichi legami*, f. 8-9, Venezia-Mestre, 1995.
5. Anthony van Dyck: *Defence of Scutari; after Paolo Veronese*, no 1957, 1214.207.52, British Museum, London. Shënime nga kërkimet në arkivin e Muzeut Britanik, Londër, 1992.
6. Valenti (Durazzo), A.: *I Durazzi, da schiavi a dogi della Republica di Genova*, f. 25, 42-43, 57, Genova, 2004.
7. Zucchi, A.: *La città di Scutari diffesa da Antonio Loredano contro Turchi,* 1720 (after Paolo Veronese) 354 x 524 mm, British Museum, London.
8. Sipas artikullit: *Ekspozision pikturash në Shkodër*, "Posta e Shqypnis", f. 3, Shkodër, 4 maj 1918.
9. Për më shumë shih: *Ekspozitë pikturash kombëtare në Shkodër*, revista "Hylli i Dritës", nr. 2, f. 12, Shkodër, 1923.
10. Bëhet fjalë për librin *La guerra di Scutari, da un manonscritto*, përgatitur nga Lucia Nadin dhe Aurel Plasari me parathënie nga Matteo Mandala, botuar nga Viella, mars, 2024.

Lugina ku bashkohen Gegë e Toskë

Nga Dr. Skënder Karriqi

Përtej faktit të njohur mbi ndarjen e gjuhës shqipe në dy dialekte (Gegë e Toskë) me kufi lumin Shkumbin, gati si një shënim plotësues, në tekstet e dialektologjisë së gjuhës shqipe bëhet fjalë edhe për të folmet kalimtare, të cilat, sipas dialektologëve, i përkasin një brezi toke *në të majtë të lumit Shkumbin* (Pse jo edhe në të djathtë?! Shënimi im) dhe *ku vihet re përzierja e tipareve kryesore* të *dy dialekteve* të *shqipes*. Më tej, për të vazhduar detajimin, përcaktohen edhe fshatra e zona të të folmeve kalimtare si: Rrajca, Bërzeshta, Polisi, Kraihna e Vërçës, e Shpatit, e Sulovës, e Dumresë, e Darsisë së Peqinit, Bregdeti i Pashtëm i Kavajës dhe pjesa veriore e Fushës së Lushnjes, të cilat duhet të jenë marrë në konsideratë si vatra të përzierjes së tipareve, pasi nuk ka asnjë arsye tjetër që të përjashtohen fshatra e zona të tjera, që kufizohen me fshatrat dhe zonat e shënuara si bartëse tipike të përzierjes, madje janë vazhdim hapsinor i tyre në përputhje me kahun e lumit Shkumbin.

Në fakt, nuk është vetëm dialektologjia dhe dialektologët që e përcaktojnë lumnin Shkumbin si kufi të ndarjes (dezintegrimit). Përfundime të tilla, shoqëruar me ilustrime hartografike, i gjejmë edhe në studimet etnomuzikologjike shqiptare, sipas të cilave ë*shtë Shkumbini ai që ndan Shqipërinë në hapësirë isopolofonike, përkatësisht Toskëria dhe hapësirë monodike, përkatësisht Gegëria.* Edhe etnografja Andromaqi Gjergji, kur bën fjalë për veshjet e Bërzeshtës, ve në dukje se, përveç kësaj zone ajo (veshja e Bërzeshtës), mbahet edhe në një grup fshatrash në krahun e djathtë të Shkumbinit, pran ë të dy brigjet e tij, prej Bërzeshte e Pishkashi, deri në Librazhd.

Dialektologët, etnomuzikologët, etnografët, me sa duket, janë të interesuar vetëm për dukurinë në vetvete lidhur me fushat përkatëse, duke u përqëndruar kështu në anën përshkrimore të dukurive përkatësisht dialektore, etnomuzikore dhe etnografike, pa qenë të interesuar në mënyrë të qëllimshme për shpjegimin logjik të dukurisë kalimtare si përzierje e elementeve kryesore të gjuhës dhe kulturës në përgjithësi, përkundrejt termit "ndarje" (dezintegrim).

Por, në fakt, në thelb, dezintegrimi si proçes i përftuar nga mungesa e kontakteve, ndalimet, largimet etj, përveçse ndryshimeve që thellohen me intensifikimin dhe zgjatjen në kohë të këtyre faktorëve, kurrsesi nuk mund të nënkuptojë përzierje të tipareve gjuhësorë dhe kulturorë, pasi përzierja vjen prej kontakteve, këmbimeve dhe afrimeve. Në këtë kuptim, përzierja e elementeve kryesorë të dy dialekteve dhe më gjerë, elementeve të kulturës etnike kombëtare përgjatë Luginës së Shkumbinit, siç thonë dialektologët dhe studiuesit e fushave të tjera (etnografia dhe etnomuzikologjia) do të nënkuptonte lëvizje (migrim) të elementeve gjuhësore dhe kulturore në kahun Veri-Lugina e Shkumbinit dhe kahun tjetër, Jug-Lugina e Shkumbinit. Sipas kësaj lëvizjeje simetrike të elementeve gjuhësore dhe kulturore, ku si bosht simetrik kemi parasysh vijën e Shkumbinit, justifikohet brezi kalimtar (jo vetëm në anën e majtë të Shkumbinit), pra përzierja e tipareve dialektore dhe kulturore. Po të jetë kështu, atëhere jemi duke pohuar se: *Shkumbini dhe Lugina e tij nuk i ndajnë në pikëpmje gjuhësore (dialektore) dhe kulturore shqiptarët: përkundrazi, i bashkojnë ata.*

Është rasti t'i referohem përsëri, si gjetkë në shkrime të tjera, prof, Neritan Cekës në studimin *Qyteti ilir pranë Selcës së Poshtme*, ku ndër të tjeta ai shkruan: *Shkumbini përbën rrugën kryesore natyrore që e përshkon këtë krahinë. Grykat e tij të Quksit janë e vetmja rrugë e përshtatshme për të dalë nga perëndimi drejt zonës bregdetare. Drejtimi tjetër nëpër Bishnicë dhe Holtë, drejt Devollit, është tepër i vështirë për një rrugë tregtare.*

Sipas kësaj reference, po të citonim në mënyrë të përshtatshme Ajnshtajnin, do të thoshim*: Është tërreni* (fusha) *që mëson se si të lëvizë njeriun* (materien). Dhe në këtë rast lëvizja në kërkim të rrugës kryesore natyrore është nga polet (Jug-Veri/ Gegëri-Toskëri) e hapësirës fizike dhe etnike shqiptare, drejt Shkumbinit dhe Luginës së tij, atje ku gjindja shqiptare afrohej, takohej, përzihej dhe në fund të fundit bashkohej përgjatë udhës së daljes në perëndim.

***

Lëvizjen e tillë si më lart, sot e gjithë ditën e reflekton edhe tradita folklorike e gjallë në Luginën e Shkumbinit. Gegët dhe Toskët në Shqipërinë urbane dhe rurale sigurisht që nuk i përmbahen vijës së Shkumbinit dhe do të ishte e pamundur të hulumtohej historia e lëvizjes së tyrë në gjithë hapësirën shqiptare. Nga ana tjetër, prania e emrave fisnorë *Gega* dhe *Toska/ Tosku* përgjatë Luginës së Shkumbinit, pikërisht në zona të të folmeve kalimtare merr një rëndësi të veçantë për të argumentuar pohimin tonë se *Shkumbini dhe Lugina e tij nuk i ndajnë në pikëpamje gjuhësore dhe kulturore shqiptarët: përkundrazi, i bashkojnë ata.*

Duke punuar për një festival lokal të polifonisë dyzërëshe (diafonike) në rrethin e Librazhdit, në Frarë të Hotolishtit (ana e djathtë e Shkumbinit, rrëzë Shebenikut), ende këndohet një këngë e vjetër, vargjet e së cilës janë:

Më rrëmbeu ai gëgë çobani,
Nënë moj më rrëmbeu,
Më rrëmbeu më çoi nga mali.
Më veshi gunën e bardhë;
Ai vish e unë zhvish.
Ia mora ia hodha poshtë

Me ndryshime jothelbësore kjo këngë këndohet përgjatë Luginës së Shkumbinit, anës së djathtë, në fshatrat: Rrajcë, Pishkash, Luqinjë, Skroskë, Kokrevë, Vulçan, Velçan, Hotolisht, e Dragostunjë, ku, sipas perceptimit të një të vjetri, ndahet Mokra me Çermenikën.

Në mungesë të kronikave historike, poezia popullore ka bukur mirë rol kompensues dhe për këtë arsye ajo shërben si pikë referimi për të hedhur dritë mbi proçese të rëndësishme të intëgrimit dhe dezintegrimit gjuhësor dhe kulturor për popuj të ndryshëm dhe në rastin tonë për shqiptarët. Kënga e mësipërme dëshmohet shumë e vjetër, për shkak të tipologjisë së saj si këngë e kohërave të dasmave me rrëmbim, që do të thotë se bëhet fjalë për periudha të hershme, të papërcaktuara kalendarikisht, por të pranuara për periudhën arkaike (Rëmbimi i Helenës së Trojës si dokumenti më i hershëm ballkanik) e deri në kufi të Mesjetës së Hershme.

Kjo këngë e kënduar në variacionet e saj (pa ndryshime thelbësore) përgjatë vijës luginore të Shkumbinit (Rrajcë-Dragostunjë) flet qartësisht për lëvizjen e gjindjes shqiptare nga Veriu drejt Shkumbinit. Këtë e vërteton shenjimi *Gegë* (gegë çobani) që i bëhet rrëmbyesit nga e rrëmbyera. Shenjimi flet për rrëmbyesin e ndryshëm (nga pikëpamja fisnore dhe etnografike) prej së rrëmbyerës dhe më gjerë, e ndryshëm në pikëpamjet e mësipërme edhe me bashkësinë tjetër ku vjen dhe përzihet përgjatë vijës luginore të Shkumbinit. Kështu fisi *Gega* në anën e djathtë të lumit Shkumbin (Rrajcë-Dragostunjë) është shumë i hershëm. Ata kanë ardhur nga Veriu, janë përzier me banorët e Luginës, por mbetën të shenjuar si *Gegë*, pra si të ndryshëm.

Po në anën e majtë të vijës luginore të Shkumbinit çfarë ndodh? A vërtetohet edhe andej, përgjithësisht apo përafërsisht, në mënyrë simetrike, i njëjti kah lëvisjeje; nga Jugu drejt Shkumbinit? Me sa duket edhe andej ka ndodhur simetrikisht e njëjta gjë. Dialektologët Vërçën e Gramshit e veçojnë si një zonë tipike kalimtare. Pikërisht në këtë zonë (në fakt shumë përtej anës së majtë të lumit Shkumbin) haset dendur fisi Toska. Banorët me këtë emër fisnor që jetojnë në Stravaj të Librazhdit, thonë se kanë ardhur aty pikërisht nga Vërça e Gramshit. Fakti që edhe këta janë të shenjuar si *Toskë*, pra të ndryshëm nga bashkësia vendase në të majtë të Shkumbinit, tregon se ata janë të ardhur aty nga Jugu i Shqipërisë dhe janë përzier e integruar me vendasit. Edhe në këtë rast nuk mungojnë motivet e rrëmbimit të vajzave. Këtë e dëshmon një këngë tjetër e mbledhur në Rrajcë, por e kënduar në variante të ndryshme në shumë fshatra të anës së majtë të Shkumbinit. Edhe pse me mbishtresime të periudhave të mëvonshme historike, kënga dëshmon rrëmbimin si më poshtë:

Ti moj Xhixho, ti moj lule
Selman Toskun çe sëmure
Selman Tosku tha një fjalë
Xhixhon nuk e le pa marrë.

Folja *marr* në këtë rast, mendojmë se ka idhje nga ana semantike (kuptimore) me atë kohë të largët, kur ajo shenjonte rrëmbimin e gruas (vajzës) dhe jo martesën e saj me të, siç e ka kuptimin sot.

Në këndvështrimin e analizës së mësipërme, nga të dyja këngët folklorike, të kënduara më së shumti përkatësisht majtas dhe djathtas vijës luginore të Shkumbinit, vërtetohet pohimi ynë se *Shkumbini dhe Lugina e tij nuk i ndajnë në pikëpamje gjuhësore dhe kulturore shqiptarët: përkundrazi, i bashkojnë ata.* Jemi në terrenin e përshtatshëm të Shkumbinit dhe luginës së tij si rrugë e përshtatshme natyrore për dalje drejt perëndimit. Sigurisht që dalje të tilla, doemos të shpeshta, bëheshin jo vetëm për aventura martesore të dasmave me rrëmbim, por edhe për motive të tjera. Ardhësit, në të dyja anët e vijës luginore të shkumbinit, qoftë edhe rrëmbyesit e vajzave, dikur nuk u tërhoqën në thellësitë veriore apo jugore prej nga vinin sipas rastit. Ata ndonse të ndryshëm, si *Gegë* në anën e djathtë dhe si *Toskë* në anën e majtë të Luginës, mbetën aty dhe u përzien me vendasite vijës luginore. Se ç'ishin vendasit që në të djathtë dhe në të majtë të Luginës së Shkumbinit i shenjonin ardhësit sipas rastit, në *Gegë* dge *Toskë,* kjo do të donte formulimin dhe vërtetimin e një pohimi apo teze tjetër.

***

Lëvizjen e tillë, përzierse, të gjindjes shqiptare, majtas dhe djathtas Luginës së Shkumbinit, e sjell si figurë poetike edhe poeti i ndjerë Koçi Petriti, i cili, me plot arsye, mund të thirret ndër të tjera, edhe poeti i kësaj Lugine.

Kur bënte fjalë për poezinë e tij *Balada e urës,* ai na thoshte të mos e lexojmë atë thjesht si një baladë dashurie. Sipas tij, ky do të ishte leximi më i përciptë i saj. Poezia në fjalë është shkruar në vitin 1980 dhe ngrihet mbi fabulën e një djali dhe një vajze, matanë e më këtë anë Luginës, bashkimin e të cilëve e pengontë Shkumbini valështumë. Por drama e tyre nuk ishte thjesht drama e dashurisë së pamundur, për shkak të pengesës natyrore; ajo ishte parasëgjithash një dramë keqkuptimi. Për shkak të pengesës, mesazhet zanore gjuhësore tjetërsoheshin, madje në kuptim të përkundërt si më poshtë:

O të dua-nisej fjala
Jo s'të dua nisej zallit
Vajva thosh : Më piftë vala
Të përpiftë i bëhej djalit.

Zgjidhja e fabulës së kësaj poezie ka në themel sakrificën humane për tejkalimin e sfidave të komunikimit dhe realizimin e tij në emër të dashurisë. Kështu duhet ta lexonim ne, sipas poetit të ndjerë Koçi Petriti, poezinë e tij *Balada e urës*, prandaj ai na orientonte më shumë tek katrena e fundit e kësaj poezie.

Zgjatën duart vunë gurë,
shtruan dhimbje që nuk thuhen,
gur mbi gur u bëbë urë,
të kalojnë ata që duhen.

Duke e mbyllur, shohim se është momenti për të thënë se me poezinë *Balada e urës,* ku ai shtjellon poetikisht, sipas mënyrës së tij, idenë e sfidave të komunikimit të gjindjes shqiptare matanë e më këtë anë të Shkumbinit, ka qenë poeti i ndjerë Koçi Petriti ai që ka artikuluar për herë të parë pohimin: *Shkumbini dhe Lugina e tij nuk i bashkojnë dhe nuk i ndajnë shqiptarët.* Ky është një ndër rastet e shumta se si ai, poeti e rizbulon poetikisht natyrën e bukur të Luginës së Shkumbinit dhe historinë e saj.

SHOQËRIA E SPEKTAKLIT DHE LIBRI

Nga Xhevair Lleshi

Eqartë, do të qe më mirë të jepnim një panoramë pak më të gjerë të shfaqjes në treg (duke sunduar) të *shoqërisë së spektaklit*, thelbit të saj, karakterit që bart dhe lëvizjes kulturore, tiparet e saj dhe faktit **pse kjo shoqëri** nuk e do **kulturën** dhe për më tepër **librin**. Shoqëria shqiptare sot është futur në binarët e shoqërisë së spektaklit, jo me dashjen e saj, por si rrjedhojë e një diktati shtetëror, planit të pabesueshëm të qeverisë për të ecur në këtë linjë dhe për të sunduar nëpërmjet paraqitjes së rremë të realitetit, nëpërmjet tiranisë shkëlqimtare të mediave, bazuar tek lustra, e bukura, forma e jashtme, ngjyrat, entuziazmi - ndonëse sa për sy e faqe dhe krejt bosh. Vetëm atëherë mund të hyjmë në temën e librit dhe marrëdhëniet e kota, të dobëta edhe kur krijohen dhe në fund ato janë vendosur gjithmonë përpara zjarrit.

Një nga kënaqësitë e shoqërisë së spektaklit (e shoqërisë socialiste në tërësi, por mbi bazën e pronës së re të krijuar prej grabitjes - prona pa prejardhje, e pasigurt dhe e ngritur pa baza ideologjike [pra pa ideologji!] dhe të fryrë kot së koti) ka qenë të zhvishet përpara pasqyrës së vetë shoqërisë, ku ajo mund ta shohë veten nga koka te këmbët. Nudo. Edhe po të jetë e veshur i rrëzon të gjitha rrobat përtokë, pastaj, cullak, harrohet për një kohë të gjatë, duke soditur e mrekulluar trupin e vet. Kjo kënaqësi i kthehet në një pasion aq sa, bie në ekstazë prej pamjes së saj të lakmueshme e sidomos për atë vijën e butë të formave të trupit, që e bëjnë edhe serioze, edhe të vëmendshme, edhe të zhytur në dashuri me vetveten. Kaq do të mjaftonte të kuptonim se shoqëria e spektaklit është narciste, ndonëse shfaqet krejt e përhumbur, ndërsa ajo as kokën nuk e lëviz për të parë nga vjen e ku shkon...

Në formë të përmbledhur **Guy Debord** e jep në këtë formë thelbin e **Shoqërisë së Spektaklit**: "Spektakli është fjalim i pandërprerë... një monolog vetëlavdërimi, që sistemi i tanishëm bën mbi vetveten."

Nëse gjithë shoqëria bën këtë çdo sekondë, nëpërmjet mediave, punës zyrtare, analizave të munguara, mosdhënies llogari para zgjedhësve që i kanë prurë të pushtet, nëpërmjet manipulimit total të zgjedhjeve dhe gjithë sistemit shoqëror në tërësi, atëherë kemi një sistem shoqëror të tërë që luan me paraqitjen, ngjyrat, bojërat, vijat, format që e bëjnë një objekt ose një tërësi të tyre në forma mahnitëse, të bukur, të pëlqyeshme, që të krijon iluzionin se ashtu qenka. Pra pa bërë asnjë punë, pa krijuar asgjë, thua se ajo ekziston, saqë edhe kur bën... një vezë, thua se qenka përmbysur dynjaja, prej kësaj vepre.

E gjithë shoqëria bën sikur habitet me gjoja të nxehurën e saj. Këtë gjë ajo e bën edhe për qejfin e saj, por sidomos për të tjerët. Si të thuash duke dashur që të shihet sa më mirë në pasqyrë, ajo ndez dritat gjithandej, bën lojën sikur ha inat, sikur ka nerv, por, pasi lë t'i rrëshqasë këmisha në fund të këmbëve, ajo ndalet papritmas, "e shqetësuar" për një çast, me disa pyetje njëherësh që mezi ia mbajnë buzët. E qeshura e të gjithëve, dihet, i shungullon në kujtesë, atë s'e lë të qetë asnjë pikë dyshimi. Shpifja - gjë e zakonshme... Edhe zbukurimi, eleganca, kostumet dhe prerjet e reja, paraqitja tri-katër dhe pesë dimensionale, në lëvizje, si një kurth i skajshëm që në të vërtetë e mban në këmbë. Madje duke krijuar idenë se këto në vetvete janë edhe shtyllat e hakmarrjes.

Shoqërinë e spektaklit e ngre në këmbë politika për interesat e saj, që, duke "punuar", e rivret njeriun duke premtuar ringjalljen. Por mos harroni se me këtë skenar të tmerrshëm, pa lëvizur asnjë pejzë në fytyrë, mashtrojnë duke kërkuar që armën t'ua japim ne, populli, sepse nesër, në fjalimet e gjata kjo ka për të qenë esenca e gjithë premtimit madhështor, dogma, opiumi, përndryshe askush s'mund të thotë dot një fjalë, ndërkohë që edhe nuk derdh dot asnjë pikë loti. Madje edhe po të kujtohet për të qenë në rreshtin e parë të protestës, duket sheshit që shpirti i tij është tharë, është bërë eshkë. Përfytyroni: një shoqëri e tërë e bërë në

këtë gjendje. Njëlloj sikur t'ia kërkosh nervin kufomës që edhe një puhizë të fryjë e shemb, madje e asgjëson. Edhe librat e shkruar janë të tillë, si jeta vetë, si personazhet që përshkruajnë. Por librat e marrin sërish fjalën duke u shtirur si indiferentë. Madje edhe të pyesin: Hë, pra, i dashur, cili është mendimi yt? Kështu që edhe politika, edhe libri, teksa prekin nervin e dhimbjes, nuk arrijnë ta përcjellin këtë te njeriu, pensionisti, punëtori i krahut, intelektuali, polici, ushtari, peshkatari, bujku, ndërtuesi...

E gjithë shoqëria, pa lënë pas dore gjë prej gjëje, edhe ajo e jona e spektaklit të manipuluar më rëndshëm se kudo tjetër, qëndron ashtu, krejt lakuriq. Shoqëria e spektaklit në një libër është historia e një prostitute që rrjedh nga prindër pijanecë, me gjak të përzier me një trashëgimi të thatë mjerimi dhe alkooli, që, në rastin e saj, ka marrë trajtën e një ekzagjerimi apo çrregullimi nervor, të instinktit të saj seksual. Mos harroni ajo është shtatlartë, e bukur, me një trup perfekt, që urren të lypurit dhe përbuzjen, ndonëse prodhim final i të cilave është edhe vetë. Dhe nënkuptohet që e gjithë kjo kalbësirë sociale, lihet të fermentohet në popull, si qelizë që kalb krejt shoqërinë. Dhe mos harroni kurrë, e gjithë kjo arrin të bëhet një forcë e natyrës, një ferment shkatërrimi, pa e dashur vetë, diçka thelbësisht korruptuese, duke çorientuar e çorganizuar rininë, së cilës ia ka futur hidhërimin në gjak dhe e sjell rrotull vetes... Madje kthehet në një shëmbëlltyrë.

Shoqëria jonë e spektaklit e gjen krahasimin me atë të mizës, një mizë ngjyrë dielli, e rritur nëpër plehra, një mizë që merr vdekjen nga kërmat përgjatë rrugëve, dhe, zukatëse, kërcyese, duke hedhur një vezullim gurësh të çmuar, helmon burrat dhe gratë thjesht duke qëndruar mbi ta, duke hyrë nëpër pallate nëpërmjet dritareve.

Pastaj shoqëria vetë, edhe e trembur pse jo, ngre kokën, sytë të fiksuar, duke vështruar zjarrin. Po zjarrin kush e shpiku, të paktën kush e solli?...

Askush nuk jep një përgjigje. Duket se do që ta lexojë edhe njëherë vetë këtë farë krijimi. Dhe me siguri një ndjesi të ftohti i kalon nga koka te shpatullat. Kjo paraqitje sociale, edhe si thelb i shoqërisë, edhe si përmbajtje libri, nuk është shkruar për t'u kthyer në vlerë, apo për t'u hedhur në plehra, për të qenë e vërteta njerëzore që e përdor njeriun si kukull, po prej djallit vetë, me marifete frazash, një vërshim fjalësh të papritura dhe përherë ekstravagante. Megjithatë, djalli, strumbullari i shoqërisë, prijësi, qëndron i mbërthyer prej asaj që sapo lexon, papritmas, zgjon brenda tij gjithçka që ai ashtu ka dashur të jetë. Mendo vetëm kaq: shteti vetë nuk paguan energji elektrike në të gjitha institucionet e tij dhe fut në burg një njeri që jeton me mjete fare minimale, i uritur, pse ka përdorur pa pagesë energjinë elektrike... Shëmti e gjallë, e mbuluar me drita verbuese të energjisë së vjedhur nga vetë shoqëria e spektaklit.

Atëherë, vetë **shoqëria** (aty është edhe **libri**, doemos, në të gjitha format e tij!) ngre sytë. Gjithçka vazhdon të jetë e zhytur në adhurimin e vetvetes, përpara pasqyrës. Për të qeshur e për të qarë, shoqëria anon qafën, për të parë më mirë një njollë të vogël, të errët, sipër gjinjve të saj të fryrë, në të djathtë ose në të mëngjër dhe e prek me majën e gishtit. Pa dyshim vetë shoqërisë sonë të spektaklit kjo shenjë i duket e këndshme dhe e bukur, në atë vend.

Pastaj zë e studion pjesët e tjera të trupit të saj, e kënaqur, e rrëmbyer nga kureshtja, si vesi i mahnitshëm i një fëmije. Kjo e çudit gjithmonë e më tepër, duke përftuar kësisoj pamjen e hutuar, tronditëse të një vajze që zbulon pubertetin e saj. Me ngadalë hap krahët për të mbështjellë trupin prej perëndeshe plot shkëlqime, përkul shtatin, për të vrojtuar përpara dhe prapa, duke u ndalur në profil për të parë nga ai pozicion gjoksin dhe trupin. Dhe e përfundon kënaqësinë e saj me një lojë të çuditshme, duke tundur majtas e djathtas gjunjët, trupi që rrotullohej nga beli e lart, me fërgëllimat e vazhdueshme të një valltareje orientale që kërcen vallen e barkut. Pak a shumë kjo është ajo që themi: pika tërheqëse e shoqërisë së spektaklit të verbon, të tërheq, të bën për vete dhe, dhimbshëm, i heq nervin gjithë shoqërisë, e bën atë as acaruese dhe as kundërshtuese. E kthen në hutim të gjallë, të nënshtruar me gjithsej.

Kur je duke e vështruar thelbin e shoqërisë së spektaklit, e sodit: ajo të fut frikën. Duket se çfarë kishe në duar nuk e ke më, je kthyer në pjesë të shoqërisë edhe ti vetë, madje e merr me të qeshur teksa vë re se e gjitha që zotëroje (temperamenti, karakteri, cilësitë e personalitetit) të kanë rrëshqitur nga dora. Në atë çast shikon edhe njëherë veten ashtu siç është dhe ajo i pështiroset. Ja si erdhën punët: brenda kaq pak vitesh, spektakli (paraqitja e shtrembëruar, duke e jashtëzakonshme si iluzion), ia ka bastarduar jetën dhe tani ndihet e prishur dhe e zvetënuar deri në palcë prej atyre pisllëqeve që as do t'i kishte menduar ndonjëherë më parë. Gjithçka duket se është e destinuar të kalbet brenda vetes, në këto momente, madje duke zaptuar çdo qelizë jetëdhënëse.

Spektakli, si thelb i shoqërisë, përfton ndonjë çast kthjellimi të ndërgjegjes për ta parë të keqen në sy dhe vë re çrregullimin që ka sjellë ky fermentim: ai qenka helmuar, gjithçka që e rrethon është shkatërruar (ka mbetur gjallë vetëm brohorima dhe më tej oshtima e saj!), një pozicion shoqëror që thyhet e vithiset. Dhe, pa mundur t'i shkëpusë sytë prej lakuriqësisë së vetë dhe të krejt shoqërisë, spektakli e vështron ngultas, përpiqet ta imponojë veten që të mbushet me neveri qoftë edhe për lakuriqësinë e shfaqur në atë farë feje.

Shoqëria e spektaklit, sidomos kjo jona, dihet që ajo sundon botën, bën edhe pushimet e ndërmjetme, çlodhet. Dhe duket sikur nuk lëviz më. Por ai që vëren e sheh qartë se ajo, me njërin krah prapa, te zverku, njëra dorë kap tjetrën, ngre lart kokën, me bërrylat larguar nga njëri-tjetri. Dhe sheh sytë e saj gjysmë të mbyllur, gojën pak të hapur, fytyrën e kredhur në një qeshje (shpesh edhe përqeshje!) dashurore; kurse, nga pas, masa e madhe e flokëve të verdhë e të përhapur, ia mbulon kurrizin si me një krifë luaneshe. E përkulur dhe me ije të tendosura, ajo ngjan me mbretëreshat amazona, me një gjoks të fortë prej luftëtareje, me muskuj të fuqishëm nën lëkurën e butë. Pastaj, një linjë e hollë e delikate, me një valëzim të butë zbret nga shpatullat, te gjoksi, te kofshët e deri poshtë te këmbët. Dhe pas këtij pushimi çlodhës merr formë përshtypja e lënë pas. S'prish punë premtimi. Fol. Gri sallatë. Mposht edhe veten. Bëj ironi sa të duash. Ngjitu edhe në degët e sarkazmës, puthe me to, jargavite, shpik të tjera hile, ose edhe "llafe bufi - xha Isufi!". S'prishet punë! Çdo gjë çon ujë në mullirin e tij. Populli pa pikën e nervit argëtohet. Madje spektakli sapo tha se bibliotekat ka kudo tek ne! Por ne e dimë të gjithë se e vërteta e një shoqërie të shëndoshë sociale është e fshehur tek bibliotekat...

Mirëpo kushdo prej nesh ndjek këtë profil kaq të bukur, ato linja të trupit që kthehen në rreze të praruara, ato forma të rrumbullta ku flaka e brydhët hedh reflekse mëndafshi.

Ndaj dhe sjell ndër mend frikën e tij të vjetër për gruan, për llojin e librit që mban kurdoherë me vete, epshndjellëse dhe të egër, njëkohësisht. "Mos kujtoni se do të shpëtoni nga librat", nga Zhan-Klod Karrier & Umberto Eko. Dhe njeriu përplaset keq me vetveten.

Vetëkuptohet që gjithçka është e dukshme te çdo gjë intime, që merr papritur forcë dhe energji, në gjithë fryrjet masakruese e të thelluara prej lugjeve të thella, që i japin misterin tronditës e sugjestionues, në gjithë vagëllimin e tyre. Kjo është edhe e pavetëdijshme si forcë, që vetëm me aromën e saj shkatërron botën. I ngarkuari me punë, domethënë pushteti, vështron i fiksuar, i turbulluar, gjersa mbyll qepallat, që të mos shohë më, as edhe hijen e librave, ndonëse pak më parë ka ulëritur fort e fort për ekzistencën e bibliotekave! Mos vallë e ka zënë turpi? Mirëpo të gjithë e dinë se shoqëria e spektaklit zotëron mjeshtërinë e kurvës, një pushtet i hatashëm mbi të bukurën dhe një sugjestionim shkatërrues. Përsëri del pambarimisht në thellësinë e hijeve të ekzistencës, më e madhe, më e tmerrshme, më sugjestionuese në qëndrimin e saj dhe kushdo e kupton qartë se tani është aty, përpara syve të të tu me gjithë trupin e saj, përgjithmonë. S'ka më turp, madje është turp që të kesh turp!

Shoqëria e spektaklit kruspulloset në vetvete. Një fërgëllimë dhembshurie duket se ka kaluar nëpër gjymtyrët e saj. Sytë i ka të lagur, ajo mblidhet e zvogëlohet, si për t'u ndier më mirë ashtu. Pastaj, i lëshon duart, duke i rrëshqitur lehtazi gjatë trupit deri tek gjinjtë, të cilët i shtyp me një shtrëngim nervoz. Pastaj tretet në një vetë-përkëdhelje, të të gjithë trupit të saj, e kënaqur, njëherë më faqen e majtë, pastaj në të djathtën. Goja e saj epshore fryn mbi gjymtyrë vetëm dëshirë, epsh. S'duron dot, zgjat buzët dhe puth veten gjatë në zonën e gjoksit, duke i qeshur pasqyrimit, me një vetëlavdërim të hatashëm, po ashtu edhe me një vetëpëlqim që të eksiton, të çon drejt orgazmës sociale!

Atëherë, edhe ti i dashur lexues, e ndien që shoqëria e spektaklit psherëtin ngadalë, gjatë. Kjo kënaqësi vetëm sa ia merr shpirtin. Papritur, të gjitha zgjidhjet që janë menduar, qenë rrëmbyer e flakur jashtë nesh, si nga një erë e fortë. Vrulli i një pasioni të paparë, të egër, bën që të kërcejë dhe të sulet drejt vetvetes, e mbërthyer dhe e shtrënguar në gjoksin e vet dhe shtrihet në tapet.

Po lëndohet! Nën një hënë e zbehtë, nëpër drurët e vdekur dhe eshtrave të tyre shoqëria e spektaklit shkruan dramën e kohës, këngën e siemrit të saj që zbret si limfë e derdhur ajrit, duke hyrë në shpirt dhe në shpërfillje të plotë të dëgjimit.

Thirrja jote e brendshme se me jetë na kanë mashtruar dhe se pa jetë janë duke na lënë, është e ndërgjegjshme edhe për disfatën, edhe për shkatërrimin e vërtetë të njeriut, të gjithçkaje që të paktën e zotëronte si pjesë përbërëse të qenies. Kushdo prej nesh e shikon në të marrëzinë, hipokrizinë, poshtërsinë dhe gënjeshtrën, por prapë e do, edhe pse është e helmuar. Në një farë mënyre sikur ia largon vuajtjen, e bën me një personalitet të përkohshëm... Sidoqoftë, herë-herë duket se e mbledh veten. Kupton. Analizon. Përtypet. Ripërtypet. Dhe përsëri prej masakrës së mediave bie sërish nën këtë efekt turbullues. Të vërtetat të trembin. Të gënjeshtërtat të joshin...

Kur të pyesin pastaj për thelbin e asaj që ndodh rreth e qark përgjigjet turbull-turbull, ngaqë s'ta ka qejfi që të ndodhë ndonjë skenë e pakëndshme, pikërisht tani. Skenat e pakëndshme të protestave? Ulërimat! Thirrjet! Nga ana tjetër, ia pohon vetes se ia di edhe ndonjë pikë të dobët të shoqërisë së spektaklit. Pas kësaj, bie një heshtje e gjatë mes nesh, gjatë së cilës vrasim mendjen sesi ta heqim qafe këtë kalbësirë, me pamje verbuese. Edhe pse duket e fortë dhe e lakmuar, ajo s'ka fare rrënjë, është kërpudhë. Por ama gjithçka e ka të bukur. Ngashënjim që duket se të vjen vetëm një herë në jetë. Diçka që të tremb, po edhe të bën për vete... Pa fare filozofi, pa përmbajtje, pa kërkime të thella, por gjithnjë elegante, pipëlimë vese, energji e shtrembëruar, pataksëse, e tmerrshme. Askush s'do të shprehë dëshirë dhe urrejtje që ka jetuar në Shqipëri në shoqërinë e spektaklit. Me dhe pa jetë. Me dhe pa libra...

Tiranë, më 11 shtator 2024

Dritarja e Marin Shkrelit: Retrospektivë mbi fatin e individit dhe qenësinë e një kombi

Nga Rrezarta Morina

Në kryqëzimin e fateve njerëzore, "eklipset" historike, me derivimin e konsekuencave të ndjeshme e fatale për individë e kolektivitet, kanë ushqyer artin e krijimtarinë që në kohërat e hershme. Ideja e Aristotelit për artin si imitim të realitetit a konceptimi i funksionit utilitar të artit nga Platoni, meqë siç shprehet studiuesi Rugova se *çështjen e artit, Platoni e merrte si res republica, si gjë publike, si çështje apo interes të përgjithshëm*[1], gërshetuar në praktikë me veprat si "Iliada", mëtojnë lidhjen e ngushtë mes letërsisë dhe fateve njerëzore, individit, një shoqërie, një kombi.

Për një komb, në themelet e të cilit qëndron kalvari i gjatë i ngjarjeve e peripetive historike, edhe krijimi i një letërsie peshkon nëpër po këto 'ujëra historike'. E vendosur brenda një rrethi të tillë historik, edhe në gjenezën e letërsisë shqipe përvijohen gjurmë historike. Megjithatë, ndonëse në fillim e stisur mbi fakte e histori si imponim i kohës, autorë të letërsisë së sotme, si Ndue Ukaj, qëllimshëm i kthehen historisë, realitetit duke gjurmuar brenda tij esencën e temave universale, problemeve filozofike që lidhen me njohjen, depërtimin drejt vetes, tjetrit, shoqërisë e kombit.

I ngjizur brenda ceneve të historisë së popullit shqiptar, "Dritarja e Marin Shkrelit" është një rrëfim retrospektiv mbi të kaluarën e dhimbshme, fatin plot tragjizëm, katrahurën e krajatat shpirtërore, fizike e psikike të një individi – Marin Shkrelit dhe një kombi – popullit shqiptar të Kosovës. Lufta e fundit në Kosovë në harkun e një decenieje të plotë (përfshirë periudhën që nga suprimimi i autonomisë e gjer në përfundimin e luftës) bëhet konteksti krucial kohor i ngjizjes së këtij romani. Duke piketuar një periudhë sa të ndjeshme e aq intense të popullit të Kosovës, ky roman bëhet mishërim i një prizmi emocional ngjyrimesh të ndryshme; pasqyrë ku parakalojnë e dokumentohen episode, anipse të shkurtra, të peripetive fizike, përhumbjes shpirtërore të qenieve si individë e si komb. Me penelatë të hollë e fine, herë-herë të detajuar, por përherë të gërshetuar me një patos të sinqertë, autori Ndue Ukaj portretizon imazhin e ankthit, frikës, dëshpërimit dhe vuajtjet e një kombi të pafat, derisa njëkohësisht paralelizon gravurat e agresorit, ku objektivisht mbërthehet karakteri antagonist i tij, nëpërmjet akteve plot mllef, dhunë, sadizëm e mizori.

"Deri më tani, as ne dhe as të parët tanë, s'kemi pritë mëngjes pa trishtim e mbrëmje pa ankth. Zgjoheshim pa e ditë se si do të na zinte muzgu i mbrëmjes dhe na përpinte errësita me tingujt e saj të frikës, pa e ditë se çfarë do të prisnim në mëngjesin e ri. Dhe këto dilema për ne s'ishin njëlloj si për pjesën tjetër të botës, kishin trajtë tjetër, ishin dilema të tmerrshme e mizore, të një jete të shtypur e tinëzare, që ishte më pak se jetë, një hije e jetës së vërtetë."[2]

Paragrafi me të cilin fillon ky roman është ndërfutje eksplicite në botën e përvuajtur të popullit shqiptar, që sa shkon e detajizohet nëpërmjet ilustrimit deskriptiv të episodeve të ndryshme për të shpërfaqur për lexuesin dromca të realitetit shqiptar, sepse, siç pohon studiuesi Ag Apolloni, *për nga gjallëria e përshkrimit, letërsia është më e vërtetë se historia.*[3]

Strumbullari i fakteve dhe ngjyrimi historik mbi të cilin ndërtohet romani megjithatë nuk mbesin vetëm si dekorim, rekuizitë që duhet t'i shfaqet publikut për të përftuar një lloj katarsisi, mirëpo funksionalizohen në shpërfaqje të një ideje më të madhe, më kruciale për autorin, protagonistin, vetë kombin shqiptar – idenë e qenësisë, identitetit, ekzistencës: kush është Marini, kush janë shqiptarët, kush është qenia njerëzore?

"Marini shijon ndjenjën e pakëndshme të krizës identitare të shqiptarit, që zgjohet perëndimor e bën ditë si oriental e bie në gjumë në ëndrra kozmopolite, të shqiptarit që përherë e përkundin të tjerët në një djep, që as ai s'e di kush ia ka ndërtuar."[4] – thuhet në roman, duke dëftuar kështu idenë e kërkimit të identitetit, kërkim ky që derivon nëpërmjet evokimit në histori, kujtesë, përballë kërcënimit të harresës.

Kësisoj, "Dritarja e Marin Shkrelit" është artikulim prozaik i hapjes së një dritareje të së kaluarës, nga e cila, përballë kornizës së kohës së tashme, evokohet e kaluara individuale e përmes saj edhe ajo kolektive. Duke rikujtuar deceniet e urëkalimit prej adoleshencës në moshën e maturisë, Marini pasqyron rritjen e kolektivitetit, botës e historisë shqiptare. Duke gjurmuar të kaluarën, Marini përpiqet të gjejë veten e së tashmes, shqiptarin e të sotmes.

Brenda tronditjes, rrënimeve të së kaluarës së shqiptarëve e vetë Marinit, romani përcjell edhe mjegullimën identitare për të ardhmen dhe brenda këtij procesi e këtij dualiteti kohësh gjallojnë jo pak tema kruciale, artikuluar përmes aktivizimit të një metagjuhe plot ekspresivitet e referencialitet.

Sistemi dualist i rrëfimit

Që në konceptimet aristoteliane është përcaktuar diferencimi mes historisë e letërsisë, megjithatë ky diferencim nuk ka përjashtuar difuzionin, vënien e historisë si produkt të veprave letrare. Edhe në këtë roman, arti, letërsia zbatohet si mjet i regjistrimit të çasteve kruciale të rëndësisë personale (momente të Marinit) e kombëtare (përlitje për fatkeqësinë e shqiptarëve në kohën e luftës). Është Marini, që përmes krijimit të një blloku shënimesh, me shpalosjen e ndjenjave e mendimeve manifeston rëndësinë, relacionin sublim mes artit e historisë, ngase siç konsideron studiuesi Apolloni *fiksioni është një organizëm i gjallë që s'jeton dot po s'u ushqye nga faktet.*[5]

Relacioni mes artit e kontekstit historik të kohës, i nënkuptuar edhe si relacion mes historisë e letërsisë, faktografisë e fiksionit është hallka e parë dualiste që prodhon edhe hallkat e tjera, të cilat ruajnë veçorinë e dualizmit. Faktikisht, i gjithë rrëfimi, inkorporimi i të gjitha temave që shpalosen në mënyrë zinxhirore brenda romanit realizohet si dualizëm, si çështje që kauzalisht e lindin njëra-tjetrën, por që njëkohësisht integrohen përmes një kontrasti, antagonie, si tema të dy polesh e prizmash të kundërt, e që megjithatë brenda tyre funksionon jeta, ekziston individi dhe shoqëria.

Dualizmi harresë-kujtesë: Markuar si konflikti qendror që katalizon ekzistencën e mikrotemave brenda romanit, dualizmi mes harresës e kujtesës realizohet si një konfrontim i vazhdueshëm i kujtesës përmes aktivizimit të artit. Ideja e këtij dualizmi lind në situatën inicuese të kohës së tashme të Marinit. Në subjektin e thjeshtë të së tashmes, Marini tashmë i moshës mbi 50 vjeçare, paraqitet në momentet e marrjes së vizës, si mundësi largimi nga vendi, mirëpo po ky moment katalizon të kaluarën, tashmë të harruar nga Marini për mbi dy decenie, harresë për të cilën është i vetëdijshëm edhe vetë Marini. Kësisoj, mundësia e largimit fizik nga atdheu bashkëdyzohet me harresën tashmë prej dy dekadash të së kaluarës dhe Marini kujtohet *të kujtojë*.

Në kandarin e Marinit, harresa intonohet si tëhuajësim i njeriut prej vetes, prej qenies, ndaj është i madh pendimi për vënien prapa krahëve të së kaluarës së vet e të popullit të vet, sado e trishtë ajo e kaluar:

"Marini sa më shumë e thellon shikimin në të kaluarën, aq më shumë pezmatohet, aq më shumë ajo i bëhet e paqartë, e zvetënuar, gati-gati e panjohur. E tmerrshme të mos njohësh jetën tënde, vetveten, pohon dhe e tund kokën, si një pemë të cilën do ta shkundë e të mbledhë çka ka mbetë në të, ndonjë frutë gjysmë e kalbur."[6]

Marini është i vetëdijshëm se harresa për dhembjet e trishtimin e periudhës së paraluftës e luftës së fundit në Kosovë mund të ngjallë pikëpyetje në identitetin e një njeriu e një shoqërie, por është i vetëdijshëm se ky identitet mund të kthehet dhe ta luftojë harresën përmes kujtesës. Ndaj, në zgrip të largimit fizik dhe tëhuajësimit shpirtëror nga e kaluara, Marini nis të kujtojë dhe përmes rrjetës së ngjarjeve, episodeve të luftës, që nga periudha e një autonomie të gjymtë, suprimimit të asaj autonomie, invadimit dhe krimeve serbe në Kosovë, artikulon një pjesë të identitetit shqiptar e atij vetanak, kalitur e 'përndritur' përmes vuajtjeve e dhembjes.

"Domethënë, historia ka rëndësi, domethënë, kujtesa është e domosdoshme që të kuptojmë kush jemi, kah kemi ardhë, kah jemi?"[7] – shtron pyetjen Marini, duke qenë plotësisht i vetëdijshëm se 'hulumtimi', evokimi pas në kohë për të njohur rrënjët është e vetmja mënyrë e njohjes dhe determinimit të së ardhmes së një individi, e aq më tepër një shoqërie e një kombi. Ndaj Marini kujton, sjell për lexuesin eksodin e dhimbshëm të jetës së tij dhe popullit shqiptar ku mishërohen humbja, dhuna, përdhunimi, vala e refugjatëve, migrimi, demonstratat dhe përballë gjithë këtyre dashuria, shpresa për liri, çlirimi dhe në fund të kësaj kujtese – Kosova e sotme, ilustruar në gati të gjitha rrafshet esenciale të jetës e ekzistencës.

Dualizmi luftë – dashuri: Në kujtesën e shpalosur, të kërcënuar nga harresa, kujtimet e luftës së fundit në Kosovë janë ato që dominojnë pjesën evokuese të Marinit dhe po këto kujtime influencojnë e determinojnë fatin e tij dhe të shoqërisë sonë. Nëpër të gjitha format me të cilat lufta shfaqet, që nga paranoja serbe dhe përbuzja e vazhdueshme ndaj shqiptarëve, kërcënimet verbale e gjer në dhunën e shfaqur në episodet e ndryshme, lufta artikulohet si forcë shkatërruese. Në kujtimet e Marinit lufta vjen si kataklizmë që masakron (përmenden masakrat në Drenicë dhe anembanë Kosovës), përdhunon (viktimë e përdhunimit bëhet edhe vetë Donika, gruja e Marinit, bashkë me të ëmën e saj) përzë (të detyruar nga policë serbë e nën dhunën e armëve, Marini dhe familja e tij shndërrohen në refugjatë, duke u përzënë nga shtëpia e duke i nisur në kufirin me Shqipërinë e më vonë drejt Amerikës). Për Marinin, në të gjitha rastet lufta është e papranueshme, sepse përceptohet si fuqi e të fortit mbi të dobëtin, ndaj vetëm kur përmenden sulmet e NATO-s mbi caqet serbe Marini shpreh ekzaltim, jo pse promovon luftën, por sepse e sheh si thirrje, ringjallje të drejtësisë. Megjithatë, përjashto rastin e fundit, sipas këtij romani në qendër të një lufte qëndron mania e njeriut, e një shoqërie që të zë një vend në histori:

"Njeriun e tmerron ideja e zhdukjes, prandaj s'rresht së kërkuari forma për mbijetesë dhe kundrejt së cilës është në gjendje të bëjë gjithçka, madje edhe krime makabre."[8]

Kundërpeshë të luftës, kujtesa e Marinit nxjerr dashurinë. E manifestuar si dashuri familjare dhe si dashuri intime mes Marinit e partneres që zgjedh, dimensioni erotik artikulohet si mburoja në të cilën Marini gjen shpëtim. Përtej realitetit të shkatërruar nga lufta e kërcënimit të vazhdueshëm të tanatosit, erosi i sjell Marinit frymën, lirinë, duke krijuar Edenin, kopshtin ideal në të cilin zhvillohet jeta paralele, brenda suazave të normales:

"...në sytë e saj hapeshin qiejt më të bukur të jetës; sepse te sytë e saj shihte perandorinë e gëzimit shumë më të madh se të gjitha vuajtjet përreth."[9]

Grandioziteti i dashurisë (nisur me Teutën e përfunduar me Donikën) ruhet gjer në fund dhe natyra sublime e dashurisë si emocion vuloset me sakrificën e Marinit për dashuri – kthimi i tij nga Amerika, heqja dorë nga jeta e lirë për ta kërkuar Donikën në Kosovën e pasluftës, përkrahja shpirtërore dhe empatia e simpatia për Donikën e dhunuar nga forcat serbe dëftojnë shenjat e një dashurie sublime dhe glorifikojnë dashurinë si emocion.

Dualizmi frikë – shpresë:

"Frika si rriqër e keqe kishte hyrë thellë në të dhe ia thithte energjinë e paktë të mendjes e të zemrës." [10]

E derivuar nga lufta, frika që shpërfaqet në këtë sentencë është emocioni që plot intensë përshkon protagonistin dhe personazhet e romanit. Në një atmosferë të zymtë, të ekspozuar ndaj dhunës e agresorizmave, frika manifestohet si trazim shpirtëror, krajatë emocionale që shkaktohet nga pasiguria për jetë, ekzistencë. Në kujtimet e Marinit, sidomos në kohën e shpërthimit të luftës, të gjitha personazhet përshkruhen të mbërthyera nga frika, të përthithura në rrathët e së papriturës, që në krijesa të zvogëluara, të përhumbura nga vuajtjet presin vdekjen. Episodet që përshkruajnë bastisjet e shtëpive nga ushtarët serbë, kolonat e gjata të refugjatëve të vëzhguar nga po të njëjtit ushtarë pasqyrojnë frikën nëpërmjet përhumbjes së vetëdijes (alivanosjet e së ëmës së Marinit), përhumbjes shpirtërore (ankthi shpirtëror i motrës së Marinit – Norës), përhumbjes emocionale (gjendja e rënduar emocionale e Donikës pas dhunimit nga serbët).

Megjithatë, edhe përballë frikës përpara çdo çasti të kaluar, si kundërforcë lind shpresa. Frika nga vdekja dhe dëshira për jetë katalizojnë shpresën, të cilën e shpërfaq vetë protagonisti, te e cila sheh të vetmen mundësi për ekzistencë.

"Dhe shpresa vërtet dëftonte se s'kishte forcë njerëzore, që mund ta ndalte pranverën. E, Marini krejt çka kishte të vetën ishte shpresa. Dhe shpresa shfaqet me armët e saj dhe Marini përmes saj udhëtonte me qenie të gjalla e të vdekura...Sepse, atë ditë kur s'do të kishte shpresë, s'do të kishte më as njerëzim."[11]

Edhe në mënyrë eksplicite, paragrafi nënvizon barazinë e shpresës me jetën, ekzistencën e një kombi që ndodhet në prag apokaliptik. Në roman, momentet e shpresës nënvizohen sidomos në kornizat historike të bisedimeve të paqes në Francë, e sidomos në sulmet e NATO-s gjatë marsit e gjer në migrimin, anipse të dhimbshëm, larg rrezikut, mortjes dhe luftës në Kosovë. Kësisoj, shpresa vjen si dëshirë për të jetuar, për të ekzistuar e për të qenë të lirë, ndaj sublimohet e bëhet më grandioze kur vihet përballë frikës, krizave ekzistenciale të personazheve në luftë.

Dualizmi liri – pseudopatriotizëm

"Sepse ai e donte paqen e lirinë si flladin e maleve. Si rrezet e diellit...Ai e donte lirinë për të gjithë, ndaj i mallkonte kufijtë dhe ata që ëndërronin të krijonin ngastra për jetët njerëzore."[12]

Në rrethanat e një kombi të përfshirë në luftë, liria në rend të parë konceptohet si dëshirë e paqes, mposhtje e dhunës dhe e drejtë e çdo anëtari të këtij kombi për të jetuar brenda kufijve të etnisë së tyre. E tillë edhe në roman, liria në rrafshin e parë konceptohet si kërkesë e të gjitha personazheve për të ekzistuar, larg dhunës dhe çdo forme të suprimimit të jetës nga armiku. Por, për Marinin, liria merr një kuptim edhe më të gjerë. I përfshirë në botën e artit e kulturës, ideja e dikurshme e Gëtes për qytetarin e botës duket se pavetëdijshëm është e ngjizur edhe brenda Marinit, për të cilin liria është bashkëjetesë përtej çdo kufiri. Mallkimi i kufijve e pyetja që shtron në orën e historisë për ekzistimin e tyre dëshmojnë konceptin që Marini ka për lirinë, si paqe dhe bashkëjetesë globale, pa kufij, pa distinksione.

Liria megjithatë nuk mbetet vetëm si ideal, përfshirja në roman e momenteve të çlirimit të vendit e përshkruan në praktikë zbatimin e lirisë, vetëm se bashkë me frymën pozitive, liria e ardhur thyen utopinë e krijuar. Edhe pas përfundimit të luftës, ajo nuk arrin totalitetin e saj, manifestohet si pavarësi, por jo si paqe e tërësishme, jo si liri që ëndërron Marini i ri dhe për këtë Marini i maturisë është i vetëdijshëm:

"Ekzistonin mure brenda Kosovës e mure jashtë Kosovës. Mure të larta. Mure të urrejtjes, të ideve të marra, të varfërisë dhe të injorancës." [13]

Ideja e një lirie ideale deformohet edhe më tej përmes fenomenit të pseudopatriotizmit e lakmisë për lavdi të cilën e piketon ky roman. Ndonëse pa shumë detajizime, narratori ravijëzon kaosin e krijuar pas çlirimit të vendit që sjell siç e quan narratori një tjetër luftë, atë të lakmisë, egoizmit dhe për rrjedhojë po këtu nis harrimi i identitetit, vetvetes e vlerave mbi të cilat ngrihet kombi.

"...ia behu një tjetër luftë, një rendje e harbuar pas lavdisë dhe në këtë maratonë njerëzit ngjesheshin e ecnin të trullosur pa këqyrë përreth, madje kishte të tillë që shkelnin mbi të tjerët... në kohë lirie njerëzit harronin shpejt ditët e egra, stuhitë...pakkush pyeste, kush ishte shqiptari në këto rendet e reja?"[14]

Në këto sentenca përfytyrohet jo vetëm imazhi i shqiptarit të kohës së lirisë, por edhe imazhi i vendit, Kosova e pasluftës, si kundërvënie e Kosovës para e gjatë luftës.

Në qarkun e një dualizmi kohor dje – sot, imazhi i Kosovës dhe shqiptarëve përthyhet në bartjen e vlerave. Përballë një kombi dhe një vendi të cilit lufta paradoksalisht ia nxjerr në pah vlerat trimërinë, stoicizmin, atdhedashurinë, koha e pasluftës prodhon një kontekst historik, politik, ekonomik që çalon. Marini e i biri i tij, tashmë i migruar në Gjermani, turma e qytetarëve që presin me shpresë e ankth nëpër ambasadat e ndryshme janë sinjalizues i një imazhi fatkeq të vendit, edhe në kohën e lirisë.

Përvoja e Marinit si adoleshent e student,

---

[1] Ibrahim Rugova: "Refuzimi estetik", Faik Konica, Prishtinë, 2015, f.17

[2] Ndue Ukaj: "Dritarja e Marin Shkrelit", Onufri, Tiranë, 2023, f. 9

[3] Ag Apolloni: "Paradigma e Proteut", Bard Books, Prishtinë, 2019, f.243

[4] Ndue Ukaj: Vepra e cituar, f. 31

[5] Ag Apolloni: Vepra e cituar, f. 245

[6] Ndue Ukaj: Vepra e cituar, f.13

[7] Po aty, f.21

[8] Ndue Ukaj: Vepra e cituar, f.63

[9] Po aty, f.111

[10] Po aty, f.123

[11] Ndue Ukaj: Vepra e cituar, f.96 – 97

[12] Po aty, f.97

[13] Po aty, f.163

[14] Ndue Ukaj: Vepra e cituar, f.32, 33

përjetimet e ‘zhgënjimet e nënkuptuara të kohës së lirisë krijojnë imazhin e personazhit që reflekton, rikujton në kërkim të së kaluarës dhe rimëkëmbjes së identitetit, por në fund, me tragjizëm, i bën jehonë një humbjeje të përhershme, një traume të pashlyeshme në identitetin e tij si individ, e përmes tij, po kjo traumë përcillet edhe në identitetin e popullit shqiptar.

“- Historianët e ardhshëm, - tha, - do të tregojnë histori lavdie, do të thurin lavde për gjeneralë e drejtues, për vagabondë e kriminelë, por asnjë s’do të tregojë për dhimbjet e Donikës, humbjet e mia, as vdekjen në dhe të huaj të prindërve të mi, as për mallin për Norën që jeton në dhe të huaj, e as për mërgimin e djalit tim.”[15]

Paragrafi me të cilin përmbyllet ky rrëfim retrospektiv është një deklaratë e protagonistit në të cilën përzihen dhembja, tragjizmi, mllefi, dilema e pasiguria për fatin e tij, përmes tij për fatin e çdo shqiptari. Për më tepër, ky paragraf në mënyrë implicite shpreh rezerva ndaj historisë dhe paraqitjes së saj në sytë e botës. Jo vetëm ky qëndrim ndaj historisë, por në gjithë rrjetin dualist që ndërtohet brenda romanit shtrihen pikëpamje mbi çështje kruciale të funksionimit të jetës e qenieve njerëzore, e që të gjitha këto, siç e thekson edhe romani, mund t›i kultivojë e t’i pasqyrojë arti, letërsia, shkrimi.

Të rrëfyerit analeptik dhe liria e narratorit

Ndërtimi i paraleles temporale mes kohës së tashme dhe së kaluarës historike të popullit të Kosovës me automatizëm përcakton një strategji dualiste edhe në ndërtimin strukturor të rrëfimit. Siç pohon edhe studiuesi Adil Olluri, të rrëfyerit në thelb ndjek një *linjë drejtvizore dhe kauzale, ku një situatë e prodhon tjetrën, ku një veprim personazhi e prodhon tjetrin*[16], megjithatë brenda kësaj linje ekzistojnë tri thyerje, në dy kohë: e tashme – e shkuar – e tashme.

Zhytja në procesin e të rrëfyerit nis me një universalitet. Përmes një paragrafi që vë theksin në fuqinë artistike dhe stilin ekspresionist, kufijtë kohor duket sikur zhduken dhe rrëfimi bëhet i pakohë, transparent dhe identifikues për shqiptarin e të gjitha kohërave. Prej këtu rrëfimi nis rrugëtimin nga e tashmja e Marin Shkrelit, duke prekur moshën e tij tashmë prej pesë dekadash dhe duke përzgjedhur momentin specifik të largimit nga atdheu. Selektimi i të rrëfyerit prej kësaj situate nuk është rastësi, por qëllimshëm nxit, motivon rrëfimin në një perspektivë tjetër kohore: e kaluara. Marini i të sotmes mund të ndërtojë të ardhmen vetëm duke ripërsëritur të kaluarën.

“Një anakroni, në të shkuarën…larg nga momenti i tashëm, domethënë nga momenti i historisë në të cilën rrëfimi është ndërprerë”[17], ky është definimi që Zheneti ia bën evokimit në rrëfim. Ky evokim të cilit Bal i jep një emërtim tjetër si *retroversion*, bëhet mekanizmi kryesor i rrëfimit në roman. Krijimi i një vepre që shpalos episode nga e kaluara historike nuk ka se si të funksionojë pa u kthyer në të shkuarën, ndaj edhe pjesa dërrmuese e romanit zhvillohet si një analepsë, që nis që në vitin 1989 dhe përfshin harkun kohor prej rreth një dekade (shtator, 2000) para se rrëfimi sërish të kthehet në kohën e tashme të Marinit (vitin 2019). Dekada që rrëfehet përmes analepsës është e diferencuar në dhjetëra episode lufte, që, të vendosur në një radhitje kronologjike, përfaqësojnë momente kruciale të jetës së Marinit dhe fatit historik të popullit shqiptar në Kosovë. E veçanta e selektimit të këtyre episodeve është densiteti dramatik që vjen e shtohet. Çdo episod bëhet më dramatik, më intensiv se tjetri dhe tendos situatën, gati për ta krijuar klimaksin dhe për ta mbajtur lexuesin nën pushtetin e vëmendjes dhe frikës. Me një ndërtim të tillë strukturor, autori Ukaj prodhon efekte katarsisi aristotelian, duke krijuar vazhdimisht emocion për receptuesin.

Brenda dekadës analeptike, ndodh që, në formë krejt gjurmësh, rrëfimi aktivizon prolepsën. Ende pa u shpalosur mirë të gjitha episodet e luftës, prolepsa e këtij romani vjen si një paralajmërim, një lloj profecie përgatitore për lexuesin mbi fatin e Marinit dhe herë pas here mbi fatin e shqiptarëve.

Në përmbyllje të dekadës së çlirimit të Kosovës, rrëfimi analeptik ndërpritet dhe kthehet në kohën e tashme, megjithatë është një pikë që i bashkon – tragjizmi i theksuar, tronditja, patosi i fuqishëm me të cilin nis dhe përfundon ky roman.

Në teorinë e rrëfimit, jo vetëm strategjia që ndjek rrëfimi, por edhe personi prej të cilit derivohet ky rrëfim është një pikë esenciale e veprës. Siç thotë Massimo Fusillo duke cituar Stephen Jay Gould-in se nuk është më e nevojshme të flitet për *homo sapiens*, por për



homo narrator.[18] *Homo narratori* i këtij romani, për nga kategorizimi është i tipit heterodiegjetik, që ndryshe njihet si narratori i gjithëdijshëm. Si i tillë, ky narrator ka një diapazon të gjerë njohurish, ai njeh mirë jo vetëm Marinin, por çdo cep të historisë së popullit shqiptar, për më tepër njohuritë e tij kalojnë kufijtë kombëtarë dhe shtrihen edhe në Evropë e botë, përmes ilustrimeve të kontekstit politik e historik të botës.

Shpesh, paradoksalisht me dijen ‘e pakufizuar’ që i atribuohet narratorit heterodiegjetik, pozicioni i tij mbetet i kufizuar, dija që zotëron i shërben për të hedhur dritë mbi të panjohurat, skutat e errëta të personazheve në vepër, por zëri i tij mbetet i heshtur, uni i tij nuk afirmohet. Megjithatë, Ndue Ukaj vepron ndryshe, sjell një narrator unik, që përtej rrëfimit të jetës dhe pikëpamjeve të Marinit, nuk heziton t’i shpalosë pikëpamjet e veta, duke sjellë edhe më tepër dritë në rrëfim. Në fakt, në dy raste, marrë parasysh rrafshin morfologjik, narratori i Ndues mëton të rrëshqasë drejt atij homodiegjetik, duke shfaqur prezencën në roman, mirëpo ekzistenca e tij, përtej rrafshit morfologjik (përdorimit të foljes në vetën e parë të shumësit, që indikon një prezencë të mundshme të këtij narratori), narratori i Ndues mbetet jashtë sferës së veprimit. Megjithatë, atij i rezervohet sfera e të menduarit dhe paralelisht me të, liria e të shprehurit. Ndaj, narratori i këtij romani mendon, flet e jep pikëpamje mbi çështje kruciale që lidhen me botën shqiptare, duke dhënë indikacione se prapa tij mund të fshihen pikëpamje e mendime të autorit. Faktikisht, narratori i kësaj vepre vjen si plotësim i pikëpamjeve edhe të personazhit kryesor, aty ku përfundon apo ku është më i zbehtë qarku i mendimeve të Marinit, shpalosen mendimet e narratorit.

“Dhe shqiptarët kanë jetuar me shekuj në ankth, ata janë formuar me ankth dhe Marini ka ankth dhe ai është rritë me ankth, dhe në realitetet e reja ai frikësohet se mund të zgjohet një ditë, dhe krejt papritë; të mos kujtojë asgjë, lënda e kujtesës së tij të zhduket përgjithmonë dhe ai të mbetet një kontinent harrese, i zbrazët, i cekët, i hutuar, pa qëllim.”[19]

Pikëpamjet e këtij narratori, *përsiatje këto të një natyre eseistike*[20]siç i quan studiuesja Elsa Skënderi, artikulojnë lirinë e narratorit, jo vetëm në të treguarit e ngjarjeve, por edhe lirinë e mendimit dhe për më tepër, këto përsiatje shfaqin karakterin e tij, të një narratori erudit që guxon të meditojë mbi problemet esenciale të protagonistit që përfaqëson dhe popullit të cilit i përket.

Mozaiku intertekstual

Kur pohon se *kurrë nuk krijohet nga asgjëja*[21], studiuesi Fusillo u referohet pikëpamjeve teorike të Julia Kristevës mbi intertekstualitetin, për të nënvizuar sërish idenë se nuk mund të flitet për një origjinalitet të pastër, pa një motivim ose influencë veprash, autorësh, qoftë kjo edhe në formë gjurmësh.

Edhe “Dritarja e Marin Shkrelit”, e vënë në rrjedhën e veprave të letërsisë së sotme, është një produkt ekzemplar i intertekstualitetit. Teksa citon La Bruyeren, Nathalie Piegay-Gros dëfton se *gjithçka është thënë, dhe ne vijmë tepër vonë që prej shtatëmijë vjetësh qëkur ka njerëz dhe që mendojnë.*[22] Edhe autori Ukaj është i vetëdijshëm për ekzistencën dhe mendimet letrare, filozofike tashmë të paraqitura në letrat e autorëve të ndryshëm, megjithatë duke u frymëzuar prej po këtyre figurave të së kaluarës, Ukaj krijon një mozaik intertekstualiteti mbi të cilin provon origjinalitetin, autenticitetin e tij si individualitet letrar.

Mozaiku intertekstual brenda kësaj vepre vjen nëpërmjet citatit dhe një diversiteti referencash.

Citati – ndonëse në roman ekziston në formë gjurmësh, citati e bën hapjen e veprës, marrë nga krijimtaria e autori Emile Zola:

“Jemi si librat. Pjesa më e madhe e njerëzisë sheh veç ballinën tonë, pakica lexon parathënien, shumë u besojnë kritikëve. Të paktë janë ata që do e njohin ndonjëherë përmbajtjen tonë.”

Rimarrja e këtij paragrafi është përshtatje me njohjen dhe misteriozitetin që bart në vete njeriu dhe historia e një populli. Si me librat, autori paralajmëron se të paktë do të jenë ata që do të interesohen të eksplorojnë me të vërtetë shtigjet e skutat e jetës së Marinit dhe jetës së shqiptarit. Ky citat hap një shteg paralajmërues për atë që do të trajtojë romani. Në dy raste të tjera, citati vjen si rimarrje e një vargu të Ndre Mjedjes e një sentence të Kamysë dhe të dy këto citate funksionalizohen si përshtatje me krajatat emocionale të Marinit, rrethanat e rënduara historike e politike të Kosovës nën kërcënimet dhe dhunën serbe.

Referencat – konsistojnë në pjesën kyçe të intertekstualitetit në këtë roman dhe brenda tyre vërshon një triadë burimesh: arti, religjioni e filozofia.

Duke peshkuar brenda letërsisë nacionale e asaj botërore, referencat letrare përfshijnë emra autorësh të njohur të të gjitha periudhave e stileve letrare. Emra autorësh të njohur që nga Homeri, Dante, Gëte, Kafka për të vazhduar me autorët shqiptarë Buzukun, Bogdanin, Kadarenë, Visar Zhitin. Madje autorë si Dante e kryevepra si “Komedia hyjnore” bëhen modele të cilat i ndjek ky roman. Vetë historinë e luftës dhe tmerrit në Kosovë, narratori, protagonisti e përmes tij edhe autori e paralelizojnë me udhëtimin e Dantes në Ferr, e arritjen e lirisë e barazojnë me synimin për ta kapur Parajsën.

Referencat me burim religjionin ndërtohen mbi rimarrjen e episodeve biblike. Episodi i Evës e Adamit dhe përjashtimi i tyre nga Edeni; vrasja e Abelit nga Kaini dhe kulla e Babelit janë tri episode që piketon ky roman për t’ia përshtatur kontekstit kohor të Kosovës. Po këtij konteksti i përshtatet edhe referenca filozofike, e cila në qendër ka figurën sokratike, vuajtjet dhe apologjinë e tij.

Mbi këto tri burime referencash, Ndue Ukaj arrin të krijojë parabola të cilat ia atribuon gjendjes emocionale të Marinit. Këto parabola, që selektohen kujdesshëm e qëllimshëm nga autori, artikulohen si empati me rrethanat, kontekstin e tragjizmit, humbjes dhe vuajtjeve të popullit shqiptar dhe vetë protagonistit.

E po aq e qëllimshme është përzgjedhja e elementeve intermediatike (muzikës e filmit) në përputhje me frymën e kohës. Përmendja e filmit “Pianisti” dhe grupit Scorpions me këngën “Wind of Change”, përveç përshtatjes me situatën politike e historike botërore, është edhe një ekzemplar i intermedialitetit dhe erudicionit të autorit.

Fuqia e ekspresivitetit dhe metagjuha

Gjuha, nga aspekte të ndryshme vë në qarkullim idetë dhe emocionet, qenien subjektive të krijuesit…Gjuha poetike ka vetëm një qëllim – të ndikojë artistikisht te lexuesi, ndërsa stili i veprës letrare bën të mundshëm që ky përjetim të jetë sa më i thellë, sa më i ndieshëm, sa më i llojllojshëm.[23] Trajtimi i një teme të ndjeshme për popullin shqiptar implikon nevojën e zgjimit të emocioneve, zgjimi i emocioneve krijohet nëpërmjet një gjuhë ekspresive.

Edhe veprën e Ndue Ukajt, ajo që e veçon, përtej dualizmit dhe një narratori të veçantë, është rrëfimi i paraqitur përmes një gjuhe të pasur, të gjallë e plot ekspresivitet. Stilistika e bujshme, figuracioni i fuqishëm krijojnë tendosjen në roman duke e shtrirë patosin në çdo segment të romanit.

Deskripcioni është një element krucial i veprës. I gërshetuar brenda kufijve të rrëfimit dhe duke i shërbyer atij, deskripcioni i pranishëm në rrëfimin e episodeve të luftës u jep atyre rrëfimeve ngjyrime të theksuara humane. Mjafton episodi ku përshkruhet loja e përbuzjes së policëve serbë me plakun e moshuar shqiptar, ku kombinimi i deskripcionit me narracion krijon atë tip deskripcioni funksional që e përmend Zheneti në tekstin “Kufijtë e rrëfimit”.

Krahas deskripcionit funksional, Zheneti përmend edhe atë dekorativ dhe ky funksion gjen hapësirë në përshkrimin që autori Ukaj ia bën Prishtinës:

“Qyteti i ndërtuar në një gropë, përreth ka disa kodra si të shkalafitura, prej ku derdhen katunde e qyteza të vogla. Rrugët i ka të ngushta, por kjo s’i ka bërë njerëzit aq mendjengushtë sa mund të pandehin dashakëqijtë.”[24]

Qasja deskriptive aplikuar në këtë paragraf krijon ndër tjerash imazhin e Prishtinës në një kohë të caktuar historike, ilustron tiparet jo vetëm eksternale, por edhe ato sociale të këtij qyteti. E që këtu vërehen gjurmë të një gjuhe ekspresive, por që bëhen më të gjalla në pjesët e tjera të romanit.

“Të qëndronin ballë për ballë me njëri-tjetrin, por të shkapërderdhur në mijëra galaksi idesh, imazhesh, ndjesish, përfytyrimesh.” – ky fragment në të cilin glorifikohet kontrasti dashuri – luftë, është dëshmi e gjallërisë gjuhësore të këtij romani. Ekspresiviteti, pasuria gjuhësore, fuqia e artit prodhojnë emocionin dhe e bëjnë romanin të gjallë, të afërt dhe të prekshëm e të përjetueshëm për lexuesin.

Në krijimin e një gjuhe të rafinuar dhe ekspresive një ndikim të fuqishëm e ka dhënë pasuria stilistike. Figuracioni i bujshëm i kësaj vepre, i përthyer në sentenca metaforike, simbolike, metonimike, nëpër pyetje retorike, krahasime të gjata e paralelizëm figurativ kanë katalizuar fuqizimin e gjuhës duke e shndërruar në njërin prej dimensioneve të fuqishme dhe kruciale të këtij romani. Të veçanta janë sidomos paralelizmat figurative që ndërtohen nga autori nëpërmjet bashkëjetesës me natyrën. Njëjtë si në romantizëm, por me një funksion më ndryshe, natyra me gjithë repertorin e saj paralelizohet në përputhje me momentet reale të banorëve të Kosovës dhe sidomos gjendjen emocionale të protagonistit. Elementet meteorologjike, organizmat fitomorfë e zoomorfë, stinët e vitit bëhen qendra e paralelizmit figurativ. Madje edhe koha matet përmes tyre (stinët e vitit).

Me një manovrim të tillë të figurave letrare, romani dëshmon fuqinë e artit, për më tepër afirmon forcën e vet stilistike letrare.

Në tekstin “Arti i romanit”, Thomas Mann, në përpjekjen për ta arsyetuar glorifikimin e romanit, ndër tjerash për romanin kishte theksuar se *“është shpirt i fuqishëm dhe madhështor, pushtues, plot jetë, i paanë si deti në monotoninë e valëve të veta, përnjëherësh gjithëpërmbajtës dhe preciz, i përkënduar dhe i menduar; ai nuk synon kah inserti, kah epizoda, ai synon kah tërësia, kah bota me plot e përplot epizoda dhe imtësi, në të cilat ndalet në vetëharresë, thuajse gjakon për çdonjërën prej tyre.”*[25] Në përputhje me konstatimet e Mann-it, përfundimisht “Dritarja e Marin Shkrelit” kalon nëpër të tilla premisa. Me një dualitet temporal, ky roman del si shpërfaqje e historisë, gjakimeve dhe qenësisë së një populli. I prirë nga Marini në qendër, ky roman kapërcen fatin e vetëm një individi dhe identifikohet me kolektivitetin, shndërrohet në roman ku kapërthuret e kaluara, e tashmja dhe premisat e ardhmërisë së një populli.

Në një rrëfim retrospektiv ku qëndrojnë shenjat e mnemozinës historike, me një gjuhë ekspresive dhe stilistikë të shtrirë me kujdes, “Dritarja e Marin Shkrelit” afirmohet si dëshmi e formësimit identitar të shqiptarëve në luftën e së djeshmes, tundimi i këtij identiteti në mjegullimën e së sotmes dhe nevoja për njohjen e vetvetes dhe ruajtjen e kësaj vetje si kusht për ekzistencë në të nesërmen.

Literatura:

1. Ag Apolloni: “Paradigma e Proteut”, Bard Books, Prishtinë, 2019,
2. Anton Berisha: “Mundësi interpretimi”, Rilindja, Prishtinë, 1979
3. Elsa Skënderi: “Një mimesis i fuqishëm i kujtesës (Romani “Dritarja e Marin Shkrelit” i Ndue Ukajt) https://exlibris.al/elsa-skenderi-nje-mimesisi-fuqishem-i-kujteses-romani-dritarja-e-marin-shkrelit-i-ndue-ukajt/
4. Ibrahim Rugova: “Refuzimi estetik”, Faik Konica, Prishtinë, 2015
5. Massimo Fausillo: “Estetika e letërsisë”, Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2023
6. Nathalie Piegay – Gros: “Poetika e intertekstualitetit”, Parnas, Prishtinë, 2016
7. Ndue Ukaj: “Dritarja e Marin Shkrelit”, Onufri, Tiranë, 2023
8. Thomas Mann: “Arti i romanit”, Estetikë letrare, Fondacioni Ibrahim Rugova, Prishtinë, 2018
9. Zherar Zhenet: “Figura III”, Elbasan, 2L-2P, 2017

[15] Po aty, f.164

[16] Ndue Ukaj: Vepra e cituar, f.166 (Adil Olluri: *Një shëtitje në të kaluarën dhe të tashmen*, tekst i botuar si pjesë e librit të Ndue Ukajt)

[17] Zherar Zhenet: “Figura III”, Elbasan, 2L-2P, 2017, f.97

[18] Massimo Fausillo: “Estetika e letërsisë”, Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2023, f.208

[19] Ndue Ukaj: Vepra e cituar, f.36

[20] Elsa Skënderi: “Një mimesis i fuqishëm i kujtesës (Romani “Dritarja e Marin Shkrelit” i Ndue Ukajt) https://exlibris.al/elsa-skenderi-nje-mimesisi-fuqishem-i-kujteses-romani-dritarja-e-marin-shkrelit-i-ndue-ukajt/, vizituar më 30 korrik 2024

[21] Massimo Fusillo: Vepra e cituar, f.230

[22] Nathalie Piegay – Gros: “Poetika e intertekstualitetit”, Parnas, Prishtinë, 2016, f.16

[23] Anton Berisha: “Mundësi interpretimi”, Rilindja, Prishtinë, 1979, f.74

[24] Ndue Ukaj: Vepra e cituar, f.98

[25] Thomas Mann: “Arti i romanit”, Estetikë letrare, Fondacioni Ibrahim Rugova, Prishtinë, 2018, f.18

– Parathënie pë librin e Anton Nikë Berishës–

SHTRESËZIMI POETIK I NJË KRIJESE TË LARTË ARTISTIKE

nga Dante Maffia



"Thonë se zakonisht e teproj", shkruan në përfundim të punimit të tij Domenico Corradini H. Broussard e, më pas, shton se vepra "Etja e gurëzuar" i ka sugjeruar një "solo për violinë"[1], sikur të përpiqej të justifikonte shprehjet e veta që i përkasin nivelit të lartë teorik e artistik dhe trajtimit të arrirë e të hollësishëm. Mirëpo, nuk mund të bënte ndryshe; askush prej lexuesve që do të hynte në faqet e këtij libri nuk do të mund të sillej ndryshe për disa arsye.

Në një kohë shterpë si kjo e tashmja, që shkon drejt një vorbulle të një letërsie gjithnjë e më tepër të konsumit, të cilësuar nga mungesat e tensioneve shpirtërore dhe etike, të gjendesh përballë një argumentimi të këtij lloji, që niset prej kohëve më të largëta dhe shqyrton çështje të ndërliqshme si ajo e identitetit, është një ndërmarrje që pranohet me kënaqësi nëse ke të bësh me leximin e përshtatshëm, nëse adhuron poezinë, nëse ke për zemër dëshirën për t'i sqaruar vetes dhe të tjerëve motivin e një pështjellimi tashmë universal që po zhvendos popullata të tëra nga njëra anë e kontinenteve në tjetrën.

Berisha nuk është dorëzuar, edhe pse kishte mundësinë të luante letrën e thjeshtë të përkatësisë duke e shndërruar atë në një flamur për ta shpalosur e për ta mbrojtur, apo të paraqiste një histori tërheqëse, siç bëhet në shumë romane e filma, si për shembull në "Dashuria është një gjë e mrekullueshme" të Han Suin-t, duke vënë theksin në dallimet racore e kulturore. Përkundrazi, Berisha projektoi veten në kushtet e përshkimit (kalimit) të një rruge të ashpër e thellësisht të vështirë nëpërmjet së cilës mbërrin i rilindur para vdekjes. Pra, rrëfim e kungim, ku të dyja bëhen duke u përballur me kontradiktat, me shpresat dhe me ëndrrat e veta, për të vështruar më qartë qenësinë e veprimeve, për të kuptuar më thellë substancën e ëndrrave, projektet e fatit, thelbin e origjinës së vet, atë të traditave.

Feja e të parëve, e mbrujtur me besime, besëtytni, mitologji, halucinacione, që, të gjitha së bashku, krijojnë një kuadër të pasur me nuanca në përqasjen – ballafaqimin jo gjithmonë të krahasueshëm mes tyre dhe kështu protagonisti i romanit, Gjin Bardhela i Ndré Bua Petës, gjendet në pafundësinë e një udhëtimi metafizik që hap njëkohësisht portat e ferrit e të parajsës, që mbruhet (përftohen) hap pas hapi nga përvoja e cila i ofrohet nga kujtimet, nostalgjia, nëpërmjet përsiatjeve që shndërrohen në poezi të vërtetë. Do të shohim që në një moment të veçantë Gjini do të takojë jo rastësisht Jeronim de Radën, që do t'i mundësojë një përvojë të jashtëzakonshme duke përballur misterin e krijimit artistik.

Që nga fillimi "Hijet e muzgut të lodhur luanin padjallëzisht me jehonën e gurgullimës së Lumit të Madh të Maqit; përngjanin në shtojzovalle të brishta, që ringjallen në ndërrime stinësh", parashenjëzohet që zhvillimi i romanit nuk do të bazohet në gërshetimin e thjeshtë e në përshkrimin e aventurave që do të lejojnë rrjedhën e ngjarjeve të tjera vijuese, por brejtja në botën e brendshme të Gjin Bardhelës, gjendja e tij e veçantë në një hapësirë neutrale mes jetës dhe vdekjes, ku çdo gjë shndërrohet, bëhet e ndryshueshme dhe më intensive sesa është në të vërtetë. Në dallgët e jetës Gjini bëhet pré e sugjestioneve që shfaqen gjithandej duke i krijuar një pështjellim në mendje e në zemër, jo si fantazmat që duan ta fajësojnë apo t'i mësojnë diçka, por si realitet që ka humbur fosilet e kohës e është bërë njësh me të tashmen, duke mbetur në të njëjtin rrafsh me të. Faktikisht, siç ndodh në romanet e dy shkrimtarëve të mëdhenj të Amerikës Jugore, Manuel Scorza e Juan Rulfo, veçanërisht në romanin "Pedro Paramo" të Rulfo-s, jeta e vdekja paraqiten të ndërlidhura ashtu si hija dhe drita, pritja dhe arritja, mëshira dhe dashuria, bukuria dhe mallkimi.

Udhëtimi duhet të kalojë nëpër të gjitha përvojat e jetës, filluar nga fëmijëria, dhe ja përse rikthehet në kujtesë gjyshja Mari, rikthehen i ati dhe e ëma, pasionet e harxhuara apo ato të mbetura në gjysmëterr, rikthehen dashuritë e shkuara, vallet, ritet që lënë gjurmë përgjithmonë në sjelljet e Gjinit, në çiltërsinë e ndjenjave që ai nuk arrin t'i udhëheqë dhe të jetojë në tërësinë e tyre dhe në ndërgjegjësinë e vet më të plotë.

Me aftësi të veçantë, Anton Nikë Berisha ndërlidh në kontekstin e romanit, nga njëra anë, legjendat e përrallat, si pjesë e traditave të rrënjosura të ngulimeve arbëreshe e, nga ana tjetër, edhe tërësinë e paragjykimeve që shkallë - shkallë janë shndërruar në një mënyrë të ekzistimit e të perceptimit të realitetit. Në këtë këndvështrim romani përfton kuptime antropologjike të një efikasiteti të rrallë, edhe për faktin që vendos protagonistin në brendësi të një bote gati magjike, me pasoja që vënë në dukje shkaqe tashmë të rrënjosura e të metamorfozuara në një natyrë të dytë.

Disa kapituj janë veçanërisht të rëndësishëm për të kuptuar në thellësi atë që mbetet në veprimet e përditshmërisë (fjala vjen, të shihen kapitulli i tretë me titull "Këmisha e gjarprit", apo i dymbëdhjeti, "Plaka që zhbënte magjitë"), të cilët hedhin dritë për të kuptuar deri në fund atë që mbetet prej së përditshmes dhe atë çka e bën jetën ëndërruese e të domosdoshme, në fund të së cilës, shfaqen mbetjet e palëvizshme që vetëm kur arrihet të kuptohet se "Edhe jeta vetë është një shtegtim", lartësohen në sipërfaqe e shndërrohen në copëza ylberi ose në thithëlopa mllefi.

Do të duhej të flitej për shumë gjëra të këtij romani, duke filluar nga kompleksiteti i tij e të përfundohet me vëzhgimet e hollësishme për botën shqiptare dhe atë arbëreshe; do të duhej të analizohej më gjatë struktura (e tekstit të romanit) që Anton Nikë Berisha e ndërton me përsosmërinë e një arkitekti e do të duhej të diskutohej më hollësisht për qëllimet dhe përfundimet në këndvështrimin ideologjik apo idealist, por ajo që më intereson më tepër është vënia në dukje e shtresëzimit poetik të krijesës së tij të lartë artistike, e artit të vetëdijshëm të vështrimit të argumenteve nëpërmjet sugjerimit poetik, por, në të njëjtën kohë, pasional e analitik. Në fund të fundit, një vepër letrare vlen më tepër për mënyrën se si paraqitet, për cilësinë e shprehjes së saj artistike. Rezultati është fare i qartë: është një roman tepër i rëndësishëm i cili, që kur u botua më 2002 në Prishtinë, ndërsa në Itali vetëm pas një dhjetëvjeçari, duhej të kishte zgjuar interesim të drejtpërdrejtë nga njerëz të vendeve të ndryshme, jo vetëm të Arbërisë, por edhe të mbarë Evropës.

Berisha është shkrimtar i kompletuar, asgjë nuk lë pa analizuar hollësisht; ai ndërthur lirizmin dhe tendencën e tij drejt metafizikës me një mesazh jo të vagëlluar, por të fortë e të vendosur, të mbajtur në krenarinë dhe ndjenjën e përkatësisë, në kuptimin e jetës dhe në shtigjet që i paraprijnë rilindjes shpirterore. Veç kësaj, për lexuesit do të ishte e këndshme të ndiheshin bashkudhëtarë të autorit që i lejon vetes hyrjen në shtjellën e zërave misteriozë, ndoshta sepse "Ishte terri i natës që i vinte në gjumë të rëndë ose i zhbënte fryma e vdekjes?".

Duhet vënë në dukje se përkthimi në italisht nga Albana Alia është shumë i saktë dhe i rrjedhshëm; ajo ka arritur të përmbushë madje edhe ritmin e rrëfimit të origjinalit duke ruajtur në skajshmëri thellësinë e kuptimit të tekstit dhe bukurinë e shprehjes artistike[2].



1 Shih Domenico Corradini H. Broussard, *Narrando gli abissi*. Tre romanzi di Anton Nikë Berisha. *Rrëfime të thellësive*. Rreth tri romaneve të Anton Nikë Berishës. "Faik Konica", Prishtinë 2009.

Anton Nikë Berisha, *La sete pietrificata*. Luigi Pellegrini Editore, Cosenza, 2013, f. 176. E përktheu në italisht Albana Alia (Titulli i romanit në shqip "Gjin Bardhela i arbresh & Etja e gurëzuar", Faik Konica, Prishtinë 2002). Shih botimin italisht: Anton Nikë Berisha, *La sete pietrificata*. Traduzione dall'albanese di Albana Alia. Postfazione Amik Kasoruho. Luigi Pellegrini Editore, Cosenza, 2013, pp. 176.

Dante Maffia është shkrimtar i shquar bashkëkohor italian, autor i një varg veprash në poezi dhe në prozë dhe është i propozuar për shpërblimin Nobel për letërsi.

Punimin e shqipëroi: Albana Alia.

BUJAR LUCA DHE ARTI I TIJ I HIJSHMËRISË SË EPËRME

nga Prof. Dr. Luan Topçiu

Vepra e artistit Bujar Luca është ndër ato që të kaplon me shikim të parë dhe të ngjall emocione të forta. Ç'ka të bie në sy është rafinamenti i rrallë, sqima artistike, eleganca, hijshmëria, vetvetshmëria, natyrshmëria. Ai mbetet një magjistar i sintaksës, i kombinimeve të shenjave, incizimeve në sipërfaqen e telajos apo të letrës. Piktori shqiptaro-francez ravijëzon në rrugëtimin e tij artistik tiparet e artit të tij më të mirë, duke mënjanuar gjatë rrugës të gjitha ato elemente që do të pengonin shprehjen e tij artistike më të epërme, më të pastër dhe më elokuente. Në shumë syresh nga veprat e tij, ai mbërrin në zonat e artit me forma të qashtra, të lira, me sintaksë dhe morfologji të përkryer. (Plafond, Acrylique sur toile; alphaimagique, Codex 333 ...) etj

Elementetët dytësorë nuk shqetësojnë më punimet e tij, ndërkohë që veprat janë të plota, me një gjuhë të zgjedhur e plot sqimë. Fin dhe i proshkët, i beftë dhe poetik gjithëherë, artisti Bujar Luca është ndër artistët që u beson tërësisht mjeteve plastike të artit vizual. Arti, që ai e realizon në mënyrë virtuoze e të shpenguar, i besohet tërësisht intuitës së tij, instiktit artistik, impulseve të brendshme, të cilat shndërrohen në udhërrëfyese të procesit të krijimit.

Desemantizimi i veprës

Në shumë nga punimet e Bujar Lucës, vepra është e desemantizuar, e çliruar nga kuptimi literal dhe referencial, të cilat i redukton ose i eliminon për t'i hapur rrugën një interpretimi të hapur, sugjestiv, për ta bërë veprën të kujdo dhe të akëcilit: sepse vepra sugjeron, ofron, sjell para receptorit atë që mund të rindërtohet prej tij. Kjo vepër kërkon patjetërsisht një rol aktiv dhe krijues të receptorit të saj. Me fjalë të tjera, në vend që të paraqesin objekte ose skena të posaçme, veprat e desemantizuara përqendrohen në aspekte formale si ngjyra, forma dhe tekstura; kuptimi dhe mesazhi janë më pak të dukshëm dhe më të vështirë për t'u interpretuar drejtpërdrejt, por janë më të lira, më evokuese, më të hapura, më sugjestionuese për interpretimin vetjak. Interpretimi është subjektiv dhe vetanak. Receptori është i ftuar të eksplorojë dhe të interpretojë, bazuar në përvojat dhe perceptimet e tij, më shumë sesa në veprat me referenca të jashtme dhe të qarta, veçanërisht ato mimetike. Në vend që të ofrojë një mesazh specifik, vepra synon ndikimin estetik dhe emocional mbi shikuesin. Shenjat mund të të interpretohen si zogj, si pemë, trungje, si gjurmë lëvizjesh të befta, si imazhe ëndrrash që janë gjithçka dhe asnjëra syresh.

Bujar Luca fokusohet në përdorimin e linjave, formave, teksturave, frazave plastike, për të krijuar efekte vizuale dhe impakt emocional. Veprat bazohen mbi shprehishmërinë gjestuale, sepse bazohen mbi spontanitetin, instinktin artistik. Piktori shkel shtigjet e panjohura në të cilat e çon intuita artistike dhe nënvetëdija. Ai vendos në një dialog hapësirat plot me ato bosh, duke i besuar gjesteve plastike në një hapësirë të posaçme. *Hapësira* është vendi ku marrin kuptim shenjat, gjestet, frazat figurative. Hapësira bosh është ajo që vitalizon gjithçka që është konkrete, e lexueshme, e kapshme, gjithçka që frymon në të. Hapësira është ajri që ndihmon të shihen qartë loja grafike, dialogu mes shenjash dhe linjash, incizimet, harmonia apo disonancat që krijohen prej asaj që është e figurshme.

Historia e artit modern njeh përvoja të ngjashme si në pikturën abstrakte të Wassily Kandinsky-t, Mark Rothko-s, të cilët përqendrohen në ngjyrë dhe formë më shumë se në pasqyrimin e objekteve, apo në ekspresionizmin abstrakt. Në veprat e Jackson Pollock përdoren gjeste spontane, për të krijuar forma abstrakte; po kështu edhe në veprat e artit minimalist përdoren forma dhe ngjyra, të reduktuara në esencë, pa detaje përshkruese.

Gjesti figurativ dhe tradita botërore

Mjeti, mbi të cilin bazohet tërësisht vepra e artistit vizual Bujar Luca, është

gjesti figurativ, qasja spontane, përmes përdorimit të lirë dhe elegant të lëvizjeve të brushës, të penës apo lapsit, i cili të kujton lëvizjen e ekspresionizmit abstrakt dhe gjithashtu traditat e artit aziatik, veçanërisht atij japonez dhe kinez. Piktori shqiptaro-francez shkel në traditën e artit modern të Jackson Pollock me "drip painting" e tij, të Willem de Kooning-in, krijuesit të përzjerjes së figuratives me abstrakten, duke krijuar një tension të veçantë në veprat e tij. Piktura gjestuale në artin Perëndimor padyshim është e ndikuar nga arti aziatik. Artisti japonez, Shikoku Samukawa, me përdorimin e teknikave të kaligrafisë tradicionale, krijoi veprat e tij abstrakte dhe u shndërrua në një urë lidhëse midis kaligrafisë dhe pikturës abstrakte. Kinezi Zao Wou-Ki, koreani, Lee Ufan, çelën mundësinë e komunikimit midis artit aziatik dhe artit modern perëndimor.

Traditat aziatike, të përqendruara në spontanitetin dhe kontrollin e brushës, kanë kontribuar në zhvillimin e një qasjeje më intuitive dhe natyrale në pikturën moderne.

Bujar Luca, duke iu besuar tërësisht mjeteve të artit, gjuhës së pastër plastike, është një artist autentik. Ai i beson gjithëçkaje që buron së brendshmi, që vjen së brendshmi, duke krijuar frazat e tij plastike, të çlirëta, të vetvetishme, të shkathta, delikate. Artisti hedh dritë mbi misterin e krijimit, mbi shtysat e mistershëm të intuitës, mbi proceset e padukshme shpirtërore dhe psikologjike, mbi dinamikën e krijimit, mbi mekanikën e lëvizjeve të befta dhe plot magji. Herë ato janë krijuese të tensioneve, herë të harmonisë të paqtë, herë janë të rrjedhshme, të lira, varësisht nga dispozicioni i artistit. Arti i krijuar në mënyrë spontane dhe improvizuese shpesh kap emocionet dhe ndjenjat e çastit të artistit, duke ofruar një pasqyrë të pastër dhe të çiltër të gjendjes shpirtërore të tij. Është, pikërisht, ky element i sinqeritetit dhe i vërtetësisë e bën artistin autentik, të papërsëritshëm.



Krijimi i vetvetishëm e lejon Bujar Lucën të eksplorojë ide të reja dhe të eksperimentojë me teknika të ndryshme, pa u ndjerë i kufizuar nga planifikimet paraprake. Ky lloj eksplorimi e çon artistin në inovacione dhe zbulime të rëndësishme artistike. Liria për të krijuar pa kufij e lejon Bujar Lucën të zhvillojë një stil të veçantë dhe të dallueshëm, duke i bërë punimet e tij origjinale dhe unike.

Arti gjestual, muzika Jazz dhe koreografia

Shpesh arti i Bujar Lucës të kujton muzikën Jazz, e cila bazohet po në lirinë e improvizimit dhe spontanitetetit, në ndjenjat e çastit. Sepse lëvizjet spontane në artin modern ngjajnë së tepërmi me tingujt e muzikës jazz, që transmetojnë një gamë të gjerë emocionesh dhe gjendjesh. Intesiteti, kahu dhe shpejtësia e lëvizjeve emetojnë energji, tension, gazmim, trishtim, dramacitet, lirizëm dhe shumë nuanca të tjera emocionale. Përdorimi i ndryshëm i teksturës dhe ngjyrës në mënyrë spontane tek telajoja e Bujar Lucës të krijon ndjesi të ndryshme vizuale dhe emocionale, duke të komunikuar mesazhe të thella, të brendlshme. Pavarësisht se mund të mos ketë një narrativë të qartë, një vepër arti mund të ketë një ndikim të thellë emocional falë mënyrës së përdorimit të formës, ngjyrës dhe kompozimit. Edhe pse spontaniteti dhe liria janë të rëndësishme ai u beson tërësisht atyre, Bujar Luca zotëron një ekspertizë të thellë teknike. Këto njohuri teknike e lejojnë të manipulojë materialet në mënyrë të sofistikuar, duke krijuar efekte vizuale të ndërlikuara, si muzikantët e jazz-it, që niveli i lartë teknik profesional u lejon të improvizojnë me liri dhe saktësi dhe i bën që të mbajnë nën kontroll frazën, kontekstin, atmosferën. Nga ana tjetër, arti i Bujar Lucës ka fuqinë t'i ofrojë shikuesit një përvojë personale unike edhe prej faktit se piktura tij gjestuale krijon një asosacion të plotë me koreografinë. Piktura gjestuale dhe koreografia ndajnë shumë elemente të përbashkëta, veçanërisht kur bëhet fjalë për lirinë e shprehjes artistike dhe spontanitetin. Të dyja format e artit fokusohen në përdorimin e lëvizjeve për të krijuar një shprehje të veçantë dhe unike. Koreografët krijojnë lëvizje dhe sekuenca të frymëzuara nga emocionet, muzika dhe hapësira. Liria e shprehjes është thelbësore për të krijuar një interpretim të ndjeshëm dhe të fuqishëm në skenë. Të dyja format e artit kërkojnë një ndjeshmëri të thellë dhe një përkushtim ndaj momentit krijues, duke i lejuar artistët të komunikojnë me publikun në mënyra të fuqishme dhe të papërsëritshme. Në punimet e Bujar Lucës ndihet lëvizja, dinamika, vallëzimi i linjave dhe i njollave, befasia e lëvizjeve të papritura.

Arti kompleks i Bujar Lucës evokon bukurinë e muzikës jazz, magjinë e lëvizjeve koreografike, finesën e mjeshtrave aziatikë, duke i besuar, tek e fundit, tërësisht mjeteve të artit figurativ që ka zgjedhur dhe talentit të tij të jashtëzakonshëm për të luajtur dhe realizuar gjithçka që ai dëshiron të shprehë përmes artit të tij. Veprat e tij janë shpesh të ekspozuara së bashku, si për të hartuar një ligjëratë me to dhe secila syresh është një sintagmë e mëvetësishme, por dhe pjesë e së tërës. Bujar Luca është një mjeshtër në artin e tij, është një magjistar i sugjerimeve plastike, një artist fin dhe padyshim një personalitet tejet i rëndësishëm i artit bashkëkohor.

RUDOLF MARKU

Kujtim i largët

FËMINIJA

Oborrin e shtëpisë tonë,
Mund ta quaje një skenë të stërmadhe. Mblidheshin të gjithë,
Fëmijët e mëhallës që shkrimtarët kurrë nuk mund t'i krijonin
Me imagjinatë, për t'i patur pjesë të librave më vonë,
A për t'i përfshirë, në stilin shekspirian, në një dramë,
Miqt e mi të fëminisë që kurrë s'u bënë
Lexues, a kritikë a spektatorë për të duartrokitur njerëzit me famë
Shkrimtarët ishin larg, të zënë me temat e mëdha, me lavditë e lashtësisë,
me veten e tyre të komplikuar, si një psiko-analizë
Dhe ne vazhdonim të vidhnim biçikletat, në mëhallë, jo për gjithmonë,
Sa për një xhiro, dhe për kënaqësinë për të bërë diçka të ndaluar me ligj;
Loznim futboll me një top shike që shfryhej,
Që në gjuejtjet e para. Dhe na duhej t'i luteshim
Biçiklet-ndreqësit të vjetër, pronarit të vetëm të një pompe ajri,
Që ta frynim topin prapë; me kusht që të loz dhe im bir,
Dhe ai ta fitoj lojën, ndryshe nuk ka se si të jetë,
Na vinte ai kushtin pa mëshirë, në një botë që kishte veç kushte
Për gjithëçka, për të ardhë në jetë, vetëm e vetëm për me vdekë,
Shabi me një sy, Kolini i Files, Kasuçja, Geshi, Kasherja, Dudi,
Gavroshi dhe Fiku. më besniku nga të gjithë,
Dhe asnjeri nuk duhej ta kishte babain polic;
Pas loje, në muzg, uleshim te shkallët, secili tregonte ngjarjen e vet,
Me fantazma, shtriga, të vdekur që vërtiteshin në rrugicat e errëta,
Dy - tre pemët e oborrit rriteshin të mëdha,
Vetëm e vetëm që të na dhuronin fruta. E njihnin mirë
Urinë tonë të pazâ. Shkonim në mal dhe ngjiteshim kalave,
Gjenim përkrenare të thyera romake, shtiza normane gjithë ndryshk,
Viheshim në rrjesht,mbi bedenat e Kalasë, dhe shihnim në Det,
Sikur ta dinim se larg nga ne, pikërisht në këtë çast, papritë
Në bregun tjetër, Jul Çezari bënte gati legjionet
për një sulm të ri në bregun tonë ilirik.

O miq të fëminisë që shumë e shumë vite më vonë,
Do ju shihnja një natë të ftohtë dimri, tek silleshit të hutuar
Burra të vrarë jete, emigrantë, rreth Arenes së Koloseut në Romë .

Dhe lotët e mia që i fsheha në një lakrimore,
të cilën e marrë me vete, fshehurazi, kudo që shkoj.

ANKESAT E GOVERNATORIT TË PARË TË TOMISIT[1] PËR OVIDIN

Ju, lexues të dymijë e më shumë viteve më vonë,
E di se do ta keni të lehtë ta mbroni Ovidin,
Mjafton të thoni se Petrarka, Dante, Fransua Vijon, Shekspiri,
qënë të ndikuar prej tij,
Por përfytyroni këtë: pamjen e kishte si gjithë njerëzit e zakonshëm,
Dhe vetë ne qemë të dënuar nga Zotat
Që të mos dinim se ç'do të thotë Poezi.

Deri sa Ovidi filloi të flasë si përqartë,
Se Poeti është përkthyes imagjinatash në një botë të shurdhët.
Dhe këmbëngul se Kolkita e Jazonit nuk është larg,
Dhe në një gjuhë të pakuptueshme,
Mburr më shumë nga vetë Odet kushtuar Perendorit,
Safon, Kalimakun dhe sekretet e hekzametrit.

I paqetë në ujërat e Lumit të Vetëpërmbajtjes,
Shkruan poezi. Zot i fuqishëm, e çfarë poezish!
Kokën e ka të nxehtë, zemren edhe më të nxehtë,
Si mund të flisni pastaj ju, dymiijë vite më vonë
Për ngrohjen globale
Si për një fenomen të ri që u shfaq në Botë?

Turmat i shkojnë pas, dhe ai lexon zëlartë rrugëve të qytetit,
Ndonëse askush nuk e kupton gjuhën që ai flet;
Burrat qeshin me të madhe dhe trishtohen njëherësh,
duke parë nga njeri-tjetri,
Ndërsa gratë, ato më të bukurat, qajnë me denesë,

Që kur sollët Ovidin në qytetin tonë
Qyteti ynë nuk është ai i mëparshmi,
dhe asnjë njeri i vetëm nuk është më i qetë.
Si Governator i Provincës, do preferoja të sillnit
Ashtu siç bëni ju, dymijë vite më vonë
Mijërat e emigrantëve barbarë, se sa një Poet!

ERA MË THIRRI...

Era më thërret, era që fryn,
Më thërret në emër, si dikur fëmijë
Krah për krah dal me eren në rrugë
si një gjethe në pshtjellì.

Por s'mund ta ndjek gjatë erën, dhe ulem në prag;
Zot i madh, çfarë kam bërë që eren s'e ndjek prapë?
Çfarë ke bërë, më pyet Shpirti, ç'mëkat?

Në kopësht hyra, më ftoi një lule jasemin,
Flet në gjuhë sekrete me shpirtin tim,

1 Tomis- qytet në Rumaninë e sotme, identifikuar me qytetin e sotëm të Konstances, ku u internua Ovidi. Ishte skaji më i largët i Perandorisë romake.

Në ditën e neserme e shoh skelet pa gjebërim.

Zot i madh, çfarë kam bërë që lulja u thâ
Ç'mëkat ke bërë?, shpirti më tha.

Të kujtova ty, gjashtëmbëdhjetë vjeçare,
Gjysëm grua-gjysëm fëmijë,
Dhe unë në një moshë pothuajse me ty,
Frynte era në qytet, një stuhi-marrëzi
Pse nuk bëjmë mëkat?- më pyete ti.

Dhe puthjet e mia ranë mbi gjoksin tënd
Dhe Ernat u qetësuan përnjëherë megjithëmend,
As natë e as ditë nuk kishte më në botë.
T'premtova se do ta kujtoj këtë natë përgjithmonë.

Dhe shpirti më thotë- Ngjitu lart në qiej, ajo prapë të pret,
Përse të mos shkojmë kur shpirti i saj na thërret,
Ka pesëdhjetë vite që ajo pret edhe pret,
dhe murlani këlthet;

Pesëdhjetë vite prapë ajo pret në at'prag,
Dhe ernat që fryjnë me shkak a pa shkak,
Po kurrë s'e pash më në këtë jetë që nga ajo natë,

Dhe mëkati i shpirtit tim që nuk thotë më
: Ah, ç'mëkat !

LETER DASHURIE NGA NJË DELE E LUMTUR

Nuk mund të ankohemi për strehimin,
Arkitektura është e re, ndonëse jo e formës së grataqieleve,
Edhe pse në mesin e qytetit. Dihet se një vathë delesh kërkon gjelbërim,
Qoftë dhe në formën e peisazheve të pikturuar.
Por sot ne nuk kullosim në fusha të lira,
Health and safety është gjëja më e rëndësishme
- kujdesi ndaj ujqërve nuk është i tepërt kurrë.

Ndërtesa është prej betoni; në orën që duhet,
Bie një alarm si tik -tok ore muri, që t'na kujtoj se është koha të hamë,
Ushqimi është i dobishëm, askush nuk pyet për shije kohët e fundit,
Dhe askush nuk e di se der' kur do jemi gjallë.

Jemi të disiplinuara, blegërijmë në kor,
kurrë nuk kemi shprehur mosbindje tekanjoze,
Shohim lajmet e fundit me livadhet e dikurshme, me kullotat alpine,
Dhe kujtohemi për pasiguritë e para-ardhësve tanë;
sa shumë viktima të pafajshme ranë pré!
Pastaj shohim me admirim muret e larta prej betoni
të vathës moderne ku sot jetojmë ne.

Më mirë që s'e dimë ditën e fundit.
Kasapët sot janë të sjellshëm dhe profesionist,
Therjet bëhën me teknikat më të fundit, si operacionet për njerëzit,
Pa dhëmbje, me anestezi. E dimë sa e rëndësishme
është t'mos kesh kujtesë,
Shoqëruar me harrimin, çdo gjë bëhet më e lehtë.

Shtëpia jonë është e rehatshme, thonë se çmimet e tyre rriten çdo ditë,
Por ne nuk paguajmë as qeranë, as faturat e ujit,
E drejta e kafshëve mbrohet me ligj,
Madje dhe ujqërit vetë do dënoheshin nga gjykatësit e rreptë të Hagës,
Po qe se do të shpreheshin për ne si qënie inferiore, si dikur.

Dhe sa herë të kujtoj, ty, delen e zezë,
që preferove të ikësh larg, larg nga unë, pa adresë,
Jashtë mureve të larta të betonit,në fusha me livadhe të pasigurta,
Pa kamera sigurie që kontrollojnë përreth,
Më kap një trishtim i lehtë, të cilin e fsheh me kujdes nga të tjerët,

Sepse trishtimi është ngjitës,
dhe neve nuk na lejohet të mos jemi të lumtura në çdo çast;

Ps: për shumë arsye, të lutem mos më shkruaj pas!

NJË DITË, NË PICCADILY, LONDER

Dal nga shtëpia në rrugët e qytetit të madh,
Dhe përzihem me turmën. Nuk e di se ku shkoj,
Eci pa qëllim, nuk dua të mbërrij gjëkund
Si ajo reja lart në qiell, pa një destinacion,
I vendosur të jem moskokëçarës në turmë,
Ndoshta dhe pak i lumtur, një ditë e bukur me diell,
Të bën të kujtosh. Dhe ja ku më shfaqesh,
Në ditën e fundit kur u ndamë,
Në qytetin më të vogël në botë,
Në qytetin më të mjerë të Ballkanit.
Ah, Zot, sa e bukur! Dhe trupat e lakuriqt në dhomë,
Dhe seksi që na bën të fluturojmë,
Dhe lutjet e tua që të mos ik në qytetin modern...
Tani më duhet të shkoj në National Gallery,
(duke shmangur Sallën e Artit Post-modern me takt),
Që të gjejë portretin më të bukur të gruas më të bukur,
Që të them se të pashë prapë.

Dhe si ajo reja lart në qiell
që ka filluar të shndrrohet në shi,
ndjej lagështirën të vërshojë në sy,
si një Lum pa shtrat;
kështu ndodh kur ec pa destinacion,
në një ditë të bukur me diell
duket se është e pamundur të jetë i lumtur,
një ballkanas që mban mbi supe më shumë kujtesë
sa ç'mumd të përtyp, (thënë nga Çërçilli, dora vetë!)

Qyteti modern që mburret se është i fuqishëm,
Ndër qytetet më të mëdhenj të planetit,
Sa i vogël që je para një qyteti mjeran të Ballkanit,
Që ruan kujtesen e një vajze të bukur
Që pa botox, pa kremëra kozmetikë,
Pa okultet e operacioneve plastik, pa reçensione të rremë,
Ruan më mirë se National Gallery,
Bukurinë e përjetshme të kujtesës.

KUJTIM I LARGËT

Kujtimi i babait tim,
Në atë vit të largët, kur lumi rebelohej si një Zot Pagan,
Dilte jashtë brigjeve, si ai i burgosuri në ditën e parë të lirisë,
i gatshëm të hakmerrret me ata që e dënuan pa shkak,
Përmbyste qytetin tonë, duke marrë me vete gjithëçka në pshtjella rrymash lamsh,
Kafshë të mbytura, pemë, shtëpi, kufoma njerëzish;
Të gjallët ngjiteshin në katet më të larta dhe kujtonin Varkën biblike të Noes;

Veç im At nuk u tremb. Pa ditur not,
U fut në vorbullën e ujit, dhe ujërat papritë u qetësuan, të kapura
në befasi,
Si kafshët e egra që tërhiqen nga guximi i beftë i një kafshe më
pak të fuqishme.

Një mëz po mbytej, sytë e frikësuar të tij
Ishin të mjaftueshëm me rrahjet e të gjitha këmbanave të mëshirës,
Im At e mbajti nga krifa me forcë dhe e terhoq drejt shtëpisë.

Atë ditë u shtuam dhe me një mëz të vogël,
i pushtuar nga kriza ekzistencialiste e ballafaqimit me vdekjen
papritë,
Duke parë nga ne me sytë më të pafajshëm nga të gjithë.

Sa herë jam ndodhur në Brigjet e Kohës,
Duke parë papritë vorbullat e ujit të saj që merr çdo gjë
Tek shihnja kufomat e njerëzve, pemet, shtëpitë e rrënuara,
njerëzit e poshtëruar, a njerëzit bosh krejt,
E kam kuptuar se sa pak na duhet që ta qetësojmë Historinë,
Veç krahu ynë që zgjatet drejt një mëzi që mbytet,
Apo qoftë vetëm kujtesa e atij çastit kur terrori i një kafshe
Bashkohet me dashurinë e qënies njerëzore, kur vetë atij

Do i duheshin shekuj e shekuj që ta kuptojë se kjo është dashuri.

GJURMËT E SAJ

Në breg të detit, e di se mbrëmjeve
Do fryjë një erë e lehtë, do këmbëngul
Të mbështillet si vishkull rreth këmbëve të mia të çveshura;
Ka kohë që nuk i shoh gjurmët e tua të dikurshme,
Çdo gjë duket si fundosje në ranë,
Kujtesa më sjellë ndërmend Bediunët
Që ndonjëherë i gëlltit shkretëtira e Saharas
Me gjurmët e fshira nga era që fryn pas.

Rreth një grumbulli guackash të mbledhura me mund,
Në një guvë ujore, bën roje një Oktopod
Si para një boutique me gjëra të çmueshme antike;

E di se unë vetë unë nuk mund ta bëj dot!

DY TABLO

1.

Dita lind nën një mjegull vdekjeje,
Ai që fle në dhomën më komode,
Zgjohet i pari. Ankohet se ëndërrat ia prishin gjumin,
Edhe në katin e tridhjetë e pestë, në grataçielin modern të
periferive,
A në guvat moderne/bunkere, me gurët e kështjellave të lashtë
Bërë me blloqe gurësh të fosileve prehistorike.
Ku zhurmat nuk penetrojnë muret e trashë
Ankohet se lehjet e qenve nuk e lënë të flenë, ulurima e ujqërve
për tmerr,
Reptilë bërë nga Terrori i Jetës, fishkëllejnë gëzueshëm poshtë
shtratit të tij,
Kërcënueshëm si një ftesë për në Ferr...

2.

Në mesditë, poshtë një dielli djegës,
Kur vetë dita është e braktisur nga vetmia,
Poshtë zhurmës homerike të betejave të perditshme të makinave
dhe njerëzve,
Pranë kaosit të cilin asnjë surrealist nuk do mund ta mendonte
dot,
Shoh trupin e njeriut të pastrehë shtrirë në trotuar ,
Që fle i pashqetësuar nga ëndërrat, zhurmat, artikjut e gazetave,
Lehjet e qenëve, ulurimat e ujqërve, vrasësit që kalojnë pranë,
fjalimeve në Kuvend;

Fle si një foshnje në gjumin më të pafajshëm
Që Engjëjt mund të mbajnë mënd.

MË VJEN KEQ

Më vjen keq që i lashë dallgët e trazuara
Të rrëshqasin në çdo cep intim të trupit tënd,
Që dallgët pastaj pafajësisht të fshihen thellësive të Detit;

Më vjen keq që e lashë ranën të rrëshqas
Mes gishtërinjëve të dorës,
Në një mbrëmje të vetmuar të Vjeshtës,

Më vjen keq që nuk e shova etjen
Tek zbrisnja nga mali,
Dhe nuk u ndala të pi te përrroi me ujë të ftohtë,

Atë përrua që tani nuk e arrij më dot.

KAFE FLORA, TIRANË

Flasim për poezinë, murgjët, dhe ikonat. Po bëhët vonë.
Qielli është në ngjyrë kobalti a bruz? Prussian-marinë?
Më tepër më ngjanë në ngjyrën e mavijosur të lëkures së
engjëjve
Të rënë nga lartësitë veç nga kurreshtja për të parë tek ty Bukurinë.

Kafeneja së shpejti do mbyllet. Gjithmonë në praninë tënde,
Mendoj se nuk është e drejtë që dita të ikë kaq shpejt,
Dua të gjunjëzohem si fëmijë i vogël dikur, dhe të lutem
Që dita të zgjatet si një balsam plagësh të fjalëve që nuk i them.

Zëri yt është i qetë dhe i ëmbël. Kurse unë ndjej se mbytem,
Poshtë shtresave të heshtjes, në ngjyrën kobalt a Prussian marinë,
Edhe pse në zërin tënd dëgjoj zhurmërimin e lumenjëve dhe të
detit,
Që me vorbullat e tyre për në Had a Parajsë po më shpijnë.

Ngrihemi të ikim, zgjatem drejt avionëve që fshihen pas reve
Po avionët nuk janë ëngjëj që flijohen për bukuritë e heshtura
dhe dashuritë,
Në këtë botë me elektronikë, fb, instigrame dhe tik-toke të marra,
Ëngjëjt vazhdojne të bien, me lëkurën kobalt a bruz, veç për të
parë bukuritë.

KTHIMET

Kthehemi në qytetet tona të lindjes
Si trupat e ushtarëve të vrarë.
Në ç'betejë ramë, ç'plagë morëm?
Kush e kujton çastin kur tek ne u shfaqen plagët e vdekjes?
Asnjë betejë, asnjë plagë në trup,
Asgjë heroike për t'u kujtuar, asnjë kronikë për t'u përmendur,
As dhe daten e rënies nuk ka se kush ta thotë,
Sepse në fakt nuk kishte asnjë rënie,
Nuk kishte beteja të mëdha,
Beteja e Heracleas, e Grunwaldit, beteja për marrjen e Berlinit,
Asgjë prej gjëje. Betejat i përkasin Historisë,
Ndersa ne bredhnim udhëve të Botës, nëpër Kontinente,
Vizitonim plot kurreshtje Muzetë, Sallën e Potsdamit,
Pamë fushën e trishtuar të Vaterlosë, vendin ku vranë Çezarin,
Shkrepem aparatet fotografike, kamerat e I-fonave, bëmë selfies,
Në një botë ku kërkonim më kot të gjenim Historinë,
I bashkohoheshim konsumatorëve të Historisë, duartrokitës të
zellshëm
Të gënjeshtrave, blerës të kujdesshëm të hartave, të globeve
Të librave me beteja, të lakrimoreve të rreme
Mbushur me lotët e tharë të Pons Pilatit,
Të durueshëm në rradhë për të marrë biletat që të vizitojmë
Pompeun, Koloseun,
Amfiteatrin e Delfit, Piramidat, sehirxhinj përballë ekraneve të
mëdhenj
Të betejave, të mashtruar dinakrisht nga Historia, lexues gazetash.

E megjithat', në çastin e fundit, në qytetet tona,
Kthehemi thjesht po ashtu si trupat e ushtarëve të vrarë,
Anonimë, pa datën e lindjes a të vdekjes.

I NJËJTI VEND

Shoh vendin ku ulesh ti.

I njëjti vënd. I njënjti kamarier,
Zogjtë shtegtarë vazhdojnë të përplasen me retë,
Si shpresat kur ikin larg mbi qiej,

Në ç'gjuhë t'i flas ligjit të pamëshirshëm të dashnisë?

I hutuar
Dy kafe njëherësh porosis.

JASHTË ZOO-PARKUT, NË CENTRAL PARK, NEW YORK

Një harabel, i vogël, më i vogli nga gjithë harabelët, këtë mëngjez,
Po lahej në një pellg uji, nuk i zinte vëndi -vënd
Me sqep merrte pikëla për t'i hedh mbi kurriz, pa kujdes;
Harlisej i tëri, trupi i vogël i dridhej si një qënje e dashuruar,
Dhe kërcente pupthi si këngëtarët e famshëm të xhazit në
Harlem,
Paçka se pak i rrezikshëm, ç' është e verteta, me shembullin e vet
personal
Duke qënë se ishte këndëj parmakut rrethues, jashtë kopshtit
zoologjik
Mund të ishte një shembëll i keq për kafshët që ishin në kafazet-
metal,
Dhe mund të kthehej në një harabel - rrezik,
Në kuptimin legal- Qënia e lirë është një kokëçarje kudo,
Qent shetisin të lidhur e të lumtur, më këpucë dhe frak, dhe
papijô
Me kohë kanë marrë zakonet e njerëzve, e prapë më të mirë se
ato,
Sepse nuk mund të lexojnë gazetat, as të ndjekin lajmet më të
fundit;

Macet janë të lumtura brenda mureve të shtëpisë, sidomos kur
rrijnë në kuzhinë
Papagallët janë përsosur dhe më tej në rregullat gramatikore dhe
në fonetikë
Dhë përsërisin ekzaktësisht fjalët e pronarëve të vet pa asnjë
gabim-gramatikë
Për gardelinat as që mendohet se mund të ikin nga kafazët -mos
kini frikë-
Edhe me dyert e çelura të kafazit, preferojnë brenda të rrijnë.
Madje të këndojnë këngë-të japin koncerte me hyrje të lirë;

...Por ky harabel, i vogël, më i vogli nga gjithë harabelët, këtë
mëngjez,
Vazhdonte të lahej- dhe të hidhej poshtë e përpjetë,
Derisa një xhirafë zgjati kokën sipër murit rrethues,
Dhe pa gjithëçka që po ndodhte përreth
Dhe ku? Në Avenjunë e Pestë! :
Harbimin e tij, fluturimin e tij rrethor, kapriçotë e tij, lumturinë e
tij pa shkak,
E pa, dhe lotë filluan të rrjedhin nga sytë e trishtë të xhirafës plakë,

Dhe pas pak, brenda kopështit zoologjik të gjitha kafshtë e
Parkut filluan të qajnë,
Disa me lotë, disa me ulërima dhe kuje që morën dhenë;
Kur harabeli u ngrit në ajër
Duke fluturuar mbi kokat e rinoçerontëve, luanëve, ujqërve të
Ballkanit, tigrave të Bengalit,
Dy-tre penguinëve iu duk sikur panë akullnajat në Pol,
Ndërsa një rinoçeronti iu mbush mendja se mund të fluturonte
lart, në ajër,
Së bashku me mikun e vet elefant;
Teksa rojtarët e Parkut përpiqeshin të kuptonin se çfarë po ndodh,
Luani i Savanës së Kenias më kot desh, por nuk arriti dot, të ulërijë,

Në Parkun Zoologjik të New York-ut, që shquhet për disiplinë
dhe qetësi.

Central Park, NY

KARONT

Autobuzi është i shtrirë si një reptil i gjatë,
Nga ato që i quanim dikur- Fizarmonikë;
Është i mbushur plot, por jo aq sa të mos ketë vënd
Të lirë. Dhe destinacioni është për në Tufinë.

Fatorino më pështpëritë si të më thotë një sekret:
"Karonti nga pasqyra gjithë pasaxherët i numëron,
Duket moskokçarës, por asnjeri nuk fal,
Nuk duron të akuzohet nga SPAK për korrupsion;

Dikur përdornim Varkën e njohur, por Lana është shterrë,
Ka tre vite që s'bie shi. Ngrohja globale, pa frikë
Varken e zëvëndësuam më autobuzin që sheh,
Është më modern, udhëtimin e bëjmë me GPS elektronik".

Der' në stacionin e fundit, Tufinë. Autobuzi ndal,
Para check-in, me ngjyrat më gazmore, që mund të mendoni Ju!
Dhe Karonti që na thotë- Nuk lejohet të vdisni pa paguar më parë,
Kartat e Bankës pranohen gjithashtu!

SI MUND TË VRASIM NJË POET

Në fillim duhej një njeri të fliste në rrugët e Athinës,
Të thoshte zëlartë se Safo është më e rëndësishme se Tempulli i
Delfit,
Se hekzametri është arkitekturë më e përsosur nga Olympi,
Po aq sa është e përsosur arkitektura e zemres së poetit.

Kaq ishte e mjaftueshme që ai të helmohej,
Që të mbetej i pa helmuar morali i Qytetit.

Më vonë, në Romë, vargu poetik, që nuk kish përfillur *political
correctness;*
S'do mend që oborrtarët ia pështpëriten në vesh Perandorit, me
frikë,
Një arsye e mjaftë që Poetin ta flakin në cepin më të largët të
Perandorisë,
Rrethuar nga turmat që flasin një gjuhë të pakuptueshme , pa
gramatikë.

Librat e tij i hoqëm menjëherë nga Biblioteka Kombëtare!

Ndersa në Anglinë e largët, poeti po bëhëj më i famshëm nga
vetë Mbretërit,
Tragjeditë me fantazma,mjegulla,vrasjet pas shpine,
mosmirënjohje,
Të jeshë a të mos jeshë ? Ah, kjo profeci e parashikuar nga ai
vetë!
Atëherë thamë se veprat e tij i shkruante një tjetër,
Që ai të mbetej anonym përjetë;

Dhe Bardin e varrosem, pa shkruar se aty prehet një Poet!

Ose Poeti që vritej në Shekullin e Njëzet,
Në Moskë, Leningrad, Librazhd, Pragë a Siberi,
Spiunët e quanin spiunë,vrasësit e quanin vrasës,
Kritikët tanë me stil të lartë shkruanin reçensione- proces verbale
për ekzektimin e tij.

Tani mjaft më! Jo vrasje, litar,helm a internim si dikur,
Ngase të gjithë i shpallëm Poetë, nuk ka më lexues të lexoj Poezi,
Orakulli elektronik i Delfit na siguron dënimin modern të Poetit,
Jemi të lirë, nuk lexojmë më libra në Shekullin e Njëzet e Një!

GAZMEND BERLAJOLI

fëllanzat

Tregim

~ të jetueme të diftueme ~

Fërfëlloi fëllanza n'uj-e
fërfëlloi o fëllanza n'uje
fëllanza, moj fëllanza
fëllanza moj
Fëllanza...

KOSOVË, MARS 1999

Ishim në shpi tue hangër darkë. Veç kur thanë: «Hynë te kojshitë. Hynë e po marrin burra e djem të rij»! S'kemi ditë gja, veç kur hynë edhe te na. Burri mule me u ikë për dritare.

E vranë. Katër veta shprazën automata. Tue e gjuejtë, ma vranë edhe çikën. Se... ngat babës së vet kish qëllue. Mue më morën tue më ngrehë për flokësh. Ngreh e ngreh, zhag për tokë. Më futën në nji xhip e më çuen në stacion të policisë...

*

Në shpi. Tue pi çaj ishim. Sa kish zanë me u errë. Veç kur i ndiem krismat – bam-bam-bam-bam. U tmerruem! S'e dishim çka asht tue ndodhë, as kah po vijnë. Këta, burri me çikat, u shtrinë për tokë. Unë kujtojsha që dikush po merr nuse. Po krismat s'kish që po ndalen. Edhe vishin bajagi afër dritareve.

*

Aty filluen! Kur më çuen në stacion të policisë. Mbas nji kohe kur... kur... kur e kryen ata... mbas katër orësh më lëshuen.

Po, kah me ia mbajtë, kah me shkue? Qysh m'u kthye n'atë shpi, që vorr i çikës e i burrit m'ish ba? Të marr me shkue te nana.

Kur mbërrij, krejt bijat ishin mbledhë aty. Më sheh nana:

- Qyqe! Çka të paska gjetë? Çka je ba kështu?

*

U thyen dritaret prej atyne krismave. Aq të forta që vishin. U çuem, ikëm prej shpie. Nja tri-katër ditë u mblodhëm te nji kojshi. E kishin nji podrum edhe na morën; krejt lagjja qaty bashkë.

Në krye të dy ditëve mbeta pa pelena. M'asht dashtë m'u kthye në shpi, m'e marrë ndoj çarshaf a gja. S'e kisha larg. Mirëpo, na gjuejshin prej kodre. Sa shihshin lëvizje, gjuejshin.

Unë prapseprap shkova, i mora nja pesë a gjashtë, se çika e vogël. Dy herë gjuejti kah shkova. Kah u ktheva shyqyr jo. Ma ish errë qatëherë. U ktheva shëndosh e mirë te çikat e burri, qaty në podrum të kojshive.

*

Në fillim s'po due me i kallxue nanës as kurrkujt çka më kish ba vaki. As për te shpia, as për... atje në stacion. Çka me i tmerrue edhe ma shumë këta?

Po nana:

- Çka krisi mori në mahallën tuej?

Qaty veç m'asht rrotullue gjithçka...

U çue vllau. Ma ka derdhë do ujë përsipri, po m'iu mëshon kapak faqeve shuplakë. Dikur m'u hoq të ligtit. Nisi unë, po kallxoj... kadale... burrin, çikën, qysh m'i vranë.

E s'kemi ditë gja, veç kur të na erdhën edhe te vllau. Vllaun e lidhën. Tue e rrehë e qitën. As s'e kena pa, as s'kena ditë ma gja për te. Deri mbas lufte.

Të na hynë mandej e po na marrin me bija. Nanën e rrehën. Para syve tonë... ia kanë ba.

- O kuklla! Kqyrni, kqyrni, se edhe juve kemi me jua ba njisoj! – na thojshin në sërbisht.

Na ngarkuen në kamion, e mandej, me kunatë, me halla, me teze, me çka qëlluem aty, na bájshin; sa andej, sa këndej.

*

Na zbuluen n'atë podrum, se na shihshin prej kodre tue hy e tue dalë.

Po u mëshojnë dyerve:

- Hajde! Përjashta! Dilni jashtë! Hajde tash, marsh në Shqipni! Vend për ju këtu s'ka!

Na futën nëpër autobusa. Sa ecshim pak, hyshin policë me kqyrë çka ka, tek ka. Nja tri-katër orë të mira udhëtuem.

Këndej, kish pasë dalë nana me më pritë. Të tanë tue na pritë, si me pasë ardhë prej kumeditë ku, veç pse ishim gjallë. Telefonat s'bajshin; kurrfarë lidhjesh nuk kemi pasë.

Te nana u rahatuem, u qetësuem bile pak.

Dikur po vjen motra. Fikall vetëm ajo. Medet! I kishin pasë hy në shpi; vra edhe burrin edhe çikën pesëvjeçe. Ajo, gërvishta trupit, fytyrën all, teshat krejt të çkyeme.

Erdhën na hallakatën edhe aty te nana. Nana s'deshti me na lëshue kurrqysh, e boll u kacafyt me ta. Rreh ata nanën, rreh, rreh. Mshoji thikë, këtu në kambë.

Ku-ku mbasandej çka i banë! Para syve tonë!

*

E të na çuen te njifarë vendi. Ish aty nji... Shkollë ish, po e kishin ba stacion policie. Herë i thojshin shkollë, herë stacion.

Na kanë marrë rend – si sot më kujtohet – nji kallaballëk gra. Tap, e tap, e tap... rend! Cila kundërshtojshim ma së forti, e nxirrshin thikën e na u sulshin. Krejt trupin sheja thikash e kam. Krejt. Dikur s'mujta me i ba ma ballë kurrnji sendi.

Kur i shihsha motrën, kunatën, tezen, çikat e vllazënve, u lutsha: «O Zot i madhi, le të na vrasin para se me na ba çka po na bajnë»!

Aty, njani hyn e tjetri dil, njani hyn e tjetri dil, si të çmendun. Njani Jovan, e thirr tjetrin Jovan, e tjetrin prap Jovan.

*

Na mbushën nëpër kamiona.

- Kah duen me na çue?

Shtatëmbëdhetë na kanë marrë, femna krejt. Kur na zhdrypën, njifarë shkolle e madhe aty. Me forcë na shtyjshin mbrenda. Çka me të pa sytë? Plot të shkreta, të mjera, përgjakë, ba ibret.

Po e pyesim nji grue:

- Ku jemi?

- Ooh e mjera unë për ju! – nëpër lot ajo, pa ndalë – Edhe juve, si neve ju paskan marrë?

Atyne kush u hyka në dorë, nuk dilka ma gjallë qysh duhet. Dhambët na i nxirrshin me dana, se refuzojshim me u avitë me ta. Qe ku e kam këtu shejën, me thikë që më kanë pre. Tjetrën në bark, nja tri nëpër kambë, n'organ gjenital nji. Nëpër krahë na i shkymbshin cigaret. Tri ditë e tri net aty që na kanë mbajtë. Na i shtishin në gojë grykat e shisheve, raki me pi. Qaq fort rrehë na kanë, torturue, na kanë shpue barkun me do gjylpana, përpara, përmbrapa.

*

Qitshin raki, qitshin ujë, edhe dofarë gjylpanash na i bajshin... Tash e di çka ishin ato. Atëherë s'e kam ditë. Qai, njani prej qatyne Jovan që i thojshin:

- Po ju japim me ju forcue! – se na pa hangër, pa pi, kurrë hiç kurrgja.

Kur e kryejshin atë punën e vet, qata ujë na e rrasshin me shishe në gojë, se na u pakshim prej keqtrajtimeve.

Prap marrin me na ngarkue në kamion. Mbas do ditësh. Lidhë kambë e duer, qashtu të përgjakta. Ka dy veta na ngjitshin me na shtie në kamion, se trohë takati s'kishim me lëvizë. Pesëmbëdhetë kilogramë pata ra.

Tue na hypë, po i pyesin do tjerë ndër ta:

- Kah këto, për kah?

- Për Zveçan p'i çojmë!

*

Mbas tri ditësh, na morën e na shtinë në nji kamion. S'i merrshin të tana, veç do-do çka i zgjedhshin. Kur kapin me më marrë mue, ngreh njani mue, ngreh tjetri me ma shkulë çikën prej duersh. Piskat çika, se e shtrëngojke fort. Ma shkulën prej duersh.

Po marrin me më ngarkue në kamion, po shyqyr qajo grue që i zgjati krahët me ua marrë çikën, asht kojshike e parë atje te burri. U qetësova pak, se thashë, me ba me pshtue gjallë, bile e di ku e lypi. Edhe çikat tjera qaty krejt bashkë, po na kqyrin neve tue na ngarkue. Za me ba s'po guxojmë, as na, as ato.

Na hiç s'po dimë pse po na ndajnë.

- Po i çojmë në Zveçan, se po i lyp Arkani, – po e ndiej njanin kah thotë.

Kur mbërritëm qaty kah mesi i rrugës, motra e then nji shishe që kish qëllue aty mbrenda. E të ka nisë me na i zgjidhë duert. Mue, unë kunatës, tjerave varg, me qatë shishe i zgjidhëm duer e kambë.

*

Këto i kishin shtie në kamion para meje, mue në fund. Isha në fund me motër, me kunatë, me dy çikat e tezës. E kisha pasë afër nji shishe të rakisë.

- Mos e rrokat! Se na bajnë çka na banë ma herët.

- A din qysh kam me e rrokatë? Kur të nisë kamioni me ecë, e s'ndiejnë çka po bahet këndej mbrapa, kam me e thye.

Kam nisë e po i mëshoj. Mëshoji me kambë, mëshoji, mëshoji, dikur – don Zoti me të ndihmue – njifarë stomi ata e zunë, unë i mëshova shishes fort e e çava. E afrova kadalë me kambë, e kapa, e t'ia kam ba vetit ving e ving, poshtë e nalt... qe kah kanë mbetë shejat, se tue u mundue, i prejsha duert. Veç, i zgjidha dikur. E t'ua zgjidhi të tanave, duer, kambë.

*

Do thojshin «jo, unë s'guxoj» e do «unë guxoj». Kemi kcye gjysa. Motra e para, unë fill mbrapa. Gjysa, a kanë kcye a jo, nuk e di.

Pamë ma larg njanin tue grahë nji kerr me nji kalë të bardhë.

- Çka ju paska ba vaki kështu?

- Jemi gërrithë tue ikë therrave, – i tha motra se s'deshti me i kallxue.

Tha:

- Ku keni me shkue? Hajde se unë ju çoj!

Hypëm në kerr, u nisëm, por na të mbulueta, tanë tue u tutë se mos po kthehet kamioni.

*

Kambët e mia i harrova. Lidhë i harrova. Thashë:

- Kceni o gra!

Do gra aty:

- Jo! Unë s'guxoj. Më shohin.

- A doni pra, po kcej unë e para? Në më vrafshin, rrini! Në pshtofsha, kceni mbas meje!

Kceva. Ua bana shejë me dorë mandej motrës e kunatës. Kcyen. Nja dhetë metra ma larg njana, nja njizet metra tjetra. Shkojsha zhag, me kambë të lidhme, deri kumeditë ku, tue lypë a ka ma tjera.

Dikur, mbërritëm te nji katund, s'di qysh i thojshin, rrugës për Zveçan. Veç kur erdhi nji magjup në kerr me kalë. Sa hypëm, po më pyet:

- Çka je ti?

- Unë turqelike!

U folsha edhe këtyne mbasandej turqisht, mos me e marrë vesh ai kush jemi. Kur u kthyem, u shpërndamë kush kah mujti se e kemi pasë nji postbllok aty, e u desht me u mshefë.

...dil prej ujit
mos dalsh kurrë
dil prej ujit moj
mos dalsh kurrë
fëllanzo, fëllanzo,
fëllanzo moj Fëllanzo...

Më kishin pasë humbë krejt çikat, hiç s'dijsha kah janë. Krejt kishin shkue e ishin strehue te nana jeme. Kur u bamë prap bashkë aty:

- Mam, çka të ka ndodhë ty?

- Kurrgja!

- Jo, na të kemi pa.

Prej atëherë e dinë, po s'ma përmendin kurrë. Janë pajtue edhe ato.

*

Unë u ktheva ma së pari në shpi teme. Thashë të shkoj njiherë, me u pastrue, me i ndërrue do tesha, se krejt gjak, lloç. Motra nga me i lypë çikat.

Kojshitë, kush kish mujtë me pshtue diqysh, ishin kthye nëpër shpi të veta. Qashtu shkrumb të bame. Shpinë teme shyqyr s'e kishin kallë. Ata po, flakën ia kishin pasë shti, po veç korridori çka ish djegë.

Vike era, xhenazet hala qaty në dhomë ku i patën vra. N'oborr të shpisë vetë i pata vorrue, dy vorre ngatangat. Falemnderës edhe prej kojshive se m'u kanë pasë gjetë bukur fort. Edhe prej kunatit, kurrë s'ia harroj. Dikur mbas lufte i kemi pasë nxjerrë në vorreza.

Prap qaty erdhi na mori policia. Prap nëpër kamiona. Veç gra nja nji mijë e pesëqind a ma shumë që ishim, pleq mandej, fëmijë plot. Na kanë zgjedhë krejt gra të reja, çika të reja, e do ma të motnueme pak. Ndër qeto, disa as sot nuk dihen ku janë. Do kanë pshtue, do i patën vra se patën provue me ikë qatëherë në fillim; disa janë të pagjetuna.

*

Mandej erdhën këto tjerat vuejtje: me dalë nëpër kolona. Ka qenë data 9 prill kur kemi dalë në kolonë. Me nanë, me kunatë, me fëmijë. N'atë kolonë çka kemi hjekë; boll u munduem me i lidhë fytyrat me pelena, me i zhlye kishe, po badihava. Tri herë rrugës na kanë... paramilitarë a çka ishin ata. Krejt me do fytyra të shkarravitme; ngjye zi, veshë zi. Nuk e merrshe vesh as kush, as tek janë. Veç me do nofka, të shkurta kështu: Peshk njani, njani Luan, tjetri Ujk. Demek, Ujku të han. Çka kemi hjekë prej qatij Ujkut, Zoti ia ktheftë nji për nji, jarabi, me familje të vet. Na kanë çkye bre. Ku-ku çka kemi hjekë.

Pesë ditë kemi ecë pajada, nji herë me shkue, mandej me u kthye, unë me çikë të vogël, me tanë atë dhunë, gjakderdhje, e untë, etshëm për ujë.

E kur na shtishin në dorë:

- Ju qeshtu e lypni, se doni me e ruejtë nderin!

- Ta bafsha edhe nanën qeshtu si ty!

- Kam me ta ba tash prej përmbrapa!

*

Veç të merrshin, kap për krahu e të futshin nëpër shpia. Katundi ku na çuen, në kodër, krejt i shprazët. Krejt shpitë aty të lëshueme. Shtina këta e mbush njanën, tjetrën, tjetrën... Nxirr televizora jashtë, frigorifera, sende çka u pëlqejshin. Policia me kerre, me xhipa, tue ardhë e tue shkue. Ndër qato gra edhe unë, nji çikë e mixhës... plot gra që u njihshim.

Njizet e dy ditë më kanë mbajtë mshelë në nji dhomë. Njizet e dy ditë, kurrë pa dalë. Me i pa në sy i njoh, po emnat s'ua di; janë ruejtë mos me i përmendë para neve. Do shirita të kuq i mbajshin lidhë për krahu, kapuça të zij, tesha të zeza. Armë mandej; i kishin do automata të shkurtë.

*

Krejt lagje-lagje qysh vishin, u tubuen te xhamia: sa burri, sa grueja, sa fëmija, sa njeri i rrehun. Pleqtë nëpër karroca cimenti i kishin qitë. Lloç kahmos, mezi i shtyjshin.

I mbledhshin burrat. Thamë, po na i vrasin ndër sy. I ngarkuen nëpër kamiona. I kishin pasë çue në burg.

Na ka qitë dikush dy bukë... Na jepshin edhe ushtria e rregullt, që nuk hyjshin në gjynah me gra e fëmijë. Na dhanë tamël pluhun, me e përzi me ujë, bukë na jepshin, na e jepshin njifarë si... e shtrydhshe si pastën e dhambëve për me lye bukën.

Çikën e vogël gjithë që e kisha në dorë.

- Ndalu! – po më thotë ushtari.

U ndala. U ndal edhe kunata pak ma andej me nanën. E ka nxjerrë thikën. Thashë don

me ma pre evladin. Ai merr e pren yllin prej kapuçit, e ia ndreq çikës nji najllon mos me e lagë shiu. Ia kap mirë me qat' yll, për mos me ia bájtë era. Shyqyr qajo, e e mbajsha çikën ma nxehtë mandej. Se pati nisë qatëherë me reshë si ma fort, e kisha dro po më sëmuhet.

*

Ka ardhë mbramjeve, deri në mëngjes ka ndejtë, njizet e dy ditë. I njejti, për çdo natë i njejti njeri. Çka kam hjekë prej tij, goja nuk din me të kallxue. Hata, kiamet! Dekën e ke pa me sy, po me dekë s'ke dekë. Zdeshë, krejt cullak, ma ka mëshue nëpër krejt trupin, krejt çivita-çivita. Në fillim gjithë i rezistojsha, mbasandej ma, u pata lëshue krejt. Sa herë mbrenda nate tue më ra të fikët.

Më ka pasë dhanë infuzione, bukë me hangër... Mbramjeve, me radio-lidhje thirre tjetrin, me ardhë ai me ma vu infuzionin.

*

E këta që ishin me shatora, tri herë na kanë ndalë rrugës, he Zoti i marroftë. Tri herë qashtu... prap nëpër duer të tyne, shkelma, grushta. Ato plagë që na i bajshin me cigare e thika, mujshe vetë pak me i la e lidhë diqysh, po ato mbrenda se...

Tue ecë, veç kur na ra granata midis kolone. Plot i la dekun. Mue më rroku në gji e në kambë. E kqyra çikën. Thashë:

- Nanë, çikën ma paska rrokë copa e granatës.

Gjak më shkojke kambës. Mezi ecsha. Me u ndalë s'guxojsha. Kush nuk mujke me ecë, që ish plagosë, e vrajshin.

- Oj nanë, veç po dridhna, a ma mban bre çikën? – i thom.

Gratë m'i dhanë do pelena me mbulue çikën, ma lidhën kambën deri kemi shkue në qytet. Rrugës më thotë nana:

- Zoti shnosh ty çika jeme, se çika jote e pat!

Vetë isha e plagostë, keq e kisha varrën. E mora çikën, ia putha të dy sytë, e lëshova te nji mulli. Kur e lëshova, ma ban nji ushtar me uniformë:

- Mos e le këtu! Merre! – më bërtitke – Merre!

*

Odë. Odë e burrave ish. Ka pasë tjera, mshelë nëpër dhoma tjera. Plot. I ndiejsha piskamat, gjithë natën, gjithë ditën.

Je dorëzue, thjesht je dorëzue, derisa ka ardhë dita, që e pruni Zoti, me u lirue. Veç Zoti që na ka ndigjue.

Atë natë, ky njeri, sa e kreu me njanin në radio-lidhje, po del prej ode e po flet në korridor me tjerët.

- Shpejt, shpejt! – e ndiejsha kah thotë.

Po kthehet, po nis po i mbledh plaçkat e veta nëpër odë. Mue nuk po më thotë kurrgja. Këndej mbledh tesha, çizme, dil shpejt prej dhome, mue po më len prap të ndryme mbrenda.

Veç kur ecën tenkat, xhipat... U shukat. As nuk erdh' kush ma, as nuk u ndiejshin piskama prej dhomave tjera. Qatëherë, si pa zdritë tamam qysh duhet, krejt u shukat.

E kam çelë kadalë dritaren edhe kam kcye jashtë. E të kam nisë, ec, e ec, e ec, por nuk kisha fuqi me ecë ma, e të kam ra në nji arë, të jam mshefë pak mbas nji kaçube e po rri. Mezi frymë që merrsha.

Kalojnë dy vetë. I njihsha.

- Çka ki, a je plagosë?

- Po – thashë – plagosë, smutë!

- Kush të ka pru këtu?

- Do ujë, a mos keni me ma dhanë?

*

Kur u afruem te qyteti, na shtinë në nji fabrikë. Sa hymë aty, erdhën gratë, me gërshanë ma hoqën pjesën e mishit që mos me u infektue. Ma prenë, m'i qitën miell me ma ndalë gjakun, ma lidhën kambën, pak m'u qetësue.

Edhe çikës ia laga buzën me do tambël që ma prunë do gra. Çika i çeli sytë. Gjallë ish.

Mbasi u ra NATO-ja, qatëherë që ka nisë mirë me i bombardue, ata ikën. Filloi me ardhë me na mjekue nji doktor shqiptar. Na dha ndihmën e parë, na ka kepë, na ka ndihmue me do kremna me na e shërue... këtë, edhe zorrën e trashë. Edhe hapa na dha për trauma, se na kallxuem krejt qysh kish ndodhë. Na i mori emna, mbiemna, të dhana plot. Javë për javë me ardhë me na pa qysh jemi e çka po na vyen ndoj send. Boll rrezik e ka pasë edhe ai. Ai çka ka ba, dikush tjetër s'kish me ba. Herëdokur, Zoti me Xhennet ia shpërbleftë ishallah.

...tybe unë ty nuk të ngas
sall për flokësh të përkas
të të shoh a je e bardhë
a je e amël
porsi dardhë...

Dhetë herë mbasandej pata tentue me e vra veten. Po, veç kur i kallxojke Zoti nanës. Vijke:

- A je këtu?

- Po.

- Ma herët ku ishe? A te bunari?

Dhetë herë pata shkue me kcye n'atë bunar. Ç'me jetue ma? Veç... kur ia ndiejsha zanin nanës, u kthejsha. Dilsha natën e kajsha te bunari. Pikshin lotët atje poshtë. Thojsha: «Sonte po e laj me lot e nesër kam me ardhë me u gjuejtë». Po, zani i nanës më ndalke.

U çue vllau, e msheli atë bunar. Mandej nuk më lejshin, më kontrollojshin. Sa herë më kanë lidhë mos m'u çue, mos me dalë natën. Në mëngjes, veç kur e shihsha veten të lidhme.

*

Tetë javë në spital kam pasë ndejtë. Mbasi jam lëshue, qatë ditë që shkoj në shpi, vjen burri. Edhe në sy të çikave, më kap, më gjuen në krevet. E të nisë me m'i hjekë teshat me zor.

- Hë, a po të vjen lezet? A ish mirë me paramilitarët? A po ndien kënaqësi? – a kështu, a ashtu, bërtit ai mue.

Piskatshin çikat të madhe, kajshin. Kajsha vetë.

Ia baj me dorë të madhës që le të thirrë njerëz me ardhë me ma hjekë. Ngajtën çikat e e thirrën kojshinë. Erdh' ai e ma hoq prej trupit.

Mbas dy muejsh, kur më banë analiza, po më thonë:

- Ti grue je shtatzanë!

- Çka?! Po du me abortu! Po du me abortu!

*

Nji ditë po i thotë vllau nanës:

- Due me u nda prej grues!

Nana:

- E ti, çka na ke kallxue neve? Çka të kanë pasë ba ty në burg të Smrekonicës? Kur pate dalë, a e mban mend çka hjekshe prej zorrës së trashë? Edhe asaj... Me zor, me qef jo!

Po vllau:

- Nuk po muj bre nanë m'u përmbajtë ma, kur po di që ma ka pasë shkau gruen.

- Djali jem, banu i fortë! Kqyri motrat, kqyre gruen!

- S'po muj me e përballue. Ma mirë krejt m'u nda!

Kur nana:

- A me ta kallxue edhe nana nji punë?

I thotë:

- Çka?

- A e din ti që... që edhe nanën tande... Jo! S'të kallxoj kurrë për jetë!

*

Ish çue:

-Veç due me e lanë!

Nana, jo, s'ban, qysh me e lanë; ai, po, due.

Qatëherë nisi nana, po don me i kallxue edhe për veti, po... u pre. S'po mundet. Nisën lotë p'i rrjedhin për faqe. Veç... e kuptoi vllau pse iu pre fjala. Mbet njiherë. Hiç s'po fol.

I ka mblue sytë me shuplaka. Për tokë u lëshue prej së ligshti, e kaj, e kaj, me za tue kajtë. U avitëm na, me nanën, me motrën, mundohu me e qetësue. Nana përqafe, puthja lotët.

Kur... dikur u çue, të na kapi të tanave n'grykë. Kaj na të tanë, lotët qetu qe te mjekrra që na u përpjekshin.

*

Jo, gruen s'e la. Edhe mirë shkojnë, se qe, edhe unë qetu me ta tue rrnue tash sa vjet që u banë. Edhe motra. E po shkojnë mirë shyqyr. Edhe na motrat me kunatë, shumë mirë. Veç... qajo motër që më rrin pak ma mërzitshëm se... Burri e ka lanë. Katër çika ajo. Të tana te baba i vet ato.

...tybe unë ty nuk të ngas
sall për ballit të përkas
të të shoh a je e hollë
faqekuqe
porsi mollë.

NJË KAFE JASHTË RADHE

Tregim nga Ylli Ajdini



Pavarësisht se kujtesa nuk më solli asnjë të njohur, gjithësesi, tek po spostohesha nga salloni për në dhomën e gjumit për të fjetur, mendova se çfarë dreqin po ndodh kështu me njerzit në qytetin tim?! Por të nesërmen në mëngjes u zgjova thuajse në të njëjtën orë, si zakonisht. U vesha dhe dola. Pas pak minutash mbrita në qendër të lagjes ku banoj, po e njëjta zhurmë, gjithashtu po e njëjta aromë e pështirë del nga dyqani i peshkut. U përshëndeta si përherë me gazetashitësin, bleva gazetën javore letrare "Ex-Libris" dhe mandej bëra pak më lartë nga kioska ku shiten gazetat, për të shfrytëzuar mesa të mundja freskinë e një hijeje pallati. Njëkohësisht i telefonova dhe një shoku për të pirë kafen e mëngjesit, të cilit, ja kisha bërë ftesën që mbrëmë. Ndërkohë që të mos ndjeja bezdinë që të shkakton pritja, i shtyrë dhe nga një kureshtje e pashpjegueshme, i hedh një sy tabelës së njoftimeve mortore. Këtë nuk se e kam ves si disa, por e pashë. Nuk i njoha të gjithë dhe s'ka se si. Por..."Mos, jooo! Ç'pate me veten!? Nuk ishte për ty ky udhëtim"! Sidoqoftë, nuk desha as ta besoja dhe as ta pranoja vdekjen e tij. Por është e vërtet, ai është, Lenci është, komshiu im. Jo vetëm emri, por edhe fotografia është e tij, ndaj s'kam më arsye të dyshoj tek faktet. Dhe pa dyshim e sigurisht që nuk do ta pranoja edhe sikur dikush të ma pohonte, por si s'më vajti mendja qysh mbrëmë kur e dhanë lajmet, se L.Ç. mund të ishte Lenci!! Një ndjesi e papërcaktuar më përshkoi trupin, një si këputje e përgjithëshme, një mungesë peshe totale, një si ajo ndjesi mosekzistence që provon pasagjeri kur avjoni bie në boshllëk. Dhe nuk them se prej keqardhjes u shemba përtokë, por ndjeva se zemra po më rrihte me një ritëm disi të shthurur. Lencin e takoja rrallë, ngaqë rrallë vinte në qytetin e lindjes. Herën e fundit kur u takuam, dhe ishte një takim krejtësisht i rastësishëm e krejtësisht i shkurtër, ishte një bisedë e zhvilluar mbi rrugën kryesore që lidh dy shtëpitë tona, më tha se jeton në Greqi dhe se punët i ecnin mirë. "Do rrish shumë", i thashë. "Disa ditë", më tha dhe u ndamë me një: "shihemi". Në buzëqeshjen e tij gjithësesi lexova qartazi një nxitim e mërzi të hidhur. Sigurisht, Lenci kishte ardhë për të dyzetat e nënës, Zanës, të takonte gjithashtu dhe motrën e tij, e cila jetonte deri më dje së bashku me nënën, por, që në vazhdim do i duhet të jetoj vetëm me veten. Gjithësesi, nuk e di se çfarë ndjenje faji dhe brenge e ka detyruar të vari veten! Nuk them as se ka bërë një veprim të pamatur e të pamenduar, por si nuk gjeti në çastin pa çast një motiv për t'u penduar?! Ndoshta nuk mundi të duronte dot mungesën e nënës, trishtimin e vetminë e motrës së sëmurë, apo dhe ndoshta mungesën e një lidhjeje të vet me ndonjë vajzë, ai i di arsyet. Sidoqoftë, rrethanat, morali, sedra, vërtet të vret, po pse kjo duhet ta shpierë njeriun e ndershëm të marrë përsipër përgjegjësi të padëshiruara? Unë nuk kam dëgjuar deri më tani ndonjë të korruptuar ose krieminel, që edhe për veprime tepër të jashtëligjëshme, të ketë varur veten. Apo mos vallë zemra të lehtësohet kur bën atë që duhet? Se di, se kam lexuar kund këtë mendim....Sidoqoftë, Lenci më qe dukur një djalë i përgjegjshëm, i qetë, me norma dhe i shoqërisë. Për këtë do kisha pranuar më mirë të vetëpranonte t'i nënshtrohej vuajtjes shpirtërore se sa të bënte një gjest të till në dukje fisnikërie.

Teksa ende po pres, te stacioni i linjave urbane, shumë pranë meje, vërej qytetarë që hypin e zbresin zhurmshëm nëpër furgona. Po dëgjoj se një djali të ri, te të 20-at, i paska rënë të fikët, mu para njerzve. U dëgjua të thonë se e ka nga të pangrënët. Për këtë dikush i ofroi ujë. Vura re se dikush tjetër i dha menjëherë një "Belino". Nuk di si ta quaj këtë ditë: të veçantë a të zakonshme? Po ndjej një mpirje të përgjithëshme të trupit. Sidoqoftë shoku ende s'po më vjen. Desha të largohesha dhe nga ajo tabelë, por nuk mundja. Por nuk dua të jem as pre e ndonjë zemërimi. Sepse nuk di kujt duhet t'i zemërohem. Fundja, s'kemi pse dridhemi nga dëshpërimi kur e dimë se sot jeta as në dukje nuk ka ndonjë kuptim. Me këtë nuk dua të them: Vrisni veten, por ju them të mos bëni veprime të pamenduara e të pamatura pavarësisht se jemi përballë një jete të ndyrë. Sepse askush nuk do t'ja dijë për ju.

Dëshpërimi më iku, por jo kujtimet për Lorenc Ç. Tani do të ulem tek ai stoli aty dhe do të pres të më vij shoku. Nuk kam pse zemërohem për vonesën e tij, sepse si duket, jam unë ai që ka dalë në takim më shpejtë nga ç'duhet. Fundja, deri sa jam përballë me Lencin, shoku le të vij kur të doj.

Eh, more Lenci!...Ja, prapë u mërzita! Por kësaj rradhe jo me Lencin, sepse një ditë të gjithë do i thonë lamtumirë kësaj jete. As i mërzitur me vetveten, nuk kam arsye. Por jam në armiqësi me kohën që po i bën njerzit të jenë varre të gjalla, të pakuptueshëm e të pamëshirshëm edhe me veten e tyre.

Ndërsa dua të qetësoj disi emocionet, para syve m'u rishfaq njoftimi mortor: "Përcjellja e të ndjerit për në varrezat e reja të qytetit, bëhet direkt nga morgu. Nisja më orën 10 ". Ç'ironi!...Direkt nga morgu!! Po ku janë turmat e njerzve për të përcjell të ndjerin sipas zakonit? Apo mos vallë janë duke përcjell vetveten? Më vjen për të qeshur. Më vjen të qesh me sociologët për të mirat e "socializimit" shoqëror. Po nuk e di a duhet ta bëj?

Hodha shikimin mbi ngjyrat e pallateve dhe hijet e rrugicave që kam përballë. Sa i urrej hijet e rrugicave! Ndërsa largova shikimin nga hijet, por edhe nga ngjyrat, mendova: "Ndoshta kam kohë. Po të nxitoj, ndoshta mbërij". Rëmbimthi pashë orën: 11 e 13 minuta. Ehh, tani është pak si vonë! Më vjen inat me veten që e lash kohën të ma rrëmbenin mendimet. Vështroj përsëri ambjentin për të larguar plogështinë që më ka kapur. Kësaj rradhe, ambjenti përballë më duket si ato pikturat dadaiste. Sidoqoftë, qartazi po shoh shokun që po afrohet drejt meje duke më buzëqeshur. Sa mirë është kur për disa gjëra nuk di asgjë!

ISTREF HAXHILLARI

Flutura e nënës sime

tregim

Teksa motra zbriste shkallët e shtëpisë, përkrye portës u dha një flutur e kaltër, me pika të lehta bojëgruri, e bukur magji. Praruar nga rrezet e diellit në perëndim, zhytej fashave të dritës, flatronte mbi kokat tona, fshikte krahët mureve, tavanit, kanatave.

Motra mbajti frymën.

- Tataja! - belbëzoi e mallëngjyer.

Lot malli vezulluan faqeve të rreshkura.

U kthye majë gishtave, hapi derën. Flutura u derdh korridorit, përshkoi kuzhinën, kryqëzoi këmbët e vogla mbi oxhak, u rrotullua të orientohej. Kërceu mbi perden e dritares së lumit, vështroi cazë matanë ballkonit, ktheu kokën, sikur donte ta thoshte diçka me gjuhë flatrash. Njihte çdo qoshe të fshehtë nga ato që ne me zor i shquanim. Fëshfëritja e krahëve u ngrit mbi heshtjen misterioze, muzikë e ëmbël pikuar prej qiellit, çau cipën e hollë të plagës dhe ajo zuri të pikojë gjak. Zemra m'u mblodh lëmsh. Si ia kisha dalë dhjetë vjet të ndrydhja mallin për nënën time, si dreqin kisha qeshur e bërë shaka, ndërsa ajo prehej në varrezat e qytetit? Krijesa bojëgruri pruri jehonën e një kohe të artë, kur Tataja i jepte jetë shtëpisë. Vitet rrëshqitën mbrapsht, zëri melodioz vërshoi lumë i rrëmbyer pas shirave litar të pranverës, a jehonë ardhur nga lart, të kallëzonte përrallat e fëmijërisë...

Sa histori të vjetra zhytur humbellës së moteve tregonte nëna ime e mençur, thua ndrynte në mish, eshtra e gjak të fshehtat e botës të cilat nuk i shteri një jetë të tërë! Njihte majë gishtave çdo shtëpi, arë e rrugë mbushur dëngëza me ngjarje, si qenë dikur e si ndryshuan vragave të kohës, dinte çdo varr të vjetër, sheshuar prej kohës, se njerëzia harruar pas punëve të përditshme i patën lënë pas dore. Mbante mend kullat e Jasharit senenë kur i përlau përroi i fryrë për kiamet si të mos qenë kurrë, e dinte ku e pati shtëpinë xha Seli dhe ku e ndërtoi më vonë, i kujtohej hakmarrja e Spahinjve me kolonelin e frëngut që deshi të çnderonte Nadiren, çupën më të bukur të fshatit.

Ledhatonte një rrënjëz domate të shkelur, ngulte sytë diku, harkonte vetullat, para se të dëftente bëmat e çuditshme, ku fantazia ime prej fëmije mezi depërtonte. Personazhet imagjinare lëvrinin nga Guri i Kamjes e Valamara te guvat e Malit të Thatë, nga brigjet e rrëpira të Shkumbinit te Liqeni i Ohrit. Rrëfimet mbanin aromën e barit të kositur ku pluskon era e luleshtrydheve, kundërmimin e dheut kthyer nga parmenda, fërfërimën e pikave të shiut në të mbaruar të ditës. Peizazhet kishin ngjyrat e ftoit të lulëzuar, lulekaçeve të porsaçelura, gjetheve të arrës ngjyer në të gjelbër. Mbushej me frymë të çlodhej dhe tok me fjalët fironin bota e stisur, e bukura e dheut, divi, ariu i kafenjtë. Ndërsa vija e ujit, kopshti i vaditur, filizi i drejtuar i domates ishin aty njëlloj si më parë, mendja ime e njomë orvatej të kuptonte si i ia dilte arra të ngjyente një më një tërë ato fletë!

E sëndisja sa s'thuhet me kureshtjen time të mallkuar, po tinës vija re se në një farë mënyre e çlodhja nga andrallat. Shpesh s'kishte nge, sajonte aty për aty përralla të reja, ose fillonte nga e para të vjetrat, të më hiqte qafe.

- Më nxori nga mendtë! - e dëgjova t'i thoshte një mbrëmje hake Këzes, - bëra si bëra çalltisa një, po do ti humba fillin. Ai s'dha e mori, e vazhdoi gjer në fund pa gabuar, ke parë kështu malukati?

Bari i kositur livadheve, yjet kupës qiellore, oshtima e erës zemrës së dimrit, kënga e përrenjve gufuar nga bora e shkrirë e gazmonin. Harmonia e botës, paqja, mirësia njerëzore ishin parime e saj më të larta. Nuk njihja tjetër të prekte aq fisnikërisht zogun e rrëzuar nga shtrofulla, një filiz të çapëlyer kumbulle, këmbën e kalit të plagosur, nanurisur me shprehje hirplote si të qenë fëmijët e saj. Ku i gjente tërë ato fjalë? Si ia dilte të shkërbente njërin pas tjetrit zërin e çjerrë të sprijës së ligë, pastaj pështpërimën e ëmbël të engjëllit? Si arrinte të bënte bashkë fjalët e njerëzve me hungërimat, mjaullitjet, bulurimat e kafshëve? Sa dua ta dëgjoj tani atë zë plot ngjyra, të shijoj pamjen e ëmbël prej nuseje me sy të perënduar nga dhuntia e rrëfimit!

I mësova një për një përrallat me xhinde, katallanë, botën e nëndheshme të vdekatarëve, historitë e burrave zulmëmëdhenj që vulosën dikur fatet e vendit. Të folurit e pleqve, zërin e ngjirur të kapedanit, britmat e komitëve, i mbajta mend gjer vonë, pa ditur se do të më hynin aq shumë në punën time të ardhshme. Kur shkruaj, ndiej vështrimin e syve të saj prej qiellit dhe ngutem të mbush faqet njërën pas tjetrës. E shtrenjta nënë më dha leksionin e parë të letërsisë.

Librat e mi mbajnë hiret e saj...

Tetë vjet s'u mësua me qytetin, thua pati ardhur mikeshë për pak kohë, priste të kthehej atje ku i bënte shpirti rehat. Dilte në ballkon, kulloste sytë maleve ku gjelbëronte lisi, rrugëve mbushur me kalimtarë, masës stërmadhe të ujit në liqen.

- Pashë xha Minin sot, - tregoi një mbrëmje, - ishte plakur e kërrusur i shkreti, ama u çmalla, sikur solli një grusht dhe' fshati poshtë ballkonit.

Sytë i ndrisnin nga gëzimi.

Të nesërmen kërkoi ta shpinim në fshat.

- Sa të çmallem me njerëzit, - psherëtiu e menduar.

- Nja dy-tre ditë, - i thashë buzagaz.

- Epo çdo të rri më shumë! - u gjegj serioze.

Mbështetur krahut të motrës u ra kryq e tërthor udhëve të fshatit, bekoi me ujë e kripë varret e të parëve, takoi moshatarët pakësuar së tepërmi viteve të fundit. Sytë e mbushur binin të malluar mbi njerëzit, shtëpitë, kasollet, të mbjellat. Çdo fillim gushti vinte me babanë të shinin thekrën në Kozic, qëndronin dy javë larg shtëpisë. Tani nuk ngjitej dot ta shihte për herë të fundit. Lot të nxehtë iu mblodhën nën mjekër.

Në mbrëmje zuri vendin e dikurshëm pas trungut të arrës së madhe, plasaritur e zgavruar nga vitet. Dielli në të perënduar lyente me purpur bashkat e reve, tisi ngjyrë bronzi ndehej si njëherë e një kohë mbi gjethnajën vigane, flladi erëmirë ia ledhatonte cullufet mikeshës së vjetër. Kushedi sa herë pati kuvenduar aty me moshataret, kushedi sa herë patën qeshur e qarë me gazet e brengat e jetës. Tani shumica preheshin në pllajën me tuma dheu matanë lumit, të gjallat rrëgjuar pleqërie, nuk çapiteshin dot gjer te arra. Sytë e mjegulluar nga lotët u endën skutave ku rrinin atëherë. Tikua hundëmadhe shtrohej mbi koritën kthyer përmbys, pinte duhan, nuk linte njeri pa ngarë. Këzja ulur në bisht për qosh trungut numëronte dertet e pambaruara.

Befas iu bë se Ishka pas saj, lëvizi vendit, i vuri dorën në pëqi.

- Erdhe, tata Selviko? Të kemi pritur, na mbetën sytë udhës së qytetit!

S'pati fat e zeza, burrë sa për të thënë, një e dy çapin aty e mbante, nxirrte gulçin.

- Ç't'i bësh! - bashkoi dorën më të sajën, - ky qe fati yt.

- Pse kaq i hidhur?

- E de, mjaft u qave, ka më keq.

- Ashtu xhanëm! - fshiu hundët me mëngën e fustanit.

- S'e paske harruar zakonin, sa herë të kam thënë? Tuhaf njeri mbete!

- Uh, harrova, ama dhe ti!

- Për të mirën tënde e kam.

- Mirë të thotë, - e ngau Këzja, - na e shpife!

- E de, mirë, oj po kjo!

Qeshën të gjitha.

- Sheqere, ti je moj derëbardhë? Sa më paska zënë malli! - iu kthye rrënjës së dalë të arrës, ku rrinte duarkryq me sytë përdhe.

Ajo tundi kokën si t'i thoshte:

- Unë që mos qofsha, hanko Selviko!

- Si nuk fole njëherë, vetëm dëgjo e qesh.

- Tani s'mundem, - iu bë të përgjigjej Sheqerja.

- Epo s'ke se si!

Ajri kërciste, thua shpirtrat e uritur nga malli orvateshin ta ceknin me duar prej ajri. Dhe s'kishin faj, i la të prisnin gjatë!

- Ndjesë paçin, - ngriti zërin, - sa të mira ishin!

Ku ta dinte ç'i ndodhi? Ndoshta mosha bënte të vetën, ndoshta shpirti i ngazëllyer në atë perëndimi të hatashëm dielli u bë njësh me to.

Përkëdheli me sy siluetat e mbledhura për hatrin e saj, rregulloi shaminë, i vuri dorën në sup së bijës, zverdhur gjethe ftoi.

- Se si m'u duk, - u shfajësua, - thua erdhën vërtet!...

Në krye të javës nuk më nxinte shtëpia, një lëmsh në fund të barkut më pengonte të merrja frymë lirisht. Pse kërkoi ta shpinim edhe njëherë atje? Pse ndenji aq gjatë? Mos përfundoi në varreza dhe nuk donin të më thoshin? Mora gjithë ankth rrugën e fshatit ta shtija edhe njëherë ndër sy. Përfund arës së lumit shqova siluetën e drejtë, supet e ngritura, floknajën verdhashe dhe më vajti zemra në vend. Ecte sa ecte, ndalonte pak, bënte më tej të merrte sa më shumë mbresa.

Motra e ndiqte kokëvarur.

Vrapova sa do ta kishte zili çdo kampion atletike, i hodha krahët rreth qafës, i futa kokën në gji, e nuhata...

E pamundur të ngopesha, sikur edhe e kisha edhe s'e kisha aty.

- Ngadalë, ore, më mbyte! - qeshi me masë.

Si më pa të zbehur, e kuptoi.

- Mos bëj kështu, ja ku e ke nënën tënde. S'i kam mbaruar të gjitha punët e kësaj bote, tërë ata nipa e mbesa pa martuar!

Nuk ia vura veshin.

- Erdha të marr, - i thashë.

M'i hodhi sytë e bukur, të lodhur.

- Prit ore, të çmallem cazë, ku dihet çka shkruar Zoti?

- Mjaft sivjet, ja erdhi moti, - zvarrita fjalët sa më qetë munda.

Nuk i thashë se mezi e shtyva një javë, se po të ikte andej nga e thërriste s'di se kush, do të marrosesha, se ishte përtej mundësive të duroja...

Ende kërthi, një mëngjes gushti në valën e punëve, u gdhiva aq sëmurë, sa të gjithë ma hoqën fillin, përveç saj.

- Nuk do të vdesë, - u tha motrave.

Ato prenë të qarat...

- Pse aq e sigurt? - e pyeta vite më vonë.

- E pashë në sytë e tu, - u përgjigj gjysmë me shaka, - nuk vuaje nga ndonjë sëmundje, hidhje vickla si mushkat se të lashë vetëm atë ditë...

Njëlloj si atëherë më dhembte trupi, më çanin kockat, mendja më vinte rrotull, s'isha as në qiell, as në tokë.

I erdhi keq, ma mori kokën në gji, siç bënte gjithnjë në vogëlinë time.

- Po ti qenke prush, o bir!

Përfshiu me sy të rrëmbushur shtëpinë, pusin, arrën, bahçen e mollëve gjer tutje ku arrinte vështrimi. Ia kishte ënda të rrinte edhe ca, të çmallej me njerëzit, dheun, varret e të afërmve, po unë e desha të tërën për vete.

Rëndova më tepër.

- Njeriu s'ngopet kurrë me vendin e tij, - psherëtiu.

Sa u kthye zuri shtratin. Humbi gjallërinë e dikurshme, bebëzat iu

çngjyrosën. E gdhinte me sytë tretur rrugës së Tiranës, ku qëllonte të vonohesha me tim vëlla.

- Do të vinë, ke për të parë, - i jepte kurajë gruaja.

Lutej me vete të kishte të drejtë.

- Ah, moj bijë, nënë mos qofsh, veç për keq shkon mendja.

Ktheheshim, i vinte çehrja, na prekte duart e ngrira nga të ftohtit e janarit.

- Sa i ëmbël evlati! - pëshpëriste me zë të mpakur...

Flutura ndaloi mbi supet e motrës, nguli këmbët leshrave, përplasi krahët të ruante ekuilibrin. Sa herë matej të ngrihej fluturim, ndërronte mendje, kthehej t'i terte lotët.

Nuk i ndava sytë...

Ditën fatale erdhëm afër mëngjesit. S'u ankua, lëvizi paksa kokën, na vështroi me sy të shuar. Thirrëm ambulancën, e zumë për krahësh të zbrisnim shkallët. Këmbët mezi i hidhte, më shumë e mbanim peshë.

- Pret makina! - e nguta.

Shpejtoi pak hapin, më hodhi sytë e murrëtuar, sikur donte të thoshte:

" S'e shikon si jam katandisur, o bir? "

Ato fjalë më gjëmojnë në vesh sot e kësaj dite. Si nuk telefonova të mos e gdhinte natën në ballkon atij janari të acartë?! Si nuk më shkoi mendja ta shpija më parë te mjeku? Përse vonova aq shumë?

- E le pas dore, - më tha atëherë shoku im Kimi.

Desha t'i shkrehesha, po sakaq e kuptova, sytë e tij të çiltër thoshin të vërtetën! Dhjetë vjet mbajta mbi shpinë barrën e rëndë të fajit. Qava, thirra si i marrë, përplasa kokën pas oxhakut pa kurrfarë dobie.

Guri i fajit u fundos thellë e më thellë.

Plaga zuri kore...

I thashë vëllait të njoftonte motrën e madhe në Tiranë. Ajo ngriti sytë ta shihte, thua do t'i vinte atij çasti. Si nuk e pa, u ndeh pa frymë, mbylli sytë. U mblodhëm gjithë sa ishim, e përmendëm. T'i kishte ardhur Shqipja, do të mbaronte, nuk mund të ikte pa e parë për herë të fundit.

Tërë natën në jerm, jepte e merrte.

Ne qanim fshehtas.

- Nuk do ta shohim më kurrë, - çau heshtjen një zë i ngashëryer.

Gruaja ime u sul jashtë, duke shkulur leshrat.

Ne, pjellat e saj, që as guxonim ta sillnim në mendje vdekjen, u dorëzuam. Motrat dilnin një nga një, mekeshin së qari diku, kthehesin me bebëza flakë të kuqe.

Tataja i diktoi, nuk u mashtrua as tani në grahmat e fundit.

- Mos ikni, - u tha me ndërprerje zëri, - dua t'u shoh, s'kam kohë.

Kaloi sytë nga motra e madhe te vëllai, i fundit i fëmijëve.

- I vogli i nënës, - lëvizi buzët mundimshëm të prapmen herë.

Mbylli sytë...

Flutura kaltëroshe fëshfëriti krahët u ngrit, më preku shkarazi llërën, iku si të kishte përmbushur misionin e vet qiellor. Vitet s'paskëshin bërë tjetër përveçse të zbërdhulnin së kujtimet si fotografitë e vjetra në mur. Malli kishte marrë fytyrën e pritjes. U plasa në dysheme, e qava përsëdyti të bukurën time leshra flori. Motra fshiu lotët me cep të shamisë, u qas, mbështeti dorën supit tim, më ledhatoi me dashurinë e vet dhe nënës përzier së toku.

- E zuri malli, pa u kthye, - pëshpëriti e përmalluar, - të qe zemëruar nuk vinte.

Unë nuk e mblidhja dot veten...

MEHMET ELEZI

31 poezi hajk

tregim

1.
Bota u zvogëlua, sa një kokërr mollë
Dikush do ta kafshojë prapë
Eva a Borëbardha?

2.
Në një zyrë u përdhunua një grua
Nëna e përdhunuesit u përpëlit në varr
Dheu u plasarit deri te Kau i Zi

3.
Desha me u ba i gjithfuqishëm si ëndërr
Një ëndërr mund t'i ngjallë të vdekurit mbarë
Ah! ku me e çue atë ushtri pafund!

4.
Molla në kokë, rastësi a fat
Njutoni zbuloi ligjin e rëndesës
Për ligjin e Fatit s'ka Njuton kjo botë

5.
Kjo vogëlushe u nis e lumtur për në shkollë
Çanta, shishja e ujit dhe një shkrepëse
Për kur të shuhet Dielli

6.
Nga poshtë gjergjefi nyje e shëmti
Ai lart, që qëndis
Sheh lulnajën në prehër

7.
Ujkut ia kursyen plumbin
I varën një kumbonë në qafë
Ai cofi úni [1]

8.
Natyrë e qetë:
Ballkoni me lule, dielli në një vazo, filxhanët e kafes
Ne të dy

9.
Ai, në gropë pa emër
Deri në qiell shtatore tjetri
Cili është heroi?

10.
Rrnove një ditë, rrnove njëmijë vjet
Parë nga hapësirat e pamata të vdekjes
Njësoj, një kokrrizë rëre

11.
Mirënjohja? Ky tipar i qenit!
E dëgjoi mirënjohja
Dhe u mbyt në lumë

12.
Bleta vdes
Nëse ta ngul thinxin
Ju lutem mos i bini në qafë

13.
Ç'hapësirë e zbrazët pas Kadaresë!
Me emrin e Tij
Dyer të zdritshme kam hapur nëpër botë

14.
Ai ndërroi jetë
Nga biblioteka doli tym
U dogjën pergamenë librash të pashkruar

15.
Thuaji je e mençur, mirë i vjen
Thuaji je e bukur, me flatra bëhet
Mos po e humb betejën mençuria?

16.
Gjeli në zenit të plehut
Tërmet në koloninë e krimbave
Bota rri e qetë, gjeli s'ka penis

17.
Ky kalë, prit e prit skaj kalorësit të vdekur
Dimri e shndërroi në shtatore bore
O njerëz, paçi fisnikërinë e kafshëve

18.
Lajmi i parë: koncert roku në stadium
Lajm i gjashtë
Të vrarë rrumbullak dyzet mijë në Gazë

19.
Mend gjen sa të duash rrugës me pluhur
Mjafton me i zbritë kalit
E me i mbledhë

20.
Dantja s'paskish rënë në dashuri me Beatriçen
Ai adhuronte
Bukurinë

21.
Njëqind vjet Kosova
Dhimbje ashti
Ashti s'kalbet, dhemb edhe në varr

22.
Kaloi një grua veshur me shije
Sytë e tij e shikonin
Të zhveshur

23.
Kush është i madh e kush i vogël?
Një virus i padukshëm
E gjunjëzoi planetin

24.
Sa herë çoj lule te të dashurit e mi
Takoj Nerudën
Kah bën një dush varrezash

25.
Ky qytet vishet me petka të vdekurish
Kujdes
Është më i gjallë se tërë të gjallët

26.
E priti Shën-Pjetri në derë të Parajsës
Kush priste në atë derë
Para Shën-Pjetrit?

27.
Djepi në kullën e moçme
E përkund era
Asnjë e qarë nuk dëgjohet

28.
Mjerë njeriu, në ardhshin jashtëtokësorët
Do pushtime tokësorësh
Më pak të frikshme janë?

29.
Ti s'ke me hangër,
Ai nuk ngihet kurrë
Varfëri pa fund

30.
Më rrej diçka të bukur
Një rrenë e bardhë
Më mban 24 orë

31.
Kryeheroi vjen turist një natë vere
Konjak Skënderbe, dhallë Skënderbe, lider Skënderbe
Darkë lëng groshe Skënderbe dhe zhduket

---

1 Ngordhi urie.

Atë Ndon Belushit në 90-vjetorin e lindjes

Rrugëtimi i një misionari: model përkushtimi për arbërorët dhe arbërinë

Nga Vilma Proko

Studiuese, QENDRA E STUDIMEVE DHE PUBLIKIMEVE PËR ARBËRESHËT

Arbëria e Arbëreshëve ngjason me një grua, e cila mban veshur një fustan të sajuar nga fijet e mitit e të historisë, të stolisur me perla "të gjakut të shprishur", të zbukuruar me lule të egra, ku dielli dimëror derdh pikëza të arta. Flladi i kujtimeve vjen si një serenatë me motivin e Moresë dhe koha vijon të lërë gjurmët e saj.

Arbëreshit i veshën tipare greke, por në ofshamën e zërit të lodhur rrëfehet historia e tij e largët, e lashtë, ku shpirti mbledh në amforën e vet antike arbëreshët madhështorë.

*Një "stoli tinëzake" është asimilimi i tyre; një piton, që po i tkurr, duke i shndërruar ata në një fragment jo më të madh se një pullë poste, por të mos harrojmë: janë ende 50 kartolina, plot 50 puzzle-a gjigantë arbërorë në tokën italiane**.

*Marrë nga libri Rrugëtim në ngulimet arbëreshe (50 kartolina gjigante arbërore në tokën italiane). Antonio Bellusci & Ornela Radovicka. Botuar nga Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA), Tiranë 2020, 452 f.

Më 15 shtator Atë Ndon Belushi (Antonio Bellusci), një nga Patriarkët e fundit të mëdhenj të Botës Arbëreshe do të festonte 90-vjetorin e lindjes. Me plot kontribute të jashtëzakonshme si rrallëkush Ai ka qenë dhe do të mbetet jo thjesht një udhëheqës shpirtëror për Arbëreshët në Itali e gjetkë, por edhe për Arvanitasit në Greqi, për të cilët la pas të dhëna thelbësore. Papas Ndoni ishte një dijetar, kërkues e studiues me zemër e shpirt të madh! Si prift famullitar, mësues, shkrimtar, publicist, etnolog, gazetar dhe historian prej më shumë se gjysmë shekulli, me urtësi, pasion dhe përkushtim kontribuoi për njohjen, ruajtjen dhe zhvillimin e kulturës, historisë, gjuhës dhe zakoneve të popullit arbëror dhe u shqua për veprimtarinë e paepur në përçimin dhe forcimin e identitetit kombëtar shqiptar.

Kam pasur fatin që të komunikoj personalisht me të nderuarin Zoti Belushi dhe kolegen e tij, Znj. Ornela Radovicka gjatë periudhës përgatitore për realizimin e Kuvendit të Parë të Studimeve Arbëreshe[1], që nga fundviti i 2020-ës e deri në ditët e fundit para zhvillimit të punimeve të Kuvendit, si edhe më 27 dhe 28 shtator të 2021-it (data në të cilat u mbajt ky Kuvend i organizuar nga Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA).

Gjatë një seance Papas Belushi e përshëndeti Kuvendin dhe të pranishmit përmes kamerave, pasi në atë periudhë të vështirë pandemie nuk e pati të mundur të merrte pjesë fizikisht. Citoj më poshtë studiuesin Kristaq Jorgo në statusin e tij të *face book-ut* më 20 qershor 2024, me rastin e ndarjes nga jeta të Atë Belushit (19 qershor 2024), i cili na mundësoi tanskriptimin e fillimit dhe të fundit të përshëndetjes së mrekullueshme të Papas Belushit dhe së Motrës, znj. Rina, që nisi e u mbyll me këngë e ngjalli emocione të rralla tek të pranishmit në sallën e Muzeut Kombëtar në Tiranë ku organizohej ky kuvend i parë arbëresh.

Papas Antonio Belushi:

Faleminderit të gjithëve juve, vëllezër të dashur!

Ju kam në zëmrë e ju falënderoj shumë-shumë për këtë nderim të madh që më jipni sot. Fatkeqësisht nuk pata mundësi të vij në Tiranë.

Po këtu, te shpia ime, bashkë me motrën time fillomi kështu këtë bisedë me ju:

Është kënga e mërgimtarëve të Diasporës që një prift, Pietro Kamodeka nga Kastërneçi më 1890 bëri për ne Arbëreshët, për ne Arbëreshët:

"*Me vërtë të mirat tona,*
Na i kemi te Korona.
Është' një vend e mirë me ne,
Moj e bukura More.
Dhe unë pjas me lot në sí
Oj Arbresh, oj Arbëri."

Kjo këngë vë kështu përpara sívet vendet tanë, varrezat e Atërve tanë të paharruar, atje në tokën e Moresë...

.....

Na jemi gjallë!

Ju përshëndesim e ju urojmë shëndet të gjithëve dhe me motrën time ju lshomë (ndahemi prej jush – K.J.) me një këngë:

Eja mblidhuni këtu, këtu, këtu,
Eja mblidhuni këtu, këtu, këtu,
Eja mblidhuni këtu, këtu, këtu,
Bashkë me ne.
Eja mblidhuni këtu, këtu, këtu,
Eja mblidhuni këtu, këtu, këtu,
Eja mblidhuni këtu, këtu, këtu,
Bashkë me ne...
Rroftë Shqipëria e Zëmrës! Për shumë vjet!
Mirupafshim!
Mirupafshim!
Shumë të mira!
[Duartrokitje]

Ndoshta fjala e fundit publike e Tij, apo amaneti i Tij drejtuar Botës Shqiptare".

Atë Antonio Belushi do të kujtohet si një atdhetar i madh, i cili, edhe pse i lindur në një ditë shtatori të vitit 1934, në një vend të bukur rrëzë Malit Pulin, në Frasnitë (Frascineto) të Kozencës dhe i rritur në Kalabri, me gjuhën e bukur shqipe, të përzier edhe me variantin e vjetër të saj, arbërishten, dha njoftime për historinë e këtij kombi të ndarë, duke pasur në mendje sidomos arvanitasit. Më 1962 Atë Belushi kreu studimet për filozofi dhe teologji në Universitetin Pontifik Gregorian të Romës dhe në vitet 1965–1973 shërbeu si famullitar në fshatin arbëresh Shën Kostandin (San Costantino Albanese) në krahinën e Potencës (në Jug të Bazilikatës), ndërsa në vitet 1973–1979 në Fallkunarë (Falconara Albanese), duke e rikthyer këtë Kishë Arbëreshe nga riti latin në ritin bizantin. Prej vitit 1979 deri në vitin 2000 shërbeu si famullitar në kishat arbëreshe të Kozencës dhe prej vitit 2000 në Kastrovilari. Krahas angazhimit baritor, Atë Belushi u përkushtua gjatë gjithë jetës për mbrojtjen, promovimin dhe vlerësimin e trashëgimisë arbëreshe. Duket se dëshira e Tij më e madhe ishte të rilidhte Arbëreshët e shpërndarë nëpër botë. Atë Ndoni është autor i 25 veprave shkencore mbi kulturën, etnografinë dhe historinë arbëreshe, ndët të cilët: "Këngë fetare arbëreshe" ("Canti sacri tradicionali albanesi") 1971; "Magjia, mite dhe besime popullore" ("Magia, miti e credenze popolari") 1983; "Fjalor Frazeologjik i Arbëreshëvet në Itali dhe Arbërorëve në Greqi" ("Dizionario fraseologico degli Albanesi d'Italia e di Grecia") 1989; "Blegtoria e Frasnitës në tekstet origjinale arbëreshe" ("La Pastorizia a Frascineto nei testi originali arbëreshë" ("La pastorizia: - Ricerca etnografia tra gli albanesi di Frascineto", 1991; "Arbërorët-Arvanitë" ("Gli Arbërori-Arvaniti–Un popolo invisibile–Ricerche etnografiche nell'Ellade (1965-2000), 2004; "Kërkime dhe studime ndër arbërorët e Helladhës", 1994, 2005; "Antologji arbëreshe" (Prozë dhe poezi gojore/Tekste në të folmet arbëreshe), 2009 etj.

Interesi i hershëm i Papas Belushit për punë kërkimore në terren vihet re qysh nga vitet e shënimit kur janë mbledhur këto vlera etno-folklorike dhe katundet ku janë regjistruar. Në bibliotekën e QSPA-së gjenden një numër i konsiderueshëm i librave të Atë Belushit[2] si edhe dhe botime të autorëve të ndryshëm në nder të Tij,[3] dhuruar nga biblioteka e Tij personale.

Atë Belushi qe nismëtar e luftëtar i betejave që kanë shenjuar një hulli të fortë: ruajtjen e vlerës unike të trashëgimisë arbëreshe. Në vitet 1966–1970 themeloi dhe drejtoi revistën e parë arbëreshe në krahinën e Bazilikatës

1 "Gjendja aktuale e studimeve për Arbëreshët", Aktet e Kuvendit të Parë të Studimeve Arbëreshe. Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA), Tiranë 2022.

2 Botime të tjera në bibliotekën e QSPA-së sipas klasifikimit të vetë Atë Ndoni Belushit: 1-1971
A. Bellusci, *Canti sacri tradizionali albanesi/Kalimere Arbëreshe, - Raccolti a S. Costantino Albanese, S. Sofia d'Epiro e in alcune comunità albanesi di Grecia e trascritti in musica - /Arbërishst dhe litalisht- Presentazione di Mons. Giovanni Stamati, vescovo di Lungo,* Edizioni Centro Ricerche, S. Costantino Albanese 1971, pp.80; II Edizione, Cosenza1991.
2-1977
A. Bellusci, Il telaio nei testi originali arbëreshë con traduzione italiana/Argali andër tekstet origjinale arbëreshë**Arbërishst dhe litalisht-* Ricerca etnografica tra gli albanesi di Calabria, Basilicata e Grecia - Presentazione del Prof. Giuseppe Trebisacce - Nota bio-bibliografica di Carmelo Candreva, Edizioni Centro Ricerche - Cosenza 1977, pp. 160 * II Edizione, 1990 .
3-1983
A. Bellusci, Magia miti e credenze popolari/Magjia Mite dhe Besime Popullore**Arbërishst dhe litalisht-* Ricerca etnografica tra gli albanesi d'Italia*, Edizioni Centro Ricerche, Cosenza 1983, pp. 136 * II Edizione, 1992- Testi nelle parlate arbereshe con traduzione italiana.
4-1989
A. Bellusci, Dizionario fraseologico degli albanesi d'Italia e di Grecia/Fjalor Frazeologjik/* Testo originale nella parlata albanese * Traduzione in lingua italiana, inglese e francese - Ricerca sul campo in 115 comunità albanofone Indice analitico di oltre 3000 voci riguardanti proverbi, detti e modi di dire - Edizioni Centro Ricerche, Cosenza 1989, pp. 262.
5-1989
A. Bellusci, Vatra Jonë/Il nostro focolare * Periodico di cultura italo-greco-albanese/ *Arbërishst dhe litalisht e anglisht-* - Ricerca etnografica tra gli albanesi di S. Costantino Albanese in Basilicata- Edizioni Centro Ricerche, Cosenza 1991, pp. 215 * (1966, 1967, 1968, 1969/'70).
6-1991
A. Bellusci, La Pastorizia a Frascineto nei testi originali arbëreshë / *Arbërishst dhe litalisht-* * Ricerca Etnografica tra gli albanesi di Frascineto in Calabria * Edizioni Centro Ricerche, Cosenza 1991, pp. 142
7-1994
A. Bellusci, *Ricerche e studi tra gli arberori dell'Ellade * Kërkime dhe studime ndër arbëroret e Helladhes* /Tekste në të folmet arbërore* Da radici arbëreshe in Italia a matrici arberore in Grecia
Testi e documenti * Introduzione in greco dell'Avv. Aristidhis Kolljas (Atene) - Presentazione in albanese del Prof. Gjovalin Shkurtaj (Tirana) - Edizioni Centro Ricerche, Cosenza 1994, pp. 506.
8-2003
A. Bellusci, *Antologia Arbëreshe*–Tekste në të folmet arbëreshe me perkthimin italisht - Ninnananne, strambotti, filastrocche, indovinelli, formule augurali, presagi fausti e infausti, giochi, usanze e credenze popolari-Trascrizione nelle parlate arbëreshe con traduzione italiana, Edizioni centro ricerche "G.Kastriota", Frascineto 2003, pp.220.
9-2004
A. Bellusci, *Gli Arberori-Arvaniti–Un popolo invisibile* – Ricerche etnografiche nell'Ellade (1965-2000)/Tekste në të fomet arbërore në Elladha, Edizioni Centro ricerche "G.Kastriota", Frascineto 2004, pp.360.
10-2007
A. Bellusci/ R. Daniele – *Manoscritti d'archivio nella Biblioteca Internazionale "A.Bellusci"* di Frascineto dal 1\522 al 1966 – Segmenti di vita giuridica, sociale, economica, politica, storica, religiosa e letteraria a Frascineto, comunità albanofona calabrese di rito bizantino-greco dal secolo XV – Premessa di Tommaso Bellusci, Edizioni Centro tricerche "G.Kastriota", Frascineto 2007, pp.448.
11-2008
A. Bellusci, *La Biblioteca Arbëreshe Bizantina "A. Bellusci",Tekste në shumë gjuhë sipas vizitatoret në Bibliotekë* - Editore Centro G. Kastriota, Frascineto 2008, pp. 485.
12-2009
A. Bellusci, *Antologji Arbëreshe - Prozë dhe poezi gojore* /Tekste në të folmet arbëreshe, Editore G. Kastriota, Frascineto 2009, pp.230.
13-2009
A. Bellusci, *La Parrocchia Bizantina S. Maria Assunta du Frascineto,* Editore Centro G. Kastriota, Frascineto 2009, pp. 230.
14-2019
A. Bellusci–Burigana Riccardo, *Storia dell'Eparchia di Lungro–Le comunità albanofone di rito bizantino in Calabria dal 1439 al 1919*, , v. I, Centro Storia Ecumenismo in IItalia, Venezia 2019, pp.78.
15-2020
A. Bellusci– Burigana Riccardo, *Storia dell'Eparchia di Lungro–L'Eparchia di Lungro degli Italo-Albanesio dell'Italia Continentale,* , v. II, Centro Storia Ecumenismo in IItalia, Venezia 2020, pp.299.
16-2021
A. Bellusci, La cultura tradizionale a San Costantino Albanese /Kultura tradicionale në Shën Kostandin Arbëresh /Tekste në të folmen e katundit, Ricerca sul campo 1965-1973, Ed.Squilibri, Roma 2021, pp. 250.
3 178-2000
A. Kolljas, *Antonio Bellusci e la magia della tradizione popolare*, Tekst në gjuhën greqishte, Edizione Dodoni, Atene 2000, pp. 147.
18-2019
O. Radovicka, *Antonio Bellusci – Rrugëtimi i një arbëreshi - Jeta vepra kujtime,* Ed. Malika, Tirana 2019, pp.228.





"Vatra jonë" ("Il nostro focolare"); që nga prilli i 1980-ës themelues i revistës periodike "Lidhja" (L'Unione)-organ gjashtëmujor informativ, kulturor e shoqëror i qytetit të Kozencës dhe drejtues i saj. Me 4 vëllimet (Nr. 1, 1980 – nr. 20, 1988; nr. 21, 1989–nr. 36, 1996; nr. 36, 1998–nr. 54, 2005 dhe nr. 56, 2066–nr. 60, 2009) revista përbën një pasuri kulturore me vlerë të përhershme për gjithë Arbërinë, për Diasporën, për Shqipërinë, për Kosovën dhe për vëllezërit arbërorë-arvanitë në Elladhë. Në faqet e saj gjen informacione për të gjitha udhëtimet dhe reportazhet shqip të Papas Belushit me takimet dhe bisedat e tij me personalitetet më të shquar shqiptarë në botë. Në këtë vështrim kjo revistë shërben si një arkiv historiko-kulturor-etnografik e gjuhësor për t'u hulumtuar. Belushi është autor i artikujve e shkrimeve me tematikë të gjerë edhe në periodikë të ndryshëm: "Zgjimi", "Katundi ynë", "Studime filologjike", "Përparimi" etj. Si mik, sivëlla e bashkëveprimtar i Ernest Koliqit kontribuoi me materiale arbëreshe në pasurimin e përmbajtjes së revistës albanologjike "Shêjzat", e cila që nga themelimi (1957) shërbeu si tribunë dhe si dritare informimi mbi aktivitetet shkencore albanologjike në botë, duke vijuar traditën kulturore të Rilindjes dhe sidomos të revistave të periudhës mes dy luftërave botërore në Shqipëri.

Atë Belushi që nga viti 1962 ka kryer udhëtime, studime dhe kërkime etnografike në vende të ndryshme dhe ka marrë pjesë në veprimtari shkencore në kuvende, kongrese në Itali, Shqipëri, Kosovë, Itali, SHBA e Australi. Ishte i vetmi pjesëmarrës arbëresh në Kuvendin I të Studimeve Ilire që u mbajt në Tiranë më 15–20 shtator 1972, (edhe pse u ndalua të hynte në Shqipëri me avion, udhëton me traget për në Tivar e prej andej hyn në kufirin shqiptar përmes Hanit të Hotit).

Arkivi i Atë Belushit përmban me dhjetëra kaseta të incizuara tek Arvanitasit (parapëlqente t'i quante Arbërorë të Greqisë) dhe rreth 2500 foto gjatë hulumtimeve në terren për pothuaj 40 vjet tek Arvanitasit e Greqisë. Është autor i listës së 920 fshatrave arvanitase (arbërore) me toponimet e tyre origjinale, ku janë regjistruar dhe incizuar më tepër se 3000 vetë. Ai ka bashkëpunuar me studiuesit Aristidh Kola (Kollja), Vangjel Ljapis, Jorgo Mihas Marougas e shumë arvanitas të tjerë në përpjekjet për ruajtjen e identitetit të tyre arbëror. Për kontributin e Belushit në mbledhjen e lëndës etno-kuturore ndër Arvanitas Aristidh Kola do të shprehej: "Për studiuesin shkencor të ardhen, materiali që ka "fotografuar", Papas Ndoni (siç e thërrisnin) do të jetë burim me vlerë të madhe studimi. Kërkuesi i ardhem do të mund të ndiekë zhvillimin e folklorit Arvanit për një kohë të gljat, ato të mund të benjë krahasime dhe referime, tuke ditur se nuk është bënë asnjë gjë e gënjeshtert, asnjë perpunim, asnjë ndërhyrje nga mbledhesi në këtë material"[4].

Si mbrojtës i Çështjes së Kosovës Atë Belushi ishte i pari që në vitin 1989 hodhi idenë e Kosovës Republikë. Në vitet 1998–1999 e konsideroi luftën ndaj Kosovës "gjenocid" dhe i dedikoi kësaj tragjedie ndaj popullit kosovar (po këtë vit) një numër special me artikuj dhe kapakun e revistës "Lidhja".

Në vitin 1961 Atë Belushi themeloi Bibliotekën Arbëreshe Ndërkombëtare "Antonio Bellusci" që numëron mbi 10.000 tituj. Në vitin 1980 krijoi Qendrën e Studimeve Albanologjike dhe Kulturës Arbëreshe "Gjergj K. Skënderbeg" (Centro Studi Albanologici e Cultura Arbëreshe), duke qenë edhe drejtor i përgjithshëm i saj deri në fund të jetës. Në vitin 1994 çeli shkollën e parë për fëmijët shqiptarë në Diasporë pranë bibliotekës së tij të veçantë që të sjell më tepër ndër mend arkivat e pasura e të njohura, se sa një bibliotekë të thjeshtë ku mahnitesh me arkivimin e shtypit shqiptar gjithandej globit me aq saktësi e respekt dhe pa asnjë përjashtim[5]. Në raftet e saj, mbushur plot e përplot me libra qëndron në vendin e merituar e me hijeshi busti i Skënderbeut.

Atë Belushi kishte shumë miq e dashamirë intelektualë, burrështetash, studiues e krijues nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe nga vende tjera të hapësirave shqiptare. Shtëpia e tij me kohë ishte bërë qendër "pelegrinazhi" për të gjithë ata që e vizitonin Kalabrinë e Sicilinë. Ndërkaq, në kasetat e incizuara rrëfen vështirësitë e pengesat që kish hasur nga autoritetet greke, me rastin e vizitave të vëllezërve shqiptarë, për qëllime studimore në hapësirat e shtrira që nga Morea deri në kufirin verior të Çamërisë[6].

Në shenjë mirënjohjeje për të gjithë veprimtarinë e tij për ruajtjen e identitetit arbëresh është nderuar nga komuna e Çiftit me titullin "Kalorës i Skënderbeut" ("Cavaliere di Skanderbeg"). Ndërkaq, për kontributet e dhëna në përhapjen, njohjen, studimin, ruajtjen dhe pasurimin e historisë, gjuhës, zakoneve dhe kulturës së rrallë arbëreshe, si dhe asaj arvanitase ka marrë vlerësime të larta e të merituara nga Presidenca e Republikës së Shqipërisë: Medaljen "Naim Frashëri" dhe Dekoratën e Lartë "Nënë Tereza"; Medaljen "Lidhja e Prizrenit" nga Presidenti i Kosovës asokohe Dr. Ibrahim Rugova; "Medalja Presidenciale" nga Presidentja e Republikës së Kosovës, Prof. Vjosa Osmani. Më 15 maj 1995 Akademia e Shkencave e Shqipërisë e ka vlerësuar me titullin e nderit "Doctor honoris causa" për veprën *Kërkime dhe Studime ndër Arbërorët e Elladhës (Ricerche e Studi tra gli Arberori dell'Ellade)*[7] me motivacionin: "Për ndihmesën e veçantë që ka sjellë me mbledhjen, sistemimin dhe botimin e etnologjisë dhe folklorit të arbëreshëve të Italisë dhe arbërorëve të Greqisë".

2. Kanë kaluar plot katër vjet që kur Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA), botoi veprën "Rrugëtim në ngulimet arbëreshe", *(50 kartolina gjigante arbërore në tokën italiane),* e hartuar nga Papas Antonio Belushi në bashkëautorësi me znj. Ornela Radovicka. Me 452 faqe, të ndara në dhjetë kapituj, kjo vepër mbulon të gjithë tematikën që lidhet me historinë, jetën dhe të ardhmen e komunitetit arbëresh të Italisë, duke qenë një pasqyrë e përgjithshme për të njohur tërësinë, por njëkohësisht për t'u thelluar në interesa të veçanta, si: prejardhja e emrit, historia e ngulimeve të para, ndarja midis legjendave dhe fakteve, mozaiku i dialekteve, veçorive etnografike, personaliteteve historike e kulturore, vendbanimeve, por edhe problematikave aktuale të mbijetesës e ruajtjes së identitetit etnik e kulturor.

Ngulimet arbëreshe të shkëputura prej shekujsh nga trungu mëmë, të vendosura dhe të shtrira në disa rajone të Italisë, janë histori dhe realitet i prekshëm. Atë Belushi, si një personalitet i vërtetë i komunitetit të vet, me këtë studim në të shkuarën, duke u ndalur në mundimet dramatike e plot kthesa, por dhe në arritjet më të ndritura deri më sot, synon vazhdimësinë: që në këto ngulime edhe më tej duhet të jetohet arbërisht, të flitet arbërisht, të mendohet arbërisht.

Duke u ndalur te secili ngulim të dy autorët veçojnë karakteristikat e mjedisit, tipare të klimës, të bimëve, të drurëve monumente të natyrës, të malit, të pjellshmërisë së tokave, të rrjedhave të lumenjve, të krojeve – të poetizuar nga folklori e poetët - kroje dikur me ujin aq të nevojshëm për jetën e përditshme. Kjo i ka dhënë librit ngjyrë e njomësi, për kundër një përshkrimi të thatë e të rrafshët.

Si klerik Atë Belushi qëndron te kishat, te roli i tyre, te historia e ndërtimit, te arkitektura, te dekorimi, e për faktin se kisha e ritit bizantin ka rolin e saj të madh në mbrojtje të identitetit arbëresh, ndërsa ngulimet që e humbën këtë rit të origjinës dhe morën atë latin, me kohë e kanë humbur gjuhën e të parëve. Vëmendjen e tij, si vizatues i apasionuar dhe krenar i vetëdijes arbëreshe, e tërheqin gojëdhana, legjenda deri anekdota që lidhen me tipare të veçanta kulturore të ngulimeve. Kostumi i gruas arbëreshe, endja e pëlhurave, e qilimave, ndryshimi në ngjyra dhe në prerje nga një krahinë në tjetrën trajtohen me hollësi. E plotësojnë përshkrimin dhe të dhënat mbi ritet e dasmës, të vdekjes, të lindjes së fëmijëve, festat, vallet, gatimet. Shtëpia dhe "gjitonia", lagjia janë në qendër të vëzhgimeve për çdo ngulim, se janë tipare aq dalluese arbëreshe në krahasim me fshatrat e vendasve italianë.

Libri është pasuruar edhe me aspekte të jetës shoqërore. Arbëreshi e filloi me shtëpitë e bëra me baltë e kashtë dhe krijoi qyteza që jetojnë edhe sot. Arbëreshët ndërtuan kolegje që prodhuan mësimdhënës në nivel dijetari, klerikë të lartë, peshkopë. Studimet në shkollat më të mira italiane nxorrën ushtarakë, poetë, mendimtarë, politikanë e revolucionarë. Garibaldinët arbëreshë u bënë dhe ministra.

Një tjetër aspekt në libër është mënyra se si u arrit krijimi i identitetit arbëresh nga zbrazëtia, pa një ndihmë nga shteti amë që atëherë nuk egzistonte. Dihet që për shkak të ritit në fillim ata i quanin grekë. Dijetarët arbëreshë, ndryshe nga Arvanitasit në Greqi që e humbën vetëdijen e origjinës, e pajisën me mendim qenien e tyre ndryshe nga Grekët dhe Italianët. Në fillim u mbështetën te gjuha, gjaku, besimi i ritit ortodoks, te historia, mitet, këngët e baladat mbi Skënderbeun. Kjo lëvizje e një vetëdijeje si Arbëreshë çoi dhe te kërkimi i origjinës pellazgjike, te Moti i Madh, te Skënderbeu, te shkrimi i gjuhës arbëreshe, mbledhja e botimi i folklorit, te trajtesat shkencore dhe në të tjera ide që u morën dhe nga Rilindja Shqiptare.

Një galeri e tërë personalitetesh arbëreshe hasen në libër pas të dhënave mbi historinë e çdo vendbanimi. Edhe pse një punë e mundimshme, autori ia ka dalë që të vizatojë në mënyrë sintetizuese shumë portrete ushtarakësh, klerikësh, poetësh, publicistësh dhe mendimtarësh arbëreshë, ku ndër të cilët disa përshkruhen me një material të ri dhe vizatime nga këndvështrime të panjohura në literaturën tonë, e madje me rëndësi për gjithë historinë dhe kulturën shqiptare. Libri është i mbështetur mbi një material të pasur bibliografik, rezultat i një pune të gjatë kërkimore dhe hulumtuese.

Ky libër përbën një thesar të trashëgimisë arbëreshe dhe, siç përmend prof. Sadik Bejko në recensionin dërguar në QSPA para botimit, "...libri ka vlerën e një monografie mbi atë që mund ta quajmë Botë Arbëreshe e më tepër se një histori, është një hetim i imët mbi ato dukuri që e bëjnë të veçantë atë që mund ta quajmë qytetërim arbëresh.....dhe përmbledh shumë lëndë mbi trashëgiminë arbëreshe, me vlera të mëdha njohëse, ...libër që herë-herë bëhet tërheqës dhe për stilin e rrjedhshëm e plot ngjyrim"[8].

Libri "Rrugëtim në ngulimet arbëreshe" *(50 kartolina gjigante arbërore në tokën italiane)* shërben si një enciklopedi e mirëfilltë e Botës Arbëreshe, duke qenë në të njëjtën kohë një studim i thelluar, një vademekum i dukurive të asaj bote, sa edhe një guidë për të gjithë ata që duan të vizitojnë virtualisht, apo fizikisht katundet arbëreshe. Në të jepen metodologji dhe mënyra të ndryshme të trajtimit të çështjeve të veçanta.

Ky libër, më shumë se një monografi, është testament i një Arbëreshi që ia ka kushtuar gjithë jetën ruajtjes së thesarit që e depoziton përmes fjalës. Janë shprehje e këtij testamenti frazat e *Parathënies* së shkruar prej tij: "Të jesh ndryshe, por i integruar, është një vlerë, një element i pasurisë dhe i rritjes morale para të qenurit civil[9]... Arbëreshi nënkupton një vazhdimësi dhe po jeton[10]...".

Në përfundim: Atë Antoni Belushi do të mbetet i gdhendur në kujtesën tonë si një personalitet dhe një veprimtar i shquar e i palodhur i jetës dhe lëvizjes kulturore shqiptare në shkallë kombëtare, një shembull i madh frymëzimi se si përpjekjet individuale, plot idealizëm, përkushtim dhe patriotizëm, i shërbejnë kombit dhe kulturës, jo vetëm arbëreshe, por edhe shqiptare, italiane dhe europiane.

Dëshëroj të falënderoj Shtëpinë Botuese "Onufri", që përgatiti këtë botim cilësor, si bartëse e një emri që do ta tumirnin e do t'i gëzoheshin simotra dhe sivëllezërit Dora, Dhimitri, Eftimi - "heronj" të monografisë "**Dhimitër Kamarda– Për një shqipe "të gjithakushme edhe të gjithakundme"&të tjera vepërza",** të studiuesit skrupuloz, prof. Dhori Q. Qirjazi, botuar po nga QSPA, ShB "Onufri", Tiranë 2021.

4 Shih *Hyrje* nga A. Kola, f. 7, në: A. Bellusci, *Kërkime dhe Studime ndër Arbërorët e Elladhës (Ricerche e Studi tra gli Arberori dell'Ellade),* - Tekste dhe Dokumente në të folmet arbërore-arvanite me përkthimin në gjuhën italiane-Hyrje nga/introduzione di Gjovalin Shkurtaj (Tirana) e Aristidhis Kolljas (Atene). Shtëpi botuese/ Casa editrice "Shoqata kulturore Gjergj Kastrioti", Frascineto 1994, pp. 500.

5 Në QSPA më 13 qershor 2021, ka mbërritur koleksioni i revistës arbëreshe "LIDHJA/L'UNIONE" e themeluar në vitin 1980 nga Antonio Bellusci (me nënshkrimin e Tij). Vëll. I përmban Lidhja 1, 1980 – n.20, 1988; Vëll. II përmban Lidhja n. 21, 1989 – n. 36, 1996; Vëll. III përmban Lidhja nr. 36, 1998 – nr. 54, 2005; Vëll. IV përmbanë Lidhja nr. 56, 2066 – nr. 60, 2009.

6 Shih më gjerë A. Bellusci, *Kultura tradicionale te Arbërorët e Greqisë (Epika dhe lirika popullore)*, në: GJENDJA AKTUALE E STUDIMEVE PËR ARBËRESHËT", Aktet e Kuvendit të Parë të Studimeve Arbëreshe. QSPA, Tiranë 2022, f. 44-57.

7 A. Bellusci, *Kërkime dhe Studime ndër Arbërorët e Elladhës (Ricerche e Studi tra gli Arberori dell'Ellade).* "Shoqata kulturore Gjergj Kastrioti", Frascineto 1994.





8 Kopja origjinale e këtij recensioni ndodhet në arkivin e QSPA-së.

9 Po aty, f. 17.

10 Po aty, f. 19.

Botim i ri nga BotArt

Yuval Noah Harari

NEXUS: Një histori e shkurtër e rrjeteve të informacionit nga Epoka e Gurit tek Inteligjenca Artificiale

Prolog

E kemi emërtuar llojin tonë *Homo sapiens* – njeriu i zgjuar, e megjithatë mbetet e dyshimtë se sa e meritojmë këtë emërtim.

Përgjatë 100 000 viteve të fundit, ne Sapiensët sigurisht që kemi grumbulluar pushtet të pamasë. Vetëm të listonim zbulimet, shpikjet dhe pushtimet do të mbusheshin vëllime të tëra. Mirëpo pushteti nuk është dije dhe, pas 100 000 viteve zbulime, shpikje dhe pushtime, njerëzimi e ka shpënë veten drejt një krize ekzistenciale. Jemi në prag të kolapsit ekologjik të shkaktuar nga keqpërdorimi i pushtetit tonë. Gjithashtu po krijojmë teknologji të reja, si Inteligjenca Artificiale (IA) e cila ka potencialin të dalë jashtë kontrollit tonë dhe të na skllavërojë ose të na shfarosë. E megjithatë, në vend që lloji ynë të bashkohej për t'u përballur me këto sfida ekzistenciale, tensionet ndërkombëtare po rriten, bashkëpunimi global po bëhet më i vështirë, shtetet po pajisen me rezerva armatimesh të shkatërrimit në masë, dhe një luftë e re nuk duket më e pamundur.

Nëse ne Sapiensët jemi kaq të zgjuar, pse jemi kaq vetëshkatërrues?

Në nivel pak më të thellë, megjithëse kemi grumbulluar kaq shumë informacion për gjithçka, që nga molekulat e ADN-së deri te galaktikat më të largëta, nuk duket sikur i gjithë ky informacion të na ketë dhënë ndonjë përgjigje për pyetjet më të mëdha të jetës: *Kush jemi ne? Për çfarë duhet të aspirojmë? Çfarë është një jetë e mirë dhe si duhet ta jetojmë atë?* Pavarësisht sasisë mbresëlënëse të informacionit që kemi në dispozicion, jemi po aq prekshëm sa edhe paraardhësit tanë ndaj fantazisë dhe deluzionit. Nazizmi dhe stalinizmi nuk janë gjë tjetër veçse dy nga shembujt më të fundit të çmendurisë masive, që herë pas here gllabëron madje edhe shoqëritë moderne.

Askush nuk e kundërshton faktin se njerëzit sot kanë shumë më tepër informacion dhe pushtet nga sa kishin në Epokën e Gurit, por nuk është aspak e sigurt që ne e kuptojmë veten dhe rolin tonë në univers më mirë se atëherë.

Pse jemi kaq të zotë për të grumbulluar më shumë informacion dhe pushtet, por shumë më pak të zotët për të fituar dije? Përgjatë historisë shumë tradita kanë besuar se disa të meta fatale në natyrën tonë na tundojnë të ndjekim pushtete që nuk jemi në gjendje t'i përballojmë. Miti grek i Fetontit tregon për një djalë i cili zbulon se është i biri i Heliosit, perëndisë së Diellit. Duke dashur të vërtetojë origjinën e tij hyjnore, Fetonti kërkon privilegjin të ngasë qerren e Diellit. Heliosi e paralajmëron Fetontin se askush nuk mund t'i kontrollojë kuajt qiellorë që tërheqin qerren e Diellit, por Fetonti këmbëngul, derisa perëndia e Diellit zbutet. Pasi ngrihet krenar drejt qiellit, Fetonti humbet kontrollin e qerres. Dielli humbet drejtimin duke përvëluar gjithë bimësinë e duke vrarë shumë qenie, madje duke kërcënuar të djegë të gjithë Tokën. Zeusi ndërhyn dhe e godet Fetontin me një rrufe. Njeriu mendjemadh bie nga qielli si një yll që këputet, duke u djegur në flakë. Perënditë rimarrin kontrollin e qiellit dhe shpëtojnë botën.

Dy mijë vite më pas, kur Revolucioni Industrial po hidhte hapat e tij të parë dhe makineritë nisën të zëvendësojnë njerëzit në punë të ndryshme, Gëte (Johann Wolfgang von Goethe) publikoi një rrëfim të ngjashëm paralajmërues të titulluar: "Nxënësi i magjistarit" *(The Sorcerer's Apprentice)*. Poema e Gëtes (më pas e popullarizuar si film i animuar nga *Walt Disney* me pjesëmarrjen e Mickey Mouse-it) tregon se si një magjistar i vjetër ia lë në dorë drejtimin e punishtes së tij një nxënësi të ri dhe i dha atij disa detyra për t'i kryer gjatë kohës që nuk do të ndodhej atypari; njëra prej tyre qe të mbushte ujë në lumë. Nxënësi vendosi t'ia lehtësojë punën vetes dhe, duke përdorur një nga magjitë e magjistarit, magjepsi një fshesë që të mbushte ujë në vend të tij. Por nxënësi nuk dinte se si ta ndalte fshesën, e cila po mbushte ujë pareshtur duke rrezikuar përmbytjen e punishtes. I kapluar në panik, nxënësi e theu fshesën më dysh me një sëpatë, mirëpo të dyja pjesët e saj u kthyen në dy fshesa të reja. Tashmë dy fshesa të magjepsura po e përmbytnin punishten me ujë. Kur u kthye magjistari i vjetër, nxënësi iu lut për ndihmë: "Shpirtrat që thirra për ndihmë nuk i ndal dot më." Magjistari e prishi menjëherë magjinë dhe përmbytja u ndal. Mësimi për nxënësin dhe njerëzimin është i qartë: "Kurrë mos ushtro pushtet, të cilin nuk mund ta kontrollosh!".

Në shekullin e njëzetenjëtë, çfarë domethënie kanë për ne fabulat paralajmëruese të nxënësit dhe të Fetontit? Qartësisht ne, njerëzit, kemi refuzuar t'ua vëmë veshin paralajmërimeve të tyre. Tashmë klimës së Tokës i kemi prishur ekuilibrin dhe kemi mbledhur miliarda fshesa magjike, dronë, *chatbot*-e*[1] dhe shpirtra të tjerë algoritmikë, që mund të dalin jashtë kontrollit tonë dhe të shkaktojnë përmbytje me pasoja të padëshiruara.

Ç'duhet të bëjmë atëherë? Fabulat nuk na japin ndonjë përgjigje, përveçse të presim për ndonjë perëndi apo magjistar të na shpëtojë. Sigurisht, ky është një mesazh jashtëzakonisht i rrezikshëm. Ai i inkurajon njerëzit të heqin dorë nga përgjegjësitë dhe t'i lënë shpresat e tyre në dorë të perëndive dhe të magjistarëve. Madje edhe më keq, ky mesazh nuk merr parasysh se perënditë dhe magjistarët janë, në vetvete, shpikje njerëzore – ashtu si qerret, fshesat dhe algoritmet. Prirja për të krijuar gjëra të fuqishme me pasoja të padëshiruara nuk ka nisur me shpikjen e motorit me avull apo të IA-së, por me shpikjen e fesë. Profetë dhe teologë kanë thirrur për ndihmë shpirtra të pushtetshëm që supozohej të sillnin dashuri dhe gëzim, por në disa raste përfunduan duke përmbytur botën në gjak.

Miti i Fetontit dhe poema e Gëtes nuk na japin këshilla të dobishme, sepse ato keqinterpretojnë mënyrën se si njerëzit e fitojnë pushtetin. Në të dyja fabulat, një njeri i vetëm fiton pushtet të pakufishëm, por më pas ai korruptohet nga mendjemadhësia dhe lakmia. Përfundimi është, se të metat në psikologjinë tonë individuale na shtyjnë drejt abuzimit me pushtetin. Ajo që i mungon kësaj analize të papërpunuar, është se pushteti njerëzor nuk mund të jetë kurrë pasojë e iniciativës individuale. Pushteti gjithnjë buron prej bashkëpunimit të njerëzve të shumtë në numër.

Po ashtu, nuk është psikologjia jonë individuale ajo që shkakton abuzimin tonë me pushtetin. Tekefundit, së bashku me lakminë, mendjemadhësinë dhe mizorinë, njerëzit janë gjithashtu në gjendje të ndiejnë dashuri, dhembshuri, përulësi dhe gëzim. Dhe vërtet, mes anëtarëve më të këqij të llojit tonë, lakmia dhe mizoria mbizotërojnë me lavdi dhe udhëheqin aktorët negativë drejt abuzimit me pushtetin. Po pse do të zgjidhnin shoqëritë njerëzore ta besonin pushtetin e tyre në duart e më të këqijve? Për shembull, shumica e gjermanëve në vitin 1933 nuk ishin psikopatë. Atëherë, pse votuan Hitlerin?

Prirja jonë për të mbledhur pushtet të cilin nuk mund ta kontrollojmë nuk buron nga psikologjia individuale, por nga mënyra unike se si bashkëpunon lloji ynë, kur jemi të shumtë në numër.

Argumenti kryesor i këtij libri është se njerëzimi fiton pushtet të pamasë duke ndërtuar rrjete të gjera bashkëpunimi, por mënyra se si ndërtohen këto rrjete, i bën ata ta përdorin pushtetin në mënyrë jo aq të zgjuar. Atëherë problemi ynë është problem i rrjetit. Në mënyrë më specifike, është problem informacioni.

Informacioni është zamka që i mban rrjetet bashkë. Për dhjetëra mijë vjet Sapiensët ndërtuan dhe mirëmbajtën rrjete të gjera duke shpikur dhe shpërndarë sajesa, fantazi dhe deluzione në masë – rreth perëndive, fshesave të magjepsura, rreth IA-së dhe shumë gjërave të tjera madhështore. Ndërkohë që secili individ human është zakonisht i interesuar në njohjen e së vërtetës rreth vetes dhe botës, rrjetet e gjera i bashkojnë anëtarët dhe krijojnë rend duke u bazuar te sajesat dhe fantazitë. Kështu, për shembull, arritëm te nazizmi dhe stalinizmi. Këto ishin rrjete veçanërisht të fuqishme, që mbaheshin në këmbë nga ide veçanërisht deluzionale. Ashtu siç thotë një shprehje e njohur e George Orwell-it: "Injoranca është forcë."

Fakti se regjimi nazist dhe ai stalinist u themeluan mbi fantazi mizore dhe gënjeshtra të paturpshme, *nuk* i bën ata më të veçantë në histori, po ashtu nuk paracakton rrënimin e tyre. *Nazizmi* dhe *stalinizmi* ishin dy nga rrjetet më të forta që ka krijuar njerëzimi. Në fund të vitit 1941 dhe në fillim të vitit 1942, fuqitë e Boshtit iu afruan fitores në Luftën e Dytë Botërore. Stalini doli si fitimtar nga ajo luftë[1] dhe gjatë viteve 1950 dhe 1960 ai dhe trashëgimtarët e tij patën mundësi të barabarta të fitonin Luftën e Ftohtë. Deri në vitet 1990 demokracitë liberale fituan avantazh, por tashmë kjo duket si një fitore e përkohshme. Në shekullin e njëzetenjëtë disa regjime të reja totalitare mund të kenë fare mirë sukses – aty ku Hitleri dhe Stalini dështuan – në krijimin e një rrjeti të plotfuqishëm që mund të parandalojë brezat e ardhshëm të përpiqen të ekspozojnë gënjeshtrat dhe sajesat e tij. Nuk duhet të supozojmë se rrjetet deluzionale janë të destinuara të dështojnë. Nëse duam të parandalojmë triumfin e tyre, na duhet ta bëjmë vetë punën më të lodhshme.

Përktheu Aulona Ormeni

1 Programe kompjuterike të krijuara për të komunikuar me qeniet njerëzore, kryesisht përmes internetit. (Të gjitha shënimet janë të përkthyeses.)



Tani së fundmi, autorja e njohur gjermane Jenny Eprenback fitoi çmimin "Booker International" me romanin e saj "Kairos". Në këtë bisedë zbërthehet sfondi i romanit dhe raporti i autores me jetën në Gjermaninë Lindore si dhe, ndikimet e këtij raporti në gjendjen e sotshme shoqërore dhe kulturore të Gjermanisë e po ashtu, në vetë jetën e shkrimtares.

JENNY ERPENBECK flet për romanin e saj "Kairos", për Marksin, shpresat e thyera dhe se si u rrit në Gjermaninë Lindore

The Berliner

Tek na tregon shtëpinë e saj në Berlin, Jenny Erpenbeck shpjegon se në raftin e saj, librat nuk janë të organizuar alfabetikisht, por sipas datëlindjes së autorit. "Ka tre nënndarje, gjermane, ruse dhe angleze, pastaj disa të tjerë si periudha e antikitetit. Librat e artit janë poshtë."

Brenda çdo nënndarjeje, ka një raft të veçantë për librat e miqve e saj, si dhe një zonë (prapa abazhurit) për librat që ajo shpreson të ketë kohë një ditë t'i lexojë. E pyetur për shkrimtarët e saj të preferuar në gjuhën angleze, ajo përmendi vepra që mund të jenë pak të njohura, madje edhe për lexuesit e anglishtes: *Spoon River Anthology* nga Edgar Lee Masters "Është si bibla ime" dhe *The Bridge of San Luis Rey* nga Thornton Wilder.

Romani juaj i ri *Kairos* është vendosur në Gjermaninë Lindore. Ju jeni rritur në Lindje. Si ishte të rikrijoje atë qytet për librin e ri?

Kishte shumë gjëra që i mbaja mend mirë, por për të tjerat, më duhej të pyesja miqtë e mi. Për shembull, mund të mbaja mend se ku ishin të gjitha kafenetë, por nuk kujtoja dot emrat ose cili ishte cili. Ishte e çuditshme, por vetëm në atë masë sa është përherë për mua kur ec nëpër Berlin. Gjithmonë do të jenë dy shtresa të qytetit. Unë vetë shoh atë çfarë ishte dikur dhe çfarë është tani.

Në esenë tuaj *Homesick for Sadness* theksoni se për ju, Berlini nuk ishte i ndarë në dysh. Ju nuk e kishit njohur kurrë qytetin si diçka tjetër përveç asaj çfarë ishte. A kishte ndonjë ndjesi, atëherë, se po jetonit në një situatë të çuditshme?

Si fëmijë, gjërat i merr ashtu si të jepen. Ka vende që nuk do t'i shohësh, ose që do t'i shohësh më vonë. Kur u rrita pak, ndërsa isha në Berlinin Lindor, dëgjova zhurmën e një kantieri ndërtimi në Berlinin Perëndimor. Kjo ishte e çuditshme sepse ishte aq afër. Ishte si të ndanim zhurmën, por jo të tashmen. Por ne ishim mësuar të dëgjonim metronë [e Berlinit Perëndimor] që kalonte poshtë. Ndoshta ishim mësuar me të çuditshmen, e cila është një bazë e mirë për t'u bërë shkrimtar.

Një ese tjetër *At the Ends of the Earth* përshkruan lojërat mes rrënojave të *Museumsinsel* si fëmijë. Duket se në këto vende të braktisura, kishte një ndjenjë lirie.

Kishte shumë vende të papërcaktuara, gjë që ishte e bukur. Ato janë vende ku mund të rritet diçka. Po të ishte gjithçka e vendosur dhe përfunduar, nuk mbetet më asgjë për të bërë, as për fantazinë dhe as për lojën. Këto ishin vende që mund të përdoreshin në mënyra të paparashikuara.

Bashkë me ribashkimin, a pati një ndjesi të menjëhershme se koha e eksperimentimit kishte përfunduar?

Mund ta shihje në çdo aspekt. Thjesht duhej të mësonim se si ishte organizuar Republika Federale, të kuptonim se si të siguronim jetesën, si të mbanim një punë, si të paguanim qiranë, e cila papritmas filloi të rritej. Ishte shumë e qartë se duhej të përshtateshim me një sistem që nuk e kishim shpikur ne. Për tetë javët e para pas rënies së murit, ndjemë se kishim fuqinë, por pastaj kur pamë drejtimin në të cilin po shkonin gjërat, e kuptuam se ne do të ishim sërish të paditurit.

Në nëntor ishte si "po bëjmë një revolucion". Deri në shkurt, u bë e qartë se gjithë shteti do të shembej dhe së shpejti nuk do të ekzistonte më.

Dhe me zgjedhjet: banorët vendas të lindjes as nuk ia kishin idenë çfarë do të thoshte "zgjedhje". Zgjedhjet e para të lira supozohej të ishin në qershor, pastaj e caktuan datën më herët, në mars, në mënyrë që partitë e sapokrijuara të mos kishin mundësi të arrinin te ndonjë njeri. Ata nuk kishin as pajisje bazë si fotokopje ose postera. Para se ne të mund të mendonim për këtë, CDU-ja mori pushtetin. Ata e dinin si bëhej: çfarë do të thotë një zgjedhje, cilat janë pasojat. Kështu që nuk ishte shumë surprizë kur njerëzit menduan, dakord, tani për t'u bërë më shpejt perëndimorë, do të zgjedhim CDU .

Ju shkruat për mënyrën se si bashkimi me Perëndimin bëri që njerëzit në Lindje ta shihnin veten me sy të rinj. Papritmas vërejtët se aktoret e Gjermanisë Lindore shpesh kishin dhëmbë të shtrembër. Askush nuk kishte menduar për këtë më parë.

Një detaj tjetër që vumë re në vitet pas ribashkimit: nëse ndonjë aktore nga Gjermania Lindore ishte në një *talk show*, ajo fliste me një theks të Berlinit. Ato ishin në gjendje të flisnin Hochdeutsch, por në jetën e përditshme, si normalë privatë të ftuar në një emision, të gjitha flisnin me një theks të zakonshëm të Berlinit.

Edhe im atë. Ai është filozof, është shumë i arsimuar. Nuk ishte çështje arsimimi; ishte një zgjedhje e bazuar në respektin për klasën punëtore. Si për të thënë: "ne jemi të barabartë". Kjo nuk ishte urdhëruar nga lart. Ishte si të thuash "moderne" të ishe normal.

A mendoni se jeni më e suksesshme ndërkombëtarisht, veçanërisht në botën anglishtfolëse, sesa në Gjermani?

Ndjenja ime është se nga bota anglishtfolëse ka një interes të vërtetë dhe serioz për të kuptuar. Si ishte ribashkimi? Pyetjet nuk janë të shtruara formalisht, por janë pyetje të vërteta. Nuk mund ta besoja sa shumë interes kishte për esenë [Not a Novel, 2020]. Shtëpia ime botuese më tha se i dërguan esenë 80 gazetarëve në Gjermani dhe pati vetëm një shkrim për të. Një. Dhe ai ishte shkruar nga një gazetare që e njoh. Një mikja ime.

Ndoshta, gjermanët nuk pëlqejnë të lexojnë ese. Në rregull. Por ndoshta ata janë po ashtu pak të lodhur nga dëgjimi i tregimeve të Gjermanisë Lindore.

E shoh edhe brenda vetes. Është shumë më e lehtë për mua të ftoj një gazetar të huaj në shtëpinë time sesa një gazetar gjerman. Largësia është më e madhe dhe kjo e bën më të lehtë të jesh intim.

Ndonjëherë termi *Ostalgie* përdoret në një mënyrë që duket se synon të zvogëlojë subjektin. A mendoni se këtu në Gjermani, disa njerëz nuk duan të përfshihen? Se ata mbajnë brenda vetes diçka që nuk duan ta shohin?

Gjërat interesante në lidhje me këtë lloj melankolie ose zhgënjimi janë se ka anë të ndryshme. Si njerëz të lindjes, ne jemi njerëz që përjetuam një kolaps të një sistemi themelor. Kjo nënkuptonte frikën nga humbja e një pune, paaftësia për të paguar qiranë, detyrimi për të lënë shtëpinë. Për shumë njerëz, ishin shumë gjëra të reja, shumë të papritura. Ata nuk e kishin pritur këtë; ata kishin pritur të ishin në gjendje të shkonin në Majorka. Dhe ata ishin në gjendje ta bënin këtë, por kjo ama ishte vetëm gjysma e së vërtetës.

Kolapsi i një sistemi është një përvojë interesante sepse të jep një mosbesim të thellë në strukturat e çdo sistemi. Të shohësh se për pesë minuta gjithçka mund të ndalet, është një përvojë themelore që shtrihet shumë përtej humbjes së socializmit. Në këtë kuptim, madje të mungojnë gjërat e këqija. Ju keni humbur "softuerin" se si të përballeni me gjërat, çfarë të bëni dhe çfarë është më mirë të lini pas dore. Edhe në Perëndim keni këto "njolla të verbra": jeni i lirë, por nuk do ta përdorni vërtet lirinë tuaj në çdo moment. Mund të thuash çfarë të duash, por ka gjasa të mos jesh i sinqertë.

Ti i njeh rregullat e sistemit në të cilin je rritur; Brenda një çasti, gjithë njohuritë tona të mbledhura, nuk kishin më asnjë vlerë.

Njerëzit që donin të ndërtonin një socializëm më të mirë hapën derën, por ajo që hyri ishte diçka krejtësisht ndryshe. Momenti ynë i tanishëm u bë histori, ashtu si dhe të ardhmet e mundshme që kishim imagjinuar.

Ju shkruani për statusin e së ardhmes nën të dy sistemet. Sot, ideja mbizotëruese duket të jetë se ne po jetojmë në të ardhmen – sistemi më i mirë i mundshëm – ndërsa e ardhmja e vërtetë kërcënon me katastrofë, prishje të sistemit, kolaps mjedisor. A e ndjetë menjëherë këtë ndryshim në statusin e së ardhmes?

Mendoj se ishte e qartë kur kishte kaq shumë lumturi për ribashkimin. Dukej si fundi i historisë. Nuk kishte nevojë për një fund tjetër.

Shumë miq të mi në Perëndim më thanë se barazpesha midis lindjes dhe perëndimit ishte gjithashtu e mirë për perëndimin. Nga momenti kur lindja u zhduk, nuk kishte më nevojë për të përmirësuar kushtet, ishte si të thoshin: "Në rregull, tani jemi vetëm dhe mund të bëjmë çfarë të duam".

Një gjë tjetër që u braktis ishte lidhja me një ide të përparimit. Në vitet '20 të shekullit të kaluar, poetë dhe piktorë si Pikaso ishin të majtë. Ishte një lëvizje e madhe që mendonte: "ne po krijojmë një botë të re". Në Lindje, ne e ruajtëm këtë vizion. Nuk po flas për realitetin, por për vizionin e një shoqërie të bazuar në solidaritet, të drejta të barabarta për të gjithë, pavarësisht gjinisë apo vendit.

Kur i quan të gjitha këto *Ostalgie*, bëhet e qartë se i përçmoni të gjithën. Dhe kjo është e vështirë për t'u përballuar.

Në Formin Marx-Engels midis Schloss dhe Alexanderplatz, ka një citim nga Engels që thotë: "gjithçka varet nga klasa punëtore që vepron si një klasë". A mendoni se kjo është e mundur sot?

Të veprosh si një klasë po bëhet gjithnjë e më e vështirë. Me kompjuterët, të gjithë mund të punojnë vetëm. Do të ishte interesante të dihej kush është klasa punëtore sot, sepse puna jonë po ndryshon kaq shumë. Marksi tha se idetë krijojnë ndryshime të vërteta kur arrijnë të përfshijnë masat. Një mikesha ime mori pjesë në disa aktivitete me lëvizjen *Occupy* dhe më tha se kishte dalë gjithë ajo ushtri për ta ndaluar atë lëvizje. Sa më të mira të bëhen armët, aq më të larta bëhen gardhet, aq më e vështirë bëhet të bësh një revolucion.

A dëshironi një revolucion?

Dua të kem një ndryshim paqësor, sigurisht. Por, mendoj se taktikisht është e mundur t'u përgjigjemi pyetjeve të mëdha duke marrë veprime private. Para se të shkruaja *Go Went Gone*, kishte një diskutim mes meje dhe babait tim rreth ndihmesës për refugjatët. Thashë se e di që nuk është aspak e mjaftueshme për të ndihmuar pesë ose dhjetë persona, por prapë, kam dëgjuar kaq shumë histori për hebrenjtë që mbijetuan vetëm sepse dikush qe i gatshëm t'i ndihmonte. Mund ta thuash pa e prishur terezinë se "bota ka nevojë për një ndryshim", dhe kështu, të mos bësh përpjekje për të ndihmuar një, dy, apo tre njerëz. Por prap: bota ka nevojë për një ndryshim, si politik ashtu edhe ligjor.

Çfarë mendoni për Marksin si shkrimtar?

Është i shkëlqyer. Për shembull, *Die Verhältnisse zum tanzen bringen*, për të bërë që marrëdhëniet e ngurta të vallëzojnë duke iu përgjigjur atyre me me po atë tingullin e tyre. Më pëlqen kjo. Të ndryshosh sistemin duke e bërë atë të vallëzojë. Dhe pastaj, sigurisht, është rreshti i famshëm: *Ein Gespenst geht um in Europa*. Një fantazmë po endet në Evropë. Nuk mund ta thuash më mirë. Dhe është ende kështu: forcat e antikomunizmit janë të forta. Mendoj se dikush si Allende në Kili do të kishte qenë një nga të paktët që do ta kishte bërë një sistem socialist të funksiononte.

A do ta quanit veten marksiste?

Ndoshta, po. Nuk di mjaftueshëm për ta quajtur veten marksiste. Kam kujtesë të dobët. Nuk është se lexoj gjithmonë *Kapitalin*. Nuk i mbaj mend të gjitha aspektet e veprës së Marksit. Por ajo që më pëlqen është që Marksi e kuptoi se si punëtori përdoret si material. Ai nuk është më njeri. Kjo është një ide e fortë. Pse disa njerëz përdoren thjesht si material për të tjerët, të cilët mund të rrinë në shtëpi dhe të marrin fitimin?

Te vëllimi me ese, ka një tekst që kam shkruar për një çantë të varur nga disa punëtorë në një pemë. Ajo mban brenda mëngjesin. Ata punojnë në një park dhe, kur të vijë koha e pushimit, do ta hanë. Pra, mëngjesi është e ardhmja, tashmë e varur në pemë. Ata po punojnë, por e ardhmja është tashmë atje. Mendoj se e ardhmja jonë po rritet diku. Ndoshta jo në vendet tona, ndoshta diku tjetër, nuk e dimë ende, por nuk mund ta mbash të ardhmen jashtë.

E përkthyer mjeshtërisht nga Alqi Kristo, botohet për herë të parë në shqip poema e Shekspirit

Feniksi dhe turtullesha

Nga Prof. Dr. Diana Kristo

Teksti i kësaj poezie të shkurtër e misterioze u duk për herë të parë në Angli më 1601, në një vëllim antologjie të titulluar Martiri i Dashurisë (Love's Martyr). Vëllimi hapet me një poezi të Robert Çesterit, pasuar nga poezi të Ben Xhonsonit dhe Xhorxh Çapmanit, të gjitha me temën e "feniksit dhe turtulleshës". Mendohet se kjo përmbledhje poezish është një vajtim për shuarjen e monarkisë së Tudorëve dhe glorifikim i vazhdimësisë së jakobinëve.

Poezia konsiderohet si një nga veprat më të errëta dhe alegorike të Shekspirit. Ajo ka temën e dashurisë, bashkimit dhe vdekjes përmes simbolizmit të feniksit dhe turtulleshës. Nënteksti alegorik i Shekspirit i ka vënë në mendime studiuesit. A simbolizon Elizabetën Feniksi, ky zog i praruar i mitologjisë që vetë konsumohet nga zjarri çdo 500 vjet dhe rilind nga hiri? Apo simboli i përket Xheimsit I të Skocisë? A i përket turtullesha Kontit të Eseksit që u ekzekutua në atë kohë (vihet re një fluiditet gjinor)? Shumë nga këto interpretime janë konjukturale dhe të parëndësishme për lexuesin e ditëve të sotme. Sipas Shekspirit dhe traditës së gjatë, Turtullesha përfaqëson besnikërinë, të Vërtetën që është konstante, e cila rrallë herë bashkohet me Bukurinë. Turtullesha është besnike dhe delikate, krejtësisht e mahnitur nga bukuria e feniksit rrethuar nga flakët. Dashuria e përsosur është unitet dhe dualitet, një jetë e hareshme brenda një vdekjeje përvëluese. Në këtë poemë ata bashkohen dhe vdesin. Feniksi nuk rilind. Zogjtë nuk lënë pas trashëgimtarë dhe digjen e bëhen hi nga e njëjta flakë.

Gjuha e poemës është e ngjeshur dhe lexuesi i sotëm mund t'i perceptojë si të errëta referimet. Simbolizmi i zogjve në kohën e Shekspirit na vjen i zbehtë deri në ditët tona. Por kjo kapërcehet me lehtësi kur kapet kuptimi sipërfaqësor dhe simbolika me zogjtë. Poema është një fabul metafizike për një dashuri të qashtër e të zjarrtë.

"Feniksi dhe Turtullesha" ka një muzikalitet të brendshëm, të shprehur në tetrametër trokaik që na sjell ndërmend një marsh hijerëndë, nëpërmjet të cilit perceptojmë tonalitetin e errët të trumpetës të përmendur në vargun e tretë (të dytin në origjinalin anglisht), si dhe ritmin monoton të dallues. Ndërkohë, në pjesën e Elegjisë që ruan të njëjtin metër, kalohet në vargun tercet dhe trioja e rimës ka një kadencë më të ëmbël. Ky kalim na kthen në neo-platonistin Plotinus dhe teorinë e tij të tri esencave: Njëshi, burimi i të gjithë ekzistencës, Inteligjenca, mbretëria e mendimit ose intelektit dhe Shpirti (Psikika), ndërmjetësja midis mbretërisë së inteligjencës dhe botës materiale. Kemi kështu një unitet të të kundërtave: dashuria ideale përfaqëson përgjërimin e shpirtit për të kapërcyer ekzistencën individuale dhe për tu ribashkuar me hyjnoren, ashtu sikurse shpirti kërkon të rikthehet tek Njëshi. Dashuria e tyre është shpirtërore dhe metafizike dhe reflekton udhëtimin e shpirtit drejt një bashkimi më të lartë, përtej ekzistencës fizike.

Poema, e cila lexohet me ëndje edhe sot, është sjellë në gjuhën shqipe në mënyrë mjeshtërore nga përkthyesi i shquar Alqi Kristo në vitet 1960 dhe botohet për herë të parë.

The Phoenix and the Turtle

By William Shakespeare

Let the bird of loudest lay
On the sole Arabian tree
Herald sad and trumpet be,
To whose sound chaste wings obey.

But thou shrieking harbinger,
Foul precurrer of the fiend,
Augur of the fever's end,
To this troop come thou not near.

From this session interdict
Every fowl of tyrant wing,
Save the eagle, feather'd king;
Keep the obsequy so strict.

Let the priest in surplice white,
That defunctive music can,
Be the death-divining swan,
Lest the requiem lack his right.

And thou treble-dated crow,
That thy sable gender mak'st
With the breath thou giv'st and tak'st,
'Mongst our mourners shalt thou go.

Here the anthem doth commence:
Love and constancy is dead;
Phoenix and the Turtle fled
In a mutual flame from hence.

So they lov'd, as love in twain
Had the essence but in one;
Two distincts, division none:
Number there in love was slain.

Hearts remote, yet not asunder;
Distance and no space was seen
'Twixt this Turtle and his queen:
But in them it were a wonder.

So between them love did shine
That the Turtle saw his right
Flaming in the Phoenix' sight:
Either was the other's mine.

Property was thus appalled
That the self was not the same;
Single nature's double name
Neither two nor one was called.

Reason, in itself confounded,
Saw division grow together,
To themselves yet either neither,
Simple were so well compounded;

That it cried, "How true a twain
Seemeth this concordant one!
Love has reason, reason none,
If what parts can so remain."

Whereupon it made this threne
To the Phoenix and the Dove,
Co-supremes and stars of love,
As chorus to their tragic scene:

THRENOS

Beauty, truth, and rarity,
Grace in all simplicity,
Here enclos'd, in cinders lie.

Death is now the Phoenix' nest,
And the Turtle's loyal breast
To eternity doth rest,

Leaving no posterity:
'Twas not their infirmity,
It was married chastity.

Truth may seem but cannot be;
Beauty brag but 'tis not she;
Truth and beauty buried be.

To this urn let those repair
That are either true or fair;
For these dead birds sigh a prayer.



Feniksi dhe turtullesha

Nga Uilliam Shekspir

Shqipëroi Alqi Kristo

Zog zëlartë që vajton,
N' atë palmë t' Arabisë,
Si kasnec, trumbet' e zisë,
Qashtërsinë e bind, e fton.

Por ti lajmës që gërthet
Si kumtar e djall i ndyrë,
Midis shpendëve mos hyr
Se për vdekjen je profet!

Prej kësaj bëjn' përjashtim
Gjithë shpendët grabitqarë,
Veç shqiponjës egërshane
Që mban rregull në varrim.

Rasëbardhin prift një herë, [2]
Që këndon për ca të vdekur,
Bëje mjelmë, shenjt të thekur
Që t'i ketë kënga vlerë.

Dhe ti korb që rron tre fish,
Si krijes' e zezë për tmerr,
Me firomën q'ep e merr,
Me vajtojcat do të shkrish.

Ja këtu nis historia:
Turtullesh' e feniks ç'hoqën,
Në një zjarr të dy u dogjën,
Vdiqën besa, dashuria!

Duheshin për bukuri,
Si një shpirt, por jo një farë,
Dy veçan, por të pandarë,
Numri vdiq në dashuri.

Zemrat larg, por n' harmoni,
Largësia nuk dallohej,
Dashuri e tyre, shtohej,
Vërtet ishte mrekulli!

Dashuri e tyre ndriti,
Turtullesha ngazëllonte,
Te feniksi kur flakëronte,
Unë e jotja, ti je imi.

Por vetitë e tyre s'puqën,
Sepse s'ishin të një lloji,
Nga natyra të një soji,
Të dy emrat i shpërpuqën.

Dhe logjika u ngatërrua
Tek shikon bashkim në ndarje,
Dukej sikur s'kishin çarje,
Dyja në një u bashkua.

Andaj thirri: "Kjo nuk shkon
Që të shkrihen dy në një!"
Dashuria s' bën pa të,
Por logjika s'e pranon!

Këtej lindi këngë e zisë,
Për feniksin dhe kumrinë,
Si dy yj për dashurinë,
Këndon kori i tragjedisë.

ELEGJIA

Bes', e nur e bukuri,
Hiri plot me thjeshtësi,
Ja këtu, u bënë hi!

Çerdh' e zogut vdekje krim,
Turtullesha besë urim,
Prehet vetëm n'amëshim;

Pa na lënë bir e bijë,
Jo se s'bënin dot fëmijë,
Virgjërinë patën prijë.

Besa duket, por mungon,
Nuri mburret, por nuk rron,
Të dy varri i mbulon!

Te ky varr ata të vijnë,
T' admirojnë virgjërinë,
Të shikojnë lemerinë!

-[1]Feniksi, sipas egjiptianëve të lashtë, ishte personifikim i perëndisë së diellit. Besohej se zogu jetonte deri në 500 vjet, pastaj digjej në zjarr me dëshirën e tij dhe ringjallej prej hirit, i freskët e i ri. Prandaj dhe konsiderohet simbol i pavdekësisë.

- Turtullesha është simbol i qashtërsisë dhe i besnikërisë.

[2]Rasëbardhë – Kleri vishej me rasë të bardhë, të cilën puritanët e kundërshtuan dhe e zëvendësuan më vonë me rasën e zezë.

Karikaturë nga Arben Meksi